



REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe



Mjetet dhe Praktikat më të Mira në Bashkëpunimin
Ndërkombëtar për Rikuperimin e Aseteve



Titulli

Mjetet dhe Praktikat më të Mira në Bashkëpunimin
Ndërkombëtar për Rikuperimin e Aseteve

Botuesit

Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE)
Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI)

Autorët

AML Consulting (Global) Ltd Experts:
Jill Thomas
Lawrence Day
Fiona Jackson

Botues

Desislava Gotskova

Dizajni dhe Printimi

UrbanGRAF, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina

© RAI2019

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ndalohet çdo
ribotim ose përdorim i paautorizuar i këtij materiali.

Këndvështrimet e paraqitura në këtë botim nuk
pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Nismës
Rajonale kundër Korrupsionit ose të shteteve anëtare të saj.

**Mjetet dhe Praktikat më të Mira
në Bashkëpunimin Ndërkombëtar
për Rikuperimin e Aseteve**

Manuali i trajnimit





Tabela e përmbajtjes

Parathënie	8
1. Hyrje	9
2. Terminologjia e rikuperimit të asetëve	10
2.1. Rikuperimi i asetëve	10
2.2. Asetet	10
2.3. Gjurmimi dhe identifikimi i asetëve	11
2.4. Bllokimi, sekuestrimi dhe ndalimi	11
2.5. Konfiskimi dhe heqja dorë nga asetet	12
2.6. Konfiskimi pa dënim	12
2.7. Konfiskim i objektit	13
2.8. Konfiskimi 'i vlerës' ose 'zëvendësimi i vlerës'	13
2.9. Realizimi i asetëve	14
2.10. Asgjësimi i asetit	14
2.11. Marrëveshje për ndarjen e asetëve	14
3. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare, rajonale dhe evropiane	15
3.1. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare	15
3.2. Legjislacioni Rajonal	17
3.3. Legjislacioni i Bashkimit Evropian	18
3.4. Sanksione dhe Listime	19
4. Mekanizmat Rajonale dhe Ndërkombëtare për Rikuperimin e Asetëve	20
4.1. CARIN-i dhe Rrjete të tjera të Agjencive të Rikuperimit të Asetëve (ARIN-t) Çfarë janë ARIN-t?	20
4.2. ARO-t	23
4.3. Europol	25
4.4. Eurojust	26
4.5. Rrjeti Gjyqësor Evropian	26
4.6. EGMONT	27
4.7. StAR	27
4.8. Interpol	28
4.9. Oficerët ndërlidhës/Kanalet e Ambasadës	28

5. Gjurmimi ndërkombëtar i aseteve	29
5.1. Kur duhet bërë Kërkesa Ndërkombëtare për Gjurmimin e Aseteve	29
5.2. Përzgjedhja e kanalit që do të përdoret	30
5.3. Shembull i Rastit A: Përdorimi i kanalit ARO për një kërkesë për gjurmimin e aseteve	31
5.4. Shembull i Rastit B: Përdorimi i CARIN dhe i ARIN-ve të tjerë për Zhvillimin e Kërkesave për Gjurmimin të Aseteve	38
5.5. Shembull i Rastit C: Një kërkesë nga Interpoli për Gjurmimin e Aseteve	41
6. Grupet e Përbashkëta Hetimore (JIT-et)	43
7. Gjurmimi i aseteve në juridiksionet offshore	48
7.1. Çfarë nënkupton një Juridiksion i një territori Parajse Fiskale	48
7.2. Trustet	49
7.3. Llojet e informacioneve të mbajtura nga bizneset në Juridiksionet Offshore	50
7.4. Si duhet të arrihet Bashkëpunimi Ndërkombëtar	52
7.5. Fjalori i Termave në Lidhje me Juridiksionet Offshore	52
8. Bllokimi dhe sekuestrimi	54
8.1. Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimit në procedurat penale	54
8.2. Marrja e kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimit në procedurat penale	56
9. Heqja dorë nga asetet dhe konfiskimi	58
9.1. Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për konfiskim në procedurat penale	58
9.2. Dërgimi dhe marrja e kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit në procedurat e konfiskimit pa dënim	60
9.3. Urdhrat për Pasurinë e Padeklaruar	62
9.4. Urdhrat për Pasurinë e Padeklaruar në MB	62
10. Kthimi dhe Asgjësimi i Aseteve: Marrëveshjet për Ndarjen e Aseteve	64
11. Ndhurma e ndërsjellë juridike për rikuperimin e aseteve	66
12. Përmbledhje e marrëveshjeve dypalëshe ekzistuese në rajon për rikuperimin e aseteve	68
13. Akronime/ Shkurtime	70
14. Burime të dobishme informacioni	72
15. Shtojca	74

Parathënie

Efektiviteti në bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar është shumë i vështirë për tu arritur. Barrierat gjuhësore, ndryshimet në legjislacionin dhe procedurat kombëtare të kombinuara me qasjet e ndryshme kulturore bëjnë që zyrtarët ligjzbatues, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët të përballen me sfida të pazakonshme gjatë ndërveprimit me partnerët e huaj homologë. Në rastet e bashkëpunimit ndërkombëtar me synim rikuperimin e asetëve, kjo sfidë shpesh bëhet edhe më e vështirë. Asetet dhe vendndodhja e tyre duhet të lokalizohen shpejt, para se të zhvendosen. Për tu arritur kjo, kërkohet që prokurorët dhe gjyqtarët të zotërojnë njohuri shumë të mira të legjislacionit të tyre të brendshëm në aspektin teknik dhe ligjor për sa i përket proceseve të bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit, së bashku me njohuri të tjera se si kryerja e këtyre proceseve mund të ndryshojë në juridiksione të tjera.

Në 2017, Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë dhe Nisma Rajonale kundër Korrupsionit u bashkuan në mbështetje të përmirësimit të kapaciteteve të juridiksioneve të rajonit të Evropës Juglindore (EJL) në lidhje me rikuperimin e asetëve. Në fillim të vitit 2018, pas një analize të thellë, proceseve të gjata të konsultimeve dhe diskutimeve të shumta të kryera nga një grup ekspertësh nga rajoni i EJL-së dhe më gjerë, u publikua një studim me titull *Rikuperimi i Aseteve në Ballkanin Perëndimor: Analizë Krahasuese e Legjislacionit dhe Praktikës*.

Ky publikim del në përfundimin se statistikisht në dispozicion tregojnë një nivel të ulët të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e rikuperimit të asetëve. Studimi dëshmon se mungesa e njohurive për mjetet dhe instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar për procesin e rikuperimit të asetëve është një faktor kyç për këtë. Si rezultat, një nga rekomandimet kryesore ishte forcimi i kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve të prokurorisë dhe organeve gjyqësore për të aplikuar instrumentet e bashkëpunimit ndërkombëtar në rastet e rikuperimit të asetëve, duke kërkuar sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve jashtë juridiksionit të tyre.

Ky Manual është hartuar si përgjigje ndaj këtyre rekomandimeve. Manuali vjen si element plotësues i aktiviteteve të vazhdueshme për ndërtimin e kapaciteteve në rajonin e Evropës Jug-Lindore dhe do të përdoret në disa aktivitete trajnimi të projektuara posaçërisht për të mbështetur autoritetet e angazhuara në rikuperimin ndërkombëtar të asetëve.

Ky Manual plotësohet nga Manuali i Rikuperimit Efektiv të Aseteve për juridiksionet e Evropës Jug-Lindore. Të dy botimet e këtyre Manualeve janë hartuar në të njëjtën kohë, me në thelb të njëjtin koncept dhe objektiv të përgjithshëm.

Qendra për Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë dhe Nisma Rajonale kundër Korrupsionit falenderojnë Qeverinë e Britanisë së Madhe për angazhimin e saj, mbështetjen financiare dhe udhëzimet materiale; Fondacionin Konrad Adenauer që na u bashkua në këtë rrugëtim dhe mbështetjen për pjesëmarrjen e përfituesve të tjerë; dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) për mbështetjen në fillimet e kësaj nisme që u konkretizua në marrjen e masave thelbësore në rajonin e Evropës Jug-Lindore.

1. Hyrje

Ky manual synon të ndihmojë praktikuesit e rikuperimit së aseteve për të kryer në mënyrë efektive rikuperimin e aseteve në nivel ndërkombëtar, duke ofruar udhëzime për praktikat më të mira për bashkëpunimin ndërkombëtar. Manuali përmban legjislacionin, standardet dhe mekanizmat përkatëse ndërkombëtare dhe evropiane për rikuperimin e aseteve për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe do të shërbejë si një mjet praktik për hetuesit, prokurorët, gjykatësit dhe institucionet e tjera të përfshira në gjurmimin dhe identifikimin e aseteve, bllokimin dhe sekuestrimin, konfiskimin (përfshirë konfiskimin pa dënim) dhe asgjësimin e aseteve ndërkombëtare. Manuali ofron gjithashtu një pasqyrë të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ekzistuese për bashkëpunimin për rikuperimin e aseteve në rajonin e Evropës Juglindore (SEE). Manuali përfshin si ndihmën e ndërsjellë juridike paraprake, ashtu edhe proceset e ndihmës së ndërsjellë juridike. Ai nuk mbulon menaxhimin ndërkufitar të aseteve.

Trajnerët mund ta përdorin manualin si një mjet mbështetës gjatë seancave kombëtare të trajnimit dhe mund t'jua ofrojnë atë pjesëmarrësve në kurs. Ai gjithashtu do të shërbejë si një burim ku mund të bazohen institutet e trajnimit gjyqësor dhe agjencitë e menaxhimit të aseteve gjatë punës së tyre operacionale.

2. Terminologjia e rikuperimit të asetëve

Praktikuesit përdorin një sërë fjalësh dhe frazash kur punojnë në fushën e rikuperimit të asetëve. Shpeshherë këto terma ndryshojnë nga një juridiksion në tjetrin. Kjo mund të sjellë probleme për të kuptuar se për çfarë nevojitet saktësisht gjatë kërkesave ndërkombëtare për të gjurmuar asetet ose për të zbatuar urdhrat e bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit. Praktikuesit e konsiderojnë praktikë të mirë përshkrimin e asaj që kërkohet kur dërgohet një kërkesë ndërkombëtare (ose Ndihmë e ndërsjellë ligjore (MLA) paraprake, ose gjatë Ndihmës së ndërsjellë Ligjore). Kjo u jep mundësinë shteteve të cilave u drejtohet kërkesa të shkojnë përtej terminologjisë në përmbajtjen e kërkesës, duke shmangur kështu çdo keqkuptim përmes përdorimit të fjalëve dhe frazave të ndryshme.

Lista e mëposhtme përmban fjalët dhe frazat më të përdorura për rikuperimin e asetëve, së bashku me shpjegimin e këtyre termave nga një praktikues dhe me përkufizimet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe Konventa e Varshavës e Këshillit të Evropës (KE), ku ato përcaktohen.

2.1. Rikuperimi i asetëve

Ky manual përdor termin "rikuperim i asetëve" për të përshkruar të gjitha fazat e procesit për të privuar kriminelët nga pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme,¹ duke përfshirë gjurmimin dhe identifikimin e asetëve, bllokimin dhe sekuestrimin, konfiskimin dhe kthimin dhe asgjësimin e asetëve.

2.2. Asetet

Asetet përfshijnë pasuritë e përdorura për të kryer krime (instrumentet) dhe të ardhurat nga krimi. Të ardhurat shpesh përshkruhen si fitime ose përfitime materiale nga krimi. Të ardhurat mund të ndahen në të ardhura të drejtpërdrejta nga krimi, të quajtura ndryshe edhe objekti, dhe të ardhurat e tërthorta nga krimi. Nëse marrim shembullin e një vjedhjeje me armë të bankës, instrumentet do të ishin arma e përdorur për të kërcënuar stafin e bankës dhe makina për arratisje, të ardhurat e drejtpërdrejta do të ishin paratë e marra nga banka dhe të ardhurat e tërthorta do të ishin pasuria e patundshme e blerë duke përdorur paratë *cash*.

Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale i përshkruajnë asetet si më poshtë:

"instrumenti" nënkupton çdo pasuri të përdorur ose që synon të përdoret, në cilëndo mënyrë, tërësisht ose pjesërisht, për të kryer një ose disa vepra penale (Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(c))

¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit e vitit 2005 përdor termin rikuperim i asetëve për t'iu referuar dëmshpërblimit të asetëve të përvetësuar vetëm nëpërmjet korrupsionit.

"pasuri" nënkupton çdo lloj aseti, si fizik edhe jofizik, i luajtshëm ose i paluajtshëm, i prekshëm ose i paprekshëm, dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë pronësinë ose interesa në këto asete (UNCAC A. 2(d); Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(b))

"produkte të krimit" nënkupton çdo pasuri që rrjedh ose përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet kryerjes së një shkelje (UNCAC, A. 2 (e))

"të ardhura" nënkupton çdo avantazh ekonomik, që rrjedh ose përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga veprat penale. Asetet mund të përbëhen nga çdo pasuri, siç përcaktohet në këtë nen. (Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(b))

2.3. Gjurmimi dhe identifikimi i aseteve

Gjurmimi dhe identifikimi i aseteve përfshin procesin e hetimit penal dhe financiar për të gjetur pasuritë ose vendndodhjen e tyre, qoftë brenda juridiksionit ku po kryen hetimet penale, ose në një juridiksion tjetër që do të përfshinte një kërkesë ndërkombëtare për të gjurmuar asetet. Identifikimi i aseteve synon të zbulojë pronarin ose kontrolluesin e pasurisë.

2.4. Bllokimi, sekuestrimi dhe ndalimi

Pas gjurmimit dhe identifikimit të asetit dhe sapo çështja të kalojë në fazën e hapur të hetimit, aseti duhet t'i nënshtrohet bllokimit, sekuestrimit ose ndalimit, me qëllim që ta ndalojë të lëvizë në periudhën para çdo vendimi të formës së prerë, në pritje të konfiskimit. Nëse asetet nuk janë të bllokuara apo të sekuestruara, autori i dyshuar i veprës mund ta lëvizë asetin në një përpjekje për ta fshehur ose shitur. Bllokimi dhe sekuestrimi zbatohen me urdhër të gjykatës. Kur një aset i nënshtrohet një urdhri bllokimi, mbetet aty ku është, për shembull, një llogari bankare do të ngrihej. Kur një aset i nënshtrohet një urdhri sekuestrimi, ai kalon në zotërim të shtetit, për shembull një makinë mund të sekuestrohet. Bllokimi dhe Sekuestrimi përkufizohen gjithashtu si "sekuestro".

Termi ndalim përdoret për të përshkruar ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, shitjes ose lëvizjes së pasurisë në pronësi të një personi të caktuar, gjithashtu nëpërmjet një urdhri të gjykatës. Në këtë rast, aseti zakonisht mbetet në pronësi të pronarit. Një urdhër ndalimi vendoset për një individ dhe jo aset, megjithëse pasuria do të përshkruhet si "e ndaluar" ose subjekt i një urdhri ndalimi.

"Bllokimi " ose "sekuestrimi" nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferimit, konvertimit, shitjes ose lëvizjes së pasurisë ose marrjen e përkohshme të kujdestarisë ose kontrollit të pasurisë me anë të një urdhri të lëshuar nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent (UNAC A. 2 (f); Konventa e Varshavës e KE-së A. 1(g)).

2.5. Konfiskimi dhe heqja dorë nga asetet

Konfiskimi është procesi i privimit të përhershëm të autorit të shkeljes nga të ardhurat, pas vendimit të formës së prerë. Heqja dorë nga asetet zakonisht përdoret për të përshkruar procesin e privimit të përhershëm të autorit të shkeljes nga instrumentet ose çdo mjet i paligjshëm siç janë drogat ose armët e zjarrit, para ose pas vendimit të formës së prerë. Megjithatë, fjalët 'konfiskim' dhe 'heqje dorë nga asetet' përdoren në mënyrë të ndërsjellë në disa juridiksione. Shprehja 'heqje dorë nga asetet' mund të përdoret në vend të konfiskimit dhe anasjelltas.

"konfiskimi", i cili përfshin heqjen dorë nga asetet, sipas rastit, nënkupton privimin e përhershëm të pasurisë me urdhër të një gjykate ose autoriteti tjetër kompetent (UNCAC A. 2 (g))

"konfiskimi" nënkupton një penaltet ose masë të urdhëruar nga një gjykatë pas procesit gjyqësor në lidhje me një ose disa vepra penale që rezultojnë në privimin përfundimtar të pasurisë.

2.6. Konfiskimi pa dënim

Konfiskimi pa dënim është procesi i konfiskimit të asetëve pa dënuar ndonjë person të caktuar për veprë penale në lidhje me ato asete. Kjo mund të bëhet si në proceset gjyqësore penale, ashtu edhe civile. Më poshtë jepen katër shembuj të konfiskimit pa dënim:

a) Konfiskimi i të ardhurave kriminale dhe instrumenteve gjatë ndjekjes penale, në rrethanat në të cilat rasti vërtetohet, por nuk është i mundur dënimi për shkak të vdekjes, mungesës ose sëmundjes mendore të autorit ose për arsye të tjera që ndalojnë dënimin e formës së prerë.

b) Konfiskimi i zgjeruar:

Konfiskimi i zgjeruar konsiderohet kur konfiskohen asetet që nuk janë objekt i veprës penale për të cilën kriminelin është sjellë para gjykatës. Në këtë rast konfiskimi "zgjerohet" te asetet që nuk janë instrumente, të ardhura të drejtpërdrejta ose të tërthorta të krimit që po ndiqet penalisht. Konfiskimi i zgjeruar zbatohet jo vetëm për përfitimet e një veprë penale të caktuar për të cilën është dënuar autori, por shtrihet për të përfshirë të gjithë përfitimet e marra nga veprimtaria kriminale në përgjithësi. Autoritetëve nuk u kërkohet të përcaktojnë një lidhje midis asetëve të dyshuara si kriminale dhe sjelljes kriminale specifike për të cilën akuzohet personi. Nga ana tjetër, konfiskimi mund të bazohet në prova ose konkluzione rrethanore. Një mospërputhje ndërmjet asetëve të një personi dhe burimeve të tyre të ligjshme të të ardhurave dhe/ ose dëshmi të përgjithshme që provojnë angazhimin në sjellje kriminale me përfitime mund të jetë pjesë e justifikimit për 'zgjerimin' e konfiskimit të asetëve të tjera (p.sh. dënime të përsëritura, dëshmi të pjesëmarrjes në organizata kriminale). Meqenëse shumë nga këto terma ndryshojnë më së shumti nga perceptimi, shtetet shpesh përpiqen t'i përshtatin ato në varësi të legjislacionit ose praktikave të tyre. Prandaj, krahas sa më sipër, disa shtete gjithashtu e konsiderojnë në bazë të të ardhurave nga krimi masën e konfiskimit të zgjeruar.

c) Konfiskimi civil:

Konfiskimi civil është një veprim inrem që kërkon prova se aseti është një instrument i krimit ose i të ardhurave kriminale, por nuk kërkon të provojë vërtetësinë e fajit të një individi përtej dyshimit të arsyeshëm.

d) Pasuri e pashpjeguar:

Pasuri e pashpjeguar konsiderohet kur një person zotëron ose gëzon një nivel pasurie që nuk mund ta kenë fituar ligjërisht, gjë që nuk mund të shpjegohet me ndonjë mjet tjetër, si trashëgimi, fitim lotarie ose dhuratë.

2.7. Konfiskim i objektit

Konfiskimi i objektit është konfiskimi i pasurisë së saktë, reale që konsiderohet si e ardhur ose instrument i krimit.

2.8. Konfiskimi 'i vlerës' ose 'zëvendësimi i vlerës'

Konfiskimi i vlerës konsiderohet kur personi i dënuar urdhërohet të paguajë një shumë parash të barabartë me vlerën e përfitimit kriminal. Gjykata ose autoriteti kompetent përlllogarit "përfitimin" për autorin e dënuar për një vepër të caktuar. Urdhri i konfiskimit bëhet në shumën e asaj vlere. Në këtë rast, gjykata nuk merret me trajtimin e instrumenteve reale (përveç rasteve nëse janë asete të paligjshme, si armë zjarri ose droga) dhe të ardhurat, por përqendrohet tek një shumë parash të barabartë me përfitimet kriminale. Urdhri i konfiskimit mund të plotësohet ose 'paguhet' nga autori i veprës duke përdorur çdo mjet në dispozicion të tyre, duke përfshirë asetet ligjore.

Shpesh, instrumentet ose të ardhurat reale nuk janë më në zotërimin e autorit të dënuar kur vjen momenti i zbatimit të urdhrit të konfiskimit. Zëvendësimi i vlerës lejon përcaktimin e vlerës së të ardhurave dhe/ose instrumenteve të krimit dhe zbaton një vlerë të barabartë që do të konfiskohet si 'zëvendësim' për instrumentet ose të ardhurat reale.

2.9. Realizimi i asetëve

Asetet realizohen kur ato konvertohen nga asetë, mallra ose shërbime në para *cash* nëpërmjet një shitjeje.

2.10. Asgjësimi i asetit

Asgjësimi i asetit është procesi i shitjes ose shkatërrimit të një asemi.

2.11. Marrëveshje për ndarjen e asetëve

Një marrëveshje për ndarjen e asetëve është një dokument që përcakton marrëveshjet ndërmjet dy ose shumë shteteve për ndarjen e asetëve, në rastet kur asetet që lidhen me shtetin që kryen hetimin ose ndjekjen penale janë të bllokuara dhe menaxhohen nga një shtet tjetër. Për shembull, shtetet mund të vendosin të ndajnë të ardhurat kriminale përgjysmë 50/50 ndërmjet dy shteteve të përfshira.

3. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare, rajonale dhe evropiane

Kapitulli i tretë trajton standardet ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale që ofrojnë një bazë për bashkëpunimin ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve ose promovojnë kuadro efektive për bashkëpunim ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve.

3.1. Legjislacioni dhe standardet ndërkombëtare

Konventat e mëposhtme të Kombeve të Bashkuara mund të përdoren si bazë për bashkëpunimin ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve ndërmjet juridiksioneve që janë nënshkruese të Konventave përkatëse. Këto Konventa ofrojnë dispozita bashkëpunimi ndërkombëtar për të dyja proceset e hetimit për të gjurmuar dhe identifikuar asetet dhe gjithashtu për bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe asgjësimin e aseteve.

3.1.1. Konventa e vitit 2000 e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC)

UNTOC është konventa kryesore e OKB-së me synim luftën kundër krimin të organizuar. Ajo mbulon veprat penale të pjesëmarrjes në grupe të organizuara kriminale, në pastrimin e parave, korrupsionin dhe pengimin e drejtësisë dhe krime të tjera të rënda të dënueshme me heqje maksimale të lirisë deri në së paku katër vjet ose me një dënim më të rëndë. Vepra penale duhet të jetë e natyrës ndërkombëtare dhe të përfshijë një grup të organizuar kriminal. Këto dy aspekte janë të përcaktuara në legjislacion.²

Neni 13 për Bashkëpunimin ndërkombëtar për qëllime konfiskimi ofron bazën ligjore për kërkesat ndërmjet juridiksioneve si për hetimin financiar (për të gjetur dhe identifikuar asetet) ashtu edhe për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, pasurive dhe instrumenteve.

Neni 14 për asgjësimin e të ardhurave të konfiskuara të krimin ose pasurisë ofron dispozita në lidhje me marrëveshjet ndërmjet juridiksioneve për asgjësimin dhe kthimin e aseteve të bllokuara ose të sekuestruara nga një juridiksion pas një kërkesë nga një juridiksion tjetër. Kjo nxit përfundimin e marrëveshjeve për ndarjen e aseteve ndërmjet shteteve me qëllim kompensimin e viktimës dhe kthimin e aktiveve tek pronarët e ligjshëm.

Neni 18 (3) g parashikon ndihmë të ndërsjellë juridike për të mbledhur prova që kanë të bëjnë me ekzistencën e aseteve me anë të identifikimit ose gjurmimit të të ardhurave të krimin, pasurisë, instrumenteve apo të tjera për tu përdorur si prova.

² Materiale shtesë shpjeguese mund të gjenden në Udhëzuesin Legjislativ të UNTOC:
https://www.unodc.org/pdf/crime/legislative_guides/Legislative%20guides_Full%20version.pdf

Neni 19 për hetimet e përbashkëta parashikon që juridiksionet të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, në lidhje me çështjet që janë subjekt i hetimeve, ndjekjeve penale ose procedurave gjyqësore në një ose më shumë shtete, në të cilat autoritetet kompetente në fjalë mund të themelojnë organe të përbashkëta hetimore. Kjo ofron mundësi për gjurmimin dhe identifikimin e asetëve për konfiskim në të ardhmen.

3.1.2. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit 2005

UNCAC-ja duhet të përdoret si bazë ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar për rikuperimin e asetëve në lidhje me veprat penale të korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.³

Kapitulli i pestë i Konventës trajton kthimin e asetëve të përfituara përmes korrupsionit. "Rikuperimi i asetëve" këtu përshkruhet si "një parim themelor i kësaj Konvente dhe Shtetet Palë i ofrojnë njëra-tjetrës nivelin më të lartë të bashkëpunimit dhe ndihmës në këtë drejtim".

Nenet 53, 54 dhe 55 përcaktojnë kërkesat për njohjen e urdhrave të konfiskimit midis shteteve dhe mekanizmat përmes së cilave zbatohen urdhrat e konfiskimit. Veçanërisht, në nenin 54, paragrafi 1, pika c, përmendet shprehimisht marrja e masave për të lejuar konfiskimin e asetëve pa dënim penal në rastet kur shkelësi nuk mund të ndiqet penalisht për shkak të vdekjes, arratisjes ose mungesës, ose në raste të tjera të përshtatshme. Neni 57 parashikon kthimin dhe asgjësimin e asetëve të konfiskuara.

Neni 59 përcakton se juridiksionet duhet të marrin në konsideratë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit ndërkombëtar për rikuperimin e asetëve në lidhje me veprat penale të korrupsionit.

3.1.3. 40 Rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar (2012)

Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar për hartimin e politikave, i cili synon vendosjen e standardeve dhe promovimin e zbatimit efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operacionale për luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Këto standarde përfshijnë gjithashtu masat për rikuperimin e asetëve. Rekomandimet e FATF-së përbëjnë një standard ndërkombëtar të njohur për luftimin e këtyre aktiviteteve kriminale, duke ofruar mjetet e duhura për të luftuar pastrimin e të ardhurave nga korrupsioni. Ndërkohë që vendet e Ballkanit Perëndimor me juridiksionet e tyre nuk bëjnë pjesë si anëtarë të FATF, MONEYVAL-i përfaqëson një anëtar të asociuar dhe kryen raport vlerësimet në vendet e Ballkanit Perëndimor sipas standardeve të FATF.

³ Materiali i mëtejshëm shpjegues mund të gjendet në Udhëzuesin Legjislativ dhe në Udhëzuesin Teknik të UNCAC-së:

https://www.unodc.org/pdf/corruption/CoC_LegislativeGuide.pdf dhe

https://www.unodc.org/documents/corruption/Technical_Guide_UNCAC.pdf

Rekomandimi 38 ofron standarde udhëzuese për bashkëpunimin ndërkombëtar në fazën e Ndhmës së Ndërsjellë Juridike të bashkëpunimit ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve, në lidhje me bllokimin, sekuestrimin, menaxhimin, konfiskimin dhe ndarjen e aseteve. Shtetet duhet të garantojnë që kanë autoritetin për të ndërmarrë "veprime të shpejta" kur iu përgjigjen kërkesave në lidhje me rikuperimin e aseteve. Kjo përfshin kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të bazuara në procedurat e konfiskimit pa dënim, kur është e mundur brenda kuadrit të legjislacionit të tyre të brendshëm.

3.2. Legjislacioni Rajonal

3.2.1. Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës e vitit 1959 për Ndhmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (Konventa e vitit 1959 e MLA-së)

Konventa e vitit 1959 e MLA-së ofron kushtet e përgjithshme për ndihmën e ndërsjellë juridike ndërmjet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës. Është metoda më e përdorur e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe, në lidhje me rikuperimin e aseteve, mund të përdoret si bazë për hetime financiare për gjetjen dhe identifikimin e aseteve, si dhe për kërkesat për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre.

3.2.2. Konventa e vitit 2005 për Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (ETS nr. 198) (Konventa e Varshavës)

Konventa e Varshavës përditëson Konventën e Strasburgut për Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (ETS nr. 141) në lidhje me rikuperimin e aseteve. Kapitulli i katërt parashikon dispozita gjithëpërfshirëse për të gjitha aspektet e bashkëpunimit ndërkombëtar për rikuperimin e aseteve, përfshirë hetimet për të gjetjen e aseteve, aksesin në të dhënat financiare dhe monitorimin e llogarive, një kuadër ligjor si për shtetet që bëjnë kërkesën për informacionin e kërkuar për të bërë kërkesa, ashtu edhe për shtetet të cilave u drejtohet kërkesa për informacionin që duhet të ofrojnë dhe për ofrimin e informacioneve pa njoftim paraprak. Konventa e Varshavës gjithashtu ofron dispozita për zbatimin e urdhrave të bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit, duke përfshirë urdhrat e bazuar në procedurat e konfiskimit pa dënim, menaxhimin e aseteve dhe asgjësimin e tyre në rastet ndërkombëtare.

3.2.3. Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsionin e vitit 1999 (ETS nr. 173) ("Konventa e Strasburgut e vitit 1999")

Konventa e Këshillit të Evropës për Korrupsionin ofron dispozita më të hollësishme për rikuperimin ndërkombëtar të aseteve. Megjithatë, neni 30 parashikon në mënyrë praktike marrjen e masave për komunikimin direkt mes autoriteteve kompetente në rast urgjence, nëpërmjet kërkesave të MLA-së të dërguara paralel nga autoritetet qendrore. Kjo mund të jetë thelbësore kur kërkohet bllokimi dhe sekuestrimi i aseteve që mund të zhduken shpejt.

3.3. Legjislacioni i Bashkimit Evropian

3.3.1 Vendimi Kuadër i Këshillit 2001/500/JHA për pastrimin, identifikimin, gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi. Kjo parashikon veprat penale për të cilat duhet të zbatohet konfiskimi dhe paraqet konfiskimin e vlerës.

3.3.2 Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/577/JHA i 22 korrikut 2003, për ekzekutimin në Bashkimin Evropian të urdhrave për bllokimin e pasurive ose provave. Paraqet parimin e njohjes së ndërsjellë të urdhrave të bllokimit dhe konfiskimit.

3.3.3 Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/JHA i 24 shkurtit 2005 për konfiskimin e të ardhurave, instrumenteve dhe pasurive të lidhura me krimin. Kjo parashikon konfiskimin e asetëve që i janë transferuar një pale të tretë dhe konfiskimin e zgjeruar.

3.3.4 Vendimi Kuadër i Këshillit 2006/783/JHA i 6 tetorit 2006 për zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të urdhrave të konfiskimit. Paraqet parimin e njohjes së ndërsjellë të urdhrave të konfiskimit.

3.3.5 Vendimi i Këshillit të BE-së 2007/845/JHA për bashkëpunimin midis Zyrave të Rikuperimit të Aseteve të Shteteve Anëtare, në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të produkteve ose të pasurive të tjera të lidhura me krimin ("Vendimi i Këshillit të ARO-së")

Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA detyron Shtetet Anëtare të themelojnë ose të caktojnë Zyra Kombëtare për Rikuperimin e Aseteve ("ARO") si pika qendrore kombëtare të kontaktit të cilat lehtësojnë, nëpërmjet bashkëpunimit të zgjeruar, gjurmimin më të shpejtë të mundshëm në BE për asetet që rrjedhin nga krimi. Vendimi u lejon ARO-ve të shkëmbejnë informacionet dhe praktikrat më të mira, qoftë me kërkesë ose pa planifikim paraprak, pavarësisht nga statusi i tyre (administrative, ligjzbatuese ose autoritet gjyqësor). U kërkon ARO-ve të shkëmbejnë informacione sipas kushteve të përcaktuara në Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së 2006/960/JHA ("Nisma Suedeze") për lehtësinë e shkëmbimit të informacionit dhe shërbimit informativ ndërmjet agjencive ligjzbatuese të BE-së, në lidhje me afatet brenda të cilave ARO-të duhet t'u përgjigjen kërkesave për gjurmimin e asetëve. Mbulon kërkesat e bëra si në bazë të procedurave penale ose, për aq sa është e mundur sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Anëtar përkatës, të procedurave civile. Siguron kuadrin ligjor për gjurmimin dhe identifikimin e asetëve nëpërmjet ARO-ve të BE-së pavarësisht Statusit të ARO-s sipas legjislacionit vendas dhe nëse është e vendosur brenda një agjencie të zbatimit të ligjit, strukture gjyqësore apo administrative.

3.3.6 Direktiva 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian. Direktiva e vitit 2014 shërben për të thjeshtuar Vendimet Kuadër të Këshillit të viteve 2001 dhe 2005. Prandaj, zhvillon më tej konfiskimin e bazuar në vlerë dhe dispozitat e konfiskimit të zgjeruar. Gjithashtu paraqet dispozitën për konfiskimin pa dënim, në rastet kur i akuzuari është arratisur ose nuk mund të ndiqet penalisht për shkak të ndonjë sëmundjeje.

3.3.7. Rregullorja e vitit 2018 e BE-së 2018/1805/BE ("Rregullorja e vitit 2018")

Rregullorja e vitit 2018 e BE-së 2018/1805/BE u prezantua për të sqaruar Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së 2003/577/JHA për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave për Bllokimin e Pasurive dhe Provave dhe Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së 2006/783/JHA për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Konfiskimit. Ashtu si dy Rregulloret pararendëse, Rregullorja e vitit 2018 krijon një sistem për njohjen e ndërsjellë të urdhrave të bllokimit dhe konfiskimit midis Shteteve Anëtare të BE-së, ku përcaktohet se kur duhet të njihen urdhrat e ngrirjes dhe konfiskimit, si dhe në çfarë rrethanash mund ta refuzojnë ngrirjen Shtetet Anëtare të BE-së. Qëllimi është nxitja e inkurajimit mes autoriteteve të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa (ekzekutues) për njohjen automatike të urdhrat të gjykatës të lëshuar nga shteti i cili dërgon kërkesën (kërkues) pa marrë kohë me procesin e nxjerrjes së urdhrave të tjerë në vendin të cilit i drejtohet kërkesa. Si shtojcë në Rregullore gjendet një model për 'certifikatën' e bllokimit dhe konfiskimit. Shtetet kërkuese plotësojnë dhe përkthejnë modelin që duhet t'i dërgohet shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, së bashku me urdhrin origjinal, megjithëse ky i fundit nuk ka nevojë të përkthehet. Rregullorja gjithashtu përfshin dispozita për menaxhimin dhe asgjësimin e pronës së bllokuar dhe të konfiskuar, kthimin e pronës viktimave dhe kompensimin e tyre. Gjithashtu, merren në konsideratë detyrimet e shteteve anëtare për personat e prekur dhe zgjidhjet ligjore në dispozicion të tyre. Rregullorja nuk zbatohet për urdhrat e bllokimit dhe konfiskimit të marra gjatë procedurave civile ose administrative dhe për këtë arsye përjashton konfiskimin civil pa dënim. Zbatohet për urdhrat e transmetuara më 19 dhjetor 2020 ose pas kësaj date.

3.4. Sanksione dhe Listime

Një numër organesh dhe institucionesh ndërkombëtare nxjerrin lista të personave juridikë dhe fizikë ose juridiksione që nuk janë në përputhje me 'standardet' që përcaktojnë ato. Këto lista ose sanksione shpesh janë katalizatorë të hetimeve që kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar për rikuperimin e asetëve. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara vendos sanksione për "rivendosjen e paqes dhe sigurisë". Bashkimi Evropian mban një listë të personave juridikë dhe fizikë që u nënshtrohen sanksioneve ndërkombëtare. Këto sanksione vendosin një detyrim në sektorin financiar, në shumë raste, për të bllokuar asetet e personave juridikë ose fizikë të listuar. Veprimet e sektorit financiar mund të bëjnë që raportet e transaksioneve të dyshimta t'ju dorëzohen njësisë kombëtare të inteligjencës financiare (FIU), të cilat nga ana tjetër mund të nisin një hetim për pastrim parash. Komisioni Evropian menaxhon një listë të konsoliduar të BE-së të personave, grupeve dhe subjekteve që iu nënshtrohen sanksioneve financiare. Baza e të dhënave mbahet dhe përditësohet nga Komisioni Evropian, në të cilën publikohen në formate të ndryshme listat e konsoliduara të sanksioneve financiare që përbëhen nga bllokimi i asetëve.⁴

⁴ <https://data.europa.eu/euodp/en/data/dataset/consolidated-list-of-persons-groups-and-entities-subject-to-eu-financial-sanctions>

4. Mekanizmat Rajonale dhe Ndërkombëtare për Rikuperimin e Aseteve

Në përgjithësi, suksesi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar nuk është i lehtë për t'u arritur. Në rastin konkret të rikuperimit të asetëve, ndryshimet në legjislacionin e brendshëm, politikat, institucionet dhe procedurat pengojnë më tej shkëmbimin efikas të informacionit. Asetet që dyshohet se ndodhen në juridiksione të ndryshme nga ato të shtetit që kryen ndjekjen penale, gjithmonë rrezikojnë të zhvendosen, të fshihen ose t'i transferohen një pale të tretë, në përpjekje për të fshehur pronarin e vërtetë. Bashkëpunimi ndërkombëtar efektiv i rikuperimit të asetëve kërkon, në mënyrë të veçantë, veprime të shpejta për të zbatuar me sukses instrumentet ndërkombëtare të listuara paraprisht.

Është pa dyshim e drejtë të thuhet që në vitet 1990 rikuperimi i asetëve ishte ende në fazën fillestare dhe kishte shumë pak bashkëpunim ndërkombëtar për gjurmimin, identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale jashtë vendit. Bllokimi dhe konfiskimi kërkohehin, në këto raste, në kërkesat për ndihmë të ndërsjellë ligjore, zakonisht në një fazë më të vonë të hetimit, kur rastet tashmë ishin në pritje në gjykatë. Kjo do të thotë se kriminelët kishin shumë kohë për të fshehur dhe asgjësuar asetet e tyre, e për rrjedhojë konfiskimi ishte rrallëherë i suksesshëm. Si rezultat i kësaj situatë të pakënaqshme, janë krijuar një sërë rrjetesh 'formale' dhe 'joformale' për të ndihmuar në mënyrë specifike me gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve.

4.1. CARIN-i dhe Rrjete të tjera të Agjencive të Rikuperimit të Aseteve (ARIN-t)

Çfarë janë ARIN-t?

Rrjetet e Agjencive të Rikuperimit të Aseteve (ARIN-t) janë rrjete joformale të kontakteve nga agjencitë ligjzbatuese dhe ato gjyqësore (prokurorë, magjistratë, gjyqtarë, avokatë qeveritarë), të cilët janë praktikues në të gjitha aspektet e procesit të rikuperimit të asetëve. Kjo përfshin gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin, menaxhimin, konfiskimin dhe asgjësimin e asetëve. Kontaktet lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për rikuperimin e asetëve.

Rrjeti Camden i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve - CARIN

CARIN-i është një rrjet joformal i praktikuesve ligjzbatues dhe gjyqësorë, profesionistë në fushën e gjurmimit, bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve. Është një rrjet ndër-institucional. Secili shtet anëtar përfaqësohet nga një punonjës i zbatimit të ligjit dhe një ekspert gjyqësor (prokuror, gjyqtar hetues, etj. në varësi të sistemit ligjor).

Qëllimi i CARIN-it është rritja e efektivitetit të përpjekjeve të anëtarëve të tij, në shumë agjenci, për të privuar kriminelët nga fitimet e tyre të paligjshme. Së pari është një rrjet operacional, i cili ekziston për të lehtësuar kërkesat operationale të bazuara në rastet e rikuperimit të asetëve.

Kontaktet e CARIN-it mbështesin procesin e rikuperimit të plotë të aseteve, që nga pika fillestare e hetimit të konfiskimit, e cila përfshin gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin, menaxhimin dhe në fund konfiskimin e aseteve, duke përfshirë çdo ndarje të domosdoshme të aseteve midis juridiksioneve. Përfaqësuesit e CARIN-it të shteteve anëtare quhen "pika kombëtare të kontaktit". Të gjithë ata janë anglishtfolës, pasi gjuha në të cilën punon rrjeti është anglishtja. Kontaktet e CARIN-it mund të kontaktohen drejtpërdrejt me telefon ose email.

Aktualisht, CARIN-i ka 54 juridiksione anëtare të regjistruara, duke përfshirë 28 shtete anëtare të BE-së dhe nëntë organizata ndërkombëtare. CARIN-i është gjithashtu i lidhur me shtatë rrjete të tjera rajonale të agjencive të rikuperimit të aseteve (ARIN) në të gjithë globin. Të gjitha juridiksionet anëtare të RAI-t janë anëtare të CARIN-it dhe kanë pika kontakti të CARIN-it.

Objektivat Kryesore të CARIN-it

Në kërkimin të arritjes së qëllimit të tij, objektivat kryesore të CARIN-it janë:

- të krijojë një rrjet pikash kontakti;
- të përqendrohet tek të ardhurat e të gjitha krimeve, brenda fushëveprimit të detyrimeve ndërkombëtare;
- të afirmohet si një qendër ekspertize në të gjitha aspektet e trajtimit të të ardhurave nga krimi;
- të promovojë shkëmbimin e informacionit dhe praktikat e mira;
- të bëjë rekomandime për organe si Komisioni Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, në lidhje me të gjitha aspektet e trajtimit të të ardhurave nga krimi;
- të veprojë si një grup këshillimi për autoritetet e tjera përkatëse;
- të lehtësojë, kur është e mundur, trajnimin në të gjitha aspektet e trajtimit të të ardhurave nga krimi;
- të theksojë rëndësinë e bashkëpunimit me sektorin privat për arritjen e qëllimit të tij;
- dhe të inkurajojë anëtarët për krijimin e zyrave kombëtare të rikuperimit të aseteve.

Rrjeti i rikuperimit të aseteve sipas stilit CARIN ka vërtetuar se është një koncept popullor midis juridiksioneve nga rajone të tjera. Kjo ka sjellë krijimin e shtatë rrjeteve të tjera rajonale të agjencive të rikuperimit të aseteve, ose 'ARIN', që nga themelimi i CARIN-it në vitin 2004. Këto rrjete kanë një vendndodhje gjeografike si më poshtë:

- 1) Kryesisht, por jo ekskluzivisht, **CARIN**-i mbulon Evropën (Rrjeti Camden i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve). Nëse një juridiksion do të donte të ishte pjesë e grupit ARIN, por në rajonin e vet nuk ka asnjë rrjet të themeluar, fillimisht do të anëtarësohej në CARIN.
- 2) **ARIN-AP** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Azinë e Paqësorit)
- 3) **ARIN-CARIB** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Karaibe)
- 4) **ARIN-EA** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Lindore)
- 5) **ARIN-SA** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Jugore)
- 6) **ARIN-WA** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Perëndimore)
- 7) **ARIN-WCA** (Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Azinë Perëndimore dhe Qendrore)
- 8) **RRAG** (Red de Recuperación de Activos de GAFILAT – për Amerikën Latine)

Për informacione të mëtejshme rreth historisë, strukturës dhe funksionimit të CARIN-it dhe ARIN-ve të tjerë, së bashku me një listë të juridiksioneve të tyre anëtare dhe mënyrat e kontaktit të Sekretariateve përkatëse, ju lutemi referojuni faqes www.carin-network.org.

Kush mund ta përdorë CARIN-in?

Këto rrjete janë unike për atë kohë sa ato përbëhen nga kontakte si nga agjencitë e zbatimit të ligjit, ashtu dhe ato gjyqësore. CARIN-it mund t'i kërkojnë ndihmë zyrtarët e zbatimit të ligjit (policia/doganat/ agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit), një prokuror, magjistrat, gjykatës ose një zyrtar nga Zyra e Rikuperimit të Aseteve (ARO) ose Zyra e Menaxhimit të Aseteve (AMO).

Kërkesat - Nga një juridiksion i CARIN-it për një juridiksion të CARIN-it

Kërkesat për informacione nga praktikuesit në një juridiksion anëtar të CARIN-it për një juridiksion tjetër anëtar të CARIN-it fillimisht duhet të bëhen nëpërmjet kontaktit përkatës të CARIN-it, d.m.th. Nga juridiksioni i CARIN-it që dërgon kërkesën për juridiksionin e CARIN-it të cilit i drejtohet kërkesa. Pas këtij kontakti fillestar, hetuesit dhe prokurorët mund të komunikojnë drejtpërdrejt me agjencinë përkatëse në shtetin e CARIN-it të cilit i drejtohet kërkesa, nëse komunikojnë në të njëjtën gjuhë.

Kërkesat - Nga një juridiksion i CARIN-it për një juridiksion jashtë CARIN-it

Të gjitha ARIN-t janë autonome në nivel rajonal në aspektin e mënyrës se si strukturohen dhe organizojnë punën e tyre strategjike. Megjithatë, për qëllime operacionale, ato bashkëpunojnë në mënyrë efektive nëpërmjet Sekretariatit të secilit rrjet. Për t'i bërë një kërkesë për informacion një juridiksioni nga një tjetër ARIN, për shembull nga Rumania (në CARIN) në Brazil (në RRAG), hetuesi ose prokurori duhet t'i dërgojnë një kërkesë kontaktit rumun të CARIN-it, i cili më pas ia dërgon me postë elektronike Sekretariatit të CARIN-it. Sekretariati i CARIN-it ia përcjell këtë kërkesë me postë elektronike Sekretariatit të një ARIN-je tjetër, që në këtë rast është Sekretariati i RRAG-ut. Sekretariati i RRAG-ut njofton nëse është e mundur të sigurohet informacioni i kërkuar dhe cilit prej kontakteve në Brazil është më e përshtatshme për t'ia dhënë. Sekretariati gjithashtu trajton çdo problem gjuhësor dhe përkthen mesazhet nëse është e nevojshme (për shembull, RRAG-u është një rrjet spanjisht folës ndërsa CARIN-i është një rrjet anglisht folës). Më pas, Sekretariati i RRAG-ut ia përcjell kërkesën me postë elektronike kontaktit përkatës të RRAG-ut në Brazil. Pas këtij kontakti fillestar, praktikuesi që bën kërkesën mund të vazhdojë komunikimin drejtpërdrejt me praktikuesin të cilit i drejtohet kërkesa, nëse komunikojnë në të njëjtën gjuhë.

Për çfarë kërkesash mund të përdoren ARIN-t?

CARIN-i dhe ARIN-t e tjera mund të përdoren për të zhvilluar çdo aspekt të procesit të rikuperimit të asetëve, nga gjurmimi dhe identifikimi i asetëve, e deri te bllokimi, sekuestrimi, menaxhimi, konfiskimi, asgjësimi përfundimtar dhe ndarja e tyre.

Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha ARIN-t kanë krijuar platforma të sigurta për shkëmbimin e kërkesave operacionale për të gjurmuar asetet ose për shkëmbimin e kërkesave për të zbatuar urdhrat e bllokimit dhe konfiskimit. ARIN-t duhet të përdoren për të përcaktuar se çfarë informacioni është në dispozicion në një juridiksion tjetër dhe çfarë kanali zyrtar dhe i sigurt duhet të përdoret për ta dërguar dhe për ta marrë atë informacion.

Kur përdoret CARIN-i

- Kur një kanal i përshtatshëm dhe i sigurt ligjor nuk është qartësisht i njohur në shtetin ku përcillet kërkesa.
Për shembull, nëse bëhet një kërkesë për gjurmimin e asetëve dhe juridiksioni i kërkuar është jashtë Evropës dhe fushëveprimit të platformës ARO të BE-së (shih seksionin mbi "ARO-të" më poshtë), mund të jetë e paqartë se çfarë baze ligjore ose kanal duhet përdorur për dërgimin e informacionit operacional të përfshirë në kërkesë (Interpol, EGDMONT FIU, kërkesë zyrtare e MLA-së etj). Në mënyrë që kërkesës t'i jepet përgjigje plotësisht dhe në kohë, kontaktet e ARIN-së duhet ta sqarojnë këtë përpara se të dërgojnë kërkesat e tyre.
- Nëse gjurmimi, bllokimi, sekuestrimi ose konfiskimi i asetëve kërkohet me urgjencë, ose nëse bllokimi apo konfiskimi duhet të kryhet në një datë të caktuar.
- Nëse kërkesa është veçanërisht e ndërlikuar, qoftë për shkak të vëllimit të punës ose aspekteve teknike të kërkesës.

4.2. ARO-t

Çfarë është Zyra Kombëtare e Rikuperimit të Asetëve (ARO) në kontekstin e BE-së?

Brenda BE-së, një ARO kombëtare është një zyrë e autorizuar për gjurmimin dhe identifikimin e asetëve që rrjedhin nga krimi, të cilat më pas mund t'i nënshtrohen një urdhri për bllokim, sekuestrim, ndalim, ose konfiskim.

Themelimi i ARO-ve të BE-së në të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së (MS) ka 'formalizuar' pjesën joformale të zbatimit të ligjit të CARIN-it, duke krijuar një bazë ligjore për kërkesat për gjurmimin e asetëve që duhen shkëmbyer (shih Vendimin e Këshillit të BE-së 2007/845/JHA Lidhur me bashkëpunimin midis Zyrave të Rikuperimit të Asetëve në Shtetet Anëtare, në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave ose pasurive të tjera që lidhen me krimin). Vendimi i Këshillit 2007/845/JHA detyron Shtetet Anëtare të themelojnë ose të caktojnë Zyra Kombëtare për rikuperimin e Asetëve ("ARO") si pika qendrore kombëtare të kontaktit të cilat lehtësojnë, nëpërmjet bashkëpunimit të zgjeruar, gjurmimin më të shpejtë të mundshëm në BE për aktivet që rrjedhin nga krimi. Vendimi u lejon ARO-ve të shkëmbejnë informacionet dhe praktikat më të mira, qoftë me kërkesë ose pa planifikim paraprak, pavarësisht nga statusi i tyre (administrative, ligjzbatuese ose autoritetet gjyqësor).

Nga natyra e detyrës kryesore që ata kryejnë, domethënë atë të hetimit, ARO-të në të shumtën e rasteve ndodhen në strukturat e policisë brenda Ministrisë së Brendshme. Në juridiksionet ku autoriteti i prokurorisë përfaqëson kreun e akuzës, ARO-t vendosen më së shumti brenda autoritetit publik të akuzës nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Në raste më pak të zakonshme, një juridiksion mund të ketë themeluar një zyrë qendrore kombëtare të pavarur për rikuperimin e asetëve. Zyrat e pavarura të rikuperimit të asetëve, sipas natyrës së ndjeshmërisë së llojeve të rasteve që mbështesin (për shembull, korrupsioni brenda një zyre publike), shpesh veçohen nga organet e tjera ministrore për të mbrojtur pavarësinë e tyre. Disa juridiksione kanë miratuar qasjen kombëtare të ARO-ve, në mënyrë që të ketë dy ARO: një ARO të policisë për të mbështetur procesin hetimor dhe një ARO të prokurorisë që mbështet bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin dhe në raste të rralla menaxhimin e asetëve. Ka disa shembuj të ARO-ve të vendosura brenda Njësive të Inteligjencës Financiare (FIU-t) ku FIU përfaqëson një instancë jo administrative dhe as policore, por me profil prokurorie ose hibride.

Kush mund t'i përdorë Zyrat e Rikuperimit të Aseteve të BE-së?

Kërkesat e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve bëhen nga ARO-ja në ARO, d.m.th. ARO-ja në shtetin i cili dërgon kërkesën i dërgon një kërkesë ARO-së në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa. Megjithatë, si agjencitë e brendshme të zbatimit të ligjit, ashtu edhe autoritetet gjyqësore, mund të nxisin një kërkesë të ARO, duke ia dërguar kërkesën e tyre ARO-ve të tyre kombëtare.

Për çfarë kërkesash përdoren ARO-të e BE-së?

ARO-të e BE-së përdoren për kërkesat e hetimit financiar për të mbledhur informacion mbi vendndodhjen e asetëve në fazën paraprake të MLA-së së një hetimi. Në disa raste, ARO-të e BE-së gjithashtu janë të autorizuar në nivel kombëtar për marrjen dhe zbatimin e urdhrave të ndalimit dhe konfiskimit. Në këtë rast, agjencitë e huaja gjyqësore mund të kërkojnë mbështetjen e ARO-ve për hartimin e kërkesave të MLA-së.

Në disa raste është e mundur të dërgohet një kopje e kërkesës së MLA-së nëpërmjet kanalit të ARO-ve, paralelisht me kanalin e përcaktuar nga shteti që dërgon kërkesën ose ai të cilit i drejtohet kërkesa (për shembull, Autoriteti Qendror).

ARO-të përdoren për hetime të bazuara në procedura penale dhe, për aq sa është e mundur sipas legjislacionit të brendshëm të Shtetit Anëtar të BE-së, procedura civile.

Si të përdoret Platforma e Shkëmbimit të Informacionit të ARO-s së BE-së

ARO-të e BE-së kanë mundësinë të përdorin platformën e sigurt të shkëmbimit të informacionit të administruar nga Europol-i, të quajtur SIENA. Terminalët me akses të drejtpërdrejtë tek platforma e shkëmbimit të SIENA-s janë instaluar në shumicën e ARO-ve të BE-së, duke lejuar shkëmbimin e informacionit mes ARO-ve me qëllim dërgimin dhe marrjen e kërkesave të gjurmimit të asetëve.

Prandaj, roli kryesor i një ARO-je është lehtësimi i gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga krimi. Menaxhimi i asetëve nuk është përmendur sipas këtij neni, e për rrjedhojë nuk është detyrim sipas Vendimit të Këshillit të ARO-ve. Megjithatë, Vendimi i ARO-ve përcakton standarde minimale dhe Shtetet Anëtare janë të lira të zgjerojnë detyrat e ARO-ve të tyre edhe për të mbuluar aktivitetet e menaxhimit të asetëve.

Jashtë BE-së, autoritetet kompetente të juridiksioneve që nuk janë pjesë e BE-së mund t'i përdorin në mënyrë operative ARO-të e BE-së, duke lidhur një marrëveshje me Zyrën Policore Evropiane, të quajtur Europol. Europol-i administron platformën elektronike të shkëmbimit të informacionit (SIENA) që përdoret nga ARO-të e BE-së.

ARO-të që nuk janë pjesë e BE-së dhe Qasja me Shumë Agjenci

Krijimi i një ARO-je kombëtare tashmë njihet në rang global si një praktikë e mirë për të përmirësuar, në veçanti, veprimet ndërkufitare për rikuperimin e asetëve. Përveç krijimit të AROs, juridiksionet në të gjithë botën kanë treguar vigjilencë më të madhe në identifikimin, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi nëpërmjet vënies në zbatim të punës në disa disiplina. Këto ARO përdorin personelin nga agjencitë e tjera ligjzbatuese, duke punuar së bashku, duke ndërlidhur kompetencat përkatëse. Për të përmirësuar efektivitetin dhe eficiencën në shënjestrimin e të ardhurave nga veprat e paligjshme në nivel kombëtar, një numër i juridiksioneve kanë zhvilluar struktura që lejojnë bashkëveprimin e punës në shumë disiplina.

4.3. Europoli

Europoli përfaqëson Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit. Europoli ka si mision dhënien e mbështetjes për 28 vendet anëtare (MS-të) të Bashkimit Evropian në luftën kundër terrorizmit, krimin kibernetik, dhe formave të tjera të organizuara të krimin. Agjencia bashkëpunon me shumë vende jo anëtare të BE-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Të gjitha vendet anëtare të Nismës Rajonale Kundër Korrupsionit kanë mundësi ligjore të bashkëpunojnë në mënyrë operacionale me Europol-in, qoftë nëpërmjet statusit të tyre si vende anëtare të BE-së, ose në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit operacional që kanë lidhur me Europol-in. Këto marrëveshje u lejojnë hetimeve nga juridiksionet e vendeve anëtare të RAI-t mundësinë për të patur akses në Zyrat e Rikuperimit së Aseteve të BE-së, nëpërmjet Zyrtarit të tyre të Ndërlidhjes të Europol-it, duke përdorur platformën e sigurtë të shkëmbimit të informacionit të SIENA-s administruar nga Europol-i. Përveç kërkesave individuale për të gjurmimin e asetëve, Europol gjithashtu ofron një analizë gjithëpërfshirëse mbi pasurinë e individëve të përfshirë në hetimin e krimeve të rënda ndërkombëtare, nëpërmjet Projektit të Analizës (AP) 'Rikuperimi i Aseteve'. Europol-i gjithashtu menaxhon Sekretariatit e Rrjetit CARIN, duke e vendosur atë në një pozicion qendror kyç, duke lehtësuar hetimet financiare me qëllim gjurmimin e asetëve. Europoli ka pozicion në qendër të kontakteve evropiane të ARIN dhe rrjetit të ARO-ve të BE-së. Europol vepron në kuadër të kornizës së vet ligjore, Rregullorja (BE) 2016/794 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit (Europol). Më shumë informacion në lidhje me Europol-in dhe

aktivitetet e saj në lidhje me rikuperimin e asetëve dhe CARIN mund të gjenden në këtë faqe zyrtare në internet: <https://www.europol.europa.eu/about-europol>

4.4. Eurojust

Ndërsa Europol-i është agjencia e BE-së për zbatimin e ligjit, Eurojust-i është agjencia e bashkëpunimit juridik për Bashkimin Evropian, me mision përmirësimin e koordinimit të hetimeve dhe ndjekjeve penale dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente në Shtetet Anëtare. Mbështetja e garantuar nga Eurojust-i në fushën e rikuperimit të asetëve është veçanërisht e dobishme për lehtësimin e ekzekutimit të kërkesave ndërkombëtare për dhënien e asistencës ligjore për të zbatuar urdhrat e bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit dhe për të asistuar në riatdhesimin e asetëve për viktimat. Krahas mandatit të saj për të mbështetur vendet anëtare (MS) të BE-së, Eurojust-i ka nënshkruar gjithashtu një numër marrëveshjesh operative me vendet e treta. Këto marrëveshje ofrojnë mundësinë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e Eurojust-it me Shqipërinë, Moldavinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë Veriore.⁵ Rregullorja e Eurojust-it (2019 Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Drejtësinë Penale) ofron kuadrin ligjor si bazë për këtë bashkëpunim. Më shumë informacion për Eurojust-in mund të gjendet tek

<http://www.eurojust.europa.eu/Pages/home.aspx>

4.5. Rrjeti Gjyqësor Evropian

Rrjeti Gjyqësor Evropian për Çështjet Penale (EJN) është një rrjet i pikave kombëtare të kontaktit për lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Ky rrjet vepron në përputhje me kuadrin e vet ligjor, Vendimin e Këshillit 2008/976/JHA të datës 16 dhjetor 2008 mbi Rrjetin Gjyqësor Evropian (referuar në vijim të këtij dokumenti si "Vendimi i EJN-së").

Roli kryesor i Pikave të Kontaktit të EJN-së është lehtësimi i bashkëpunimit gjyqësor në lidhje me çështjet penale ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së. Pikat e kontaktit ndihmojnë në vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta midis autoriteteve kompetente dhe sigurojnë informacionin ligjor dhe praktik të nevojshëm për të përgatitur një kërkesë efektive për bashkëpunim gjyqësor. Sekretariati i EJN-së me seli tek zyrat e Eurojust-it në Hagë, është përgjegjës për detyrat administrative të EJN-së. Më shumë informacion mund të gjendet tek

https://www.ejn-crimjust.europa.eu/ejn/EJN_Home.aspx.

EJN-ja ka hartuar një seri dokumentesh dhe mekanizmash të aksesueshme në internet për të asistuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, përfshirë rikuperimin e asetëve. Për shembull në dokumentin "Dokument i Përbashkët" mbi *Ndihmën në Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështjet Penale për Praktikuesit (Dokumenti i Përbashkët)*, përshkruhet roli i EJN-së dhe Eurojust-it. Qëllimi i Dokumentit të Përbashkët është mundësimi për praktikuesit gjyqësorë për të vendosur nëse duhet të kontaktojnë me EJN-në dhe Eurojust-in për ndihmë në bashkëpunim ndërkombëtar në çështjet penale. Dokumenti i Përbashkët i EJN-së është përkthyer në disa gjuhë, përfshirë gjuhët e

⁵ Një marrëveshje bashkëpunimi mes Serbisë dhe Eurojust-it është në pritje për tu nënshkruar.

Ballkanit Perëndimor. EJN-ja gjithashtu ofron një sërë instrumentesh të dobishëm për identifikimin e kërkesave ligjore të një autoriteti kompetent vendor kur kërkon bashkëpunimin gjyqësor, një model të ndihmës së ndërsjellë juridike, një bibliotekë gjyqësore, pikat e kontaktit dhe ofron informata koncize dhe praktikë ligjore lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar për sa i përket masave shtrënguese. Informacion i mëtejshëm mbi EJN-në dhe të gjitha instrumentet në dispozicion të EJN-së gjenden tek kjo faqe zyrtare në internet https://www.ejn-crimjust.europa.eu/ejn/EJN_Home.aspx

4.6. EGMONT

Grupi EGMONT është një rrjet global i 159 Njësi të Inteligjencës Financiare (FIU-të), të cilat shkëmbejnë informacion financiar përmes uebit të sigurt të EGMONT-it. Fokusi kryesor i FIU-ve është lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ato janë një burim informacioni veçanërisht i dobishëm në lidhje me raportet e transaksioneve të dyshimta dhe llogaritë financiare siç janë llogaritë bankare. FIU-të përdorin faqen zyrtare në internet të sigurt të EGMONT-it për të shkëmbyer informacione në mënyrë të sigurt nëpërmjet një sistemi të koduar të postës elektronike. EGMONT-i ofron shkëmbimi informacioni nga FIU-ja në FIU, prandaj, për ta përdorur këtë kanal, hetuesit dhe prokurorët duhet të kontaktojnë FIU-në e tyre të brendshme. Për më shumë informacion në lidhje me EGMONT-in, ju lutem referojuni faqes: <https://egmontgroup.org/en/content/about>.

4.7. StAR

Rrjeti i Rikuperimit së Pasurive të Vjedhura (StAR) Rrjeti Global i Pikave të Kontaktit të Interpolit (GFPN) është një listë e pikave të kontaktit që lidhen në mënyrë specifike me rikuperimin e aseteve në rastet e anti-korrupsionit. Këto kontakte mund të shërbejnë gjithashtu si kontakte të ARIN-ve ose ARO-ve. GFPN-ja është krijuar që të ndihmojë praktikuesit për të kapërcyer barrierat operacionale që lidhen me lehtësimin e riatdhesimit të të ardhurave nga korrupsioni, duke mundësuar një platformë të sigurt për shkëmbimin e informacionit për rikuperimin e aseteve kriminale. Zyrtarët e autorizuar të zbatimit të ligjit nga secili vend anëtar (vendet anëtare të INTERPOL) janë caktuar si "Pika Kontakti" dhe janë në dispozicion për t'u përgjigjur kërkesave të menjëhershme për ndihmë në lidhje me rikuperimin e aseteve nga çdo vend tjetër anëtar duke përdorur një faqe të sigurt interneti të Interpol të njohur si I-SECOM për shkëmbimin e informacionit. Objektivi strategjik i menjëhershëm i kësaj nisme është që t'ju përgjigjet shqetësimeve të bllokimit të aseteve, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve të vjedhura. Një objektivi i vazhdueshëm është të lehtësojë shkëmbimin e sigurt të informacionit të klasifikuar midis Pikave të Kontaktit të agjencive kundër korrupsionit dhe rikuperimit të aseteve. Për më shumë informacion se si të kontaktoni Interpol-in në lidhje me këtë platformë, ju lutem referojuni faqes: <https://www.interpol.int/Crimes/Corruption/Asset-recovery>.

4.8. Interpol

Interpol-i, Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (ICPO), është një rrjet i 194 vendeve anëtare dhe është krijuar për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar të policisë. Ky rrjet vepron sipas Kushtetutës së Interpol-it dhe ofron një platformë të sigurt të shkëmbimit të informacionit, e cila mund të përdoret për kërkesat për gjurmimin e asetëve, gjatë fazës së hetimit për rikuperimin e asetëve. Kanali I/24 i sigurt i komunikimit është veçanërisht i dobishëm për shkëmbimin e informacionit operacional jashtë Bashkimit Evropian. Ky është një opsion i shkëlqyer ku CARIN-i dhe pikat e tjera të kontaktit të ARIN-it kanë krijuar kontakte fillestare me kontaktin e ARIN-it nga një juridiksion tjetër dhe kërkesat për gjurmimin e asetëve hyn në një fazë ku duhet të shkëmbehet informacioni operacional. Pikat e kontaktit të CARIN/ARIN mund të kontaktojnë Zyrën Qendrore Kombëtare (NCB) të Interpolit dhe të kërkojnë ndihmë për të dërguar informacionin për rastin në një pikë tjetër kontakti CARIN/ARIN nëpërmjet NCB-së në vendin e kërkuar, pasi kontakti fillestar është krijuar nëpërmjet rrjetit përkatës të ARIN. Kjo do të mundësojë një transmetim të ligjshëm dhe të sigurt të informacionit operacional. Për më shumë informacion në lidhje me Interpol-in, ju lutem referojuni faqes:

<https://www.interpol.int>.

4.9. Oficerët ndërlidhës/Kanalet e Ambasadës

Kërkesat për gjurmimin e asetëve dhe zbatimin e urdhrave për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin mund të dërgohen edhe nëpërmjet Oficerëve Ndërlidhës ose Ambasadave, për të garantuar transmetimin e tyre të ligjshëm dhe të sigurt.

5. Gjurmimi ndërkombëtar i aseteve

Kapitulli i katërt i Manualit përshkruan kanalet rajonale dhe ndërkombëtare më të përdorura për gjurmimin ndërkombëtar të aseteve. Për 9 vendet e rajonit të Ballkanit anëtare të RAI rrjetet operative janë: rrjeti i ARO-s së BE-së (nëpërmjet Europoli-it), rrjeti CARIN-it, Rrjeti i Aseteve të Vjedhura (StAR), Rrjeti i Pikave të Kontaktit të Interpoli-it (GFPN). Pavarësisht nga kanali që përdoret, ekzistojnë tri rregulla të rëndësishme:

1. **Shmangni ekspeditat hetimore.** Kërkesa për gjurmimin e aseteve i dërgohet një shteti vetëm kur keni arsye për të besuar se asetet që po kërkonit mund të gjenden në juridiksionin e vendit të cilit i drejtohet kërkesa. Për shembull, i dyshuari, apo anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e tij mund të udhëtojnë shpesh në juridiksionin e kërkuar, mund të kenë një biznes apo familje në atë vend ose mund të keni informata apo prova të tjera që tregojnë se asetet që zotëron ose kontrollohen nga i dyshuari juaj gjenden në vendin e kërkuar.
2. **Kur zgjidhni një kanal komunikimi, mos e ndryshoni atë.** Mos e dërgoni të njëjtën kërkesë nëpërmjet disa kanaleve, vetëm nëse keni ndonjë arsye. Në këtë rast, shpjegoni siç duhet që tashmë keni përdorur një tjetër kanal. Puna e dyfishtë do ta irritojë shtetin të cilit i drejtohet kërkesa dhe duhet të shmanget.
3. **Hartojeni siç duhet kërkesën për gjurmimin e aseteve.** Ndiqni strukturat e përshkruara në Shtojcën A dhe B të 'Nismës Suedeze' (Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së 2006/960/JHA "Nisma Suedeze") për thjeshtimin e shkëmbimit të informacionit dhe shërbimit informativ ndërmjet agjencive ligjzbatuese të BE-së)(shih Shtojcën).

5.1. Kur duhet bërë Kërkesa Ndërkombëtare për Gjurmimin e Aseteve

Kur bëni një kërkesë ndërkombëtare për gjurmimin e aseteve, të cilat më vonë mund t'i nënshtrohen bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit, së pari merrni në konsideratë fazën e hetimit penal dhe financiar. Faza e çështjes, para arrestimit, pas arrestimit ose pas dënimit të subjektit, mund të ketë ndikim te nevoja për një hetim urgjent ose të fshehtë, e për rrjedhojë te kanali që mund të zgjidhni. Nëse çështja është në fazën pas dënimit, i pandehuri është tashmë i vetëdijshëm që autoritetet do të kërkojnë asetet e tij. Në këtë rast, shpejtësia mund të mos jetë aq e rëndësishme, pasi ka gjasa që pronari i asetit tashmë e ka zhvendosur, fshehur ose tjetërsuar pasurinë e tij. Si rregull i praktikës më të mirë, hetimi financiar për të gjurmimin e aseteve që më vonë do jenë subjekt konfiskimi, duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur në fazën para arrestimit të subjektit, paralelisht me hetimin penal, nga hetuesit financiarë të specializuar. Sapo hetuesit dhe prokurorët të vihen në dijeni se asetet të cilat më vonë mund të merren në konsideratë për konfiskim, janë transferuar në një juridiksion tjetër, ata duhet të fillojnë hetimet për gjurmimin e aseteve.

5.2. Përzgjedhja e kanalit që do të përdoret

Kanali më efektiv që do të përdoret për gjurmimin ndërkombëtar të aseteve varet nga një sërë faktorësh. Këta faktorë janë caq të ndryshueshëm, saqë një hetues financiar ose prokuror në një juridiksion kërkues nuk mund t'i njohë realisht të gjitha opsionet në të gjitha juridiksionet me të cilat mund të bashkëpunojë. Këta faktorë përfshijnë:

- Nëse jeni duke mbledhur informacione rreth dosjes penale të subjektit ose prova (kërkesë joformale në fazën paraprake të MLA-së ose kërkesë formale e MLA-së)
- nëse shtetet kërkuese dhe ato të cilave u drejtohet kërkesa janë shtete anëtare të BE-së ose jo
- legjislacioni ose politika në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa lidhur me aksesin e mundshëm në bazat e të dhënave pa pasur nevojë për masa shtrënguese (ndoshta kërkohet një MLA)
- kuadri institucional i shtetit kërkues dhe atij të cilit i drejtohet kërkesa (cili agjenci apo autoritet e ka informacionin e nevojshëm)
- lloji i krimit nën hetim (korrupsion, pastrim parash etj.).

Këto ndryshime janë arsyeja e krijimit të rrjeteve si CARIN-i. Mund të ndodhë që disa juridiksione të jenë më të njohura se të tjerat, si një zgjedhje për kriminelët për të investuar pasurinë e tyre të paligjshme, për shembull kur blejnë shtëpi në juridiksione me klimë më të ngrohtë. Në këtë rast, në këto juridiksione do të kryhen më sistematikisht hetime të një natyre të veçantë, e për rrjedhojë do jetë më e qartë se cili është kanali më i mirë për t'u përdorur.

Përfundimisht, për të realizuar konfiskimin, gjykata në shtetin kërkues do të kërkojë provat për ekzistencën e aseteve të cilat do të sigurohen nëpërmjet një kërkesë të bazuar në Traktatin e Ndhmës së Ndërsjellë Ligjore. Megjithatë, është më mirë që asetet të cilat gjenden në një juridiksion tjetër të identifikohen në mënyrë joformale, duke përdorur kanalet joformale të disponueshme si fillim, para se të bëhet një kërkesë zyrtare MLA. Në fakt, disa juridiksione do të insistojnë që kërkesa është trajtuar nga ARO-ja e tyre, para ekzekutimit të MLA-së për gjurmimin e pasurive.

Më poshtë jepen disa udhëzime të përgjithshme për hetuesit se cilat rrjete dhe kanale duhet të përdorin për kërkesat joformale në fazën paraprake të MLA-së për gjurmimin e aseteve. Megjithatë, nëse hetuesit dhe prokurorët nuk janë të sigurt, duhet të konsultohen me kontaktin e CARIN-it se cila është alternativa më e mirë.

Nga një Shtet Anëtar i BE-së për një tjetër Shtet Anëtar të BE-së

Kanali i ARO-ve

Kërkesat për gjurmimin e aseteve midis Shteteve Anëtare të BE-së lehtësohen më së miri duke përdorur kanalën e Zyrave të Rikuperimit të Aseteve të BE-së. Gjatë përgatitjes dhe përgjigjes së një kërkesë për gjurmimin e aseteve, mund të përdorin formatet e përcaktuara në Shtojcën A (përgjigje nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa) ose Shtojca B (hetim nga shteti i cili dërgon kërkesën) të Nismës Suedeze, ose të ndjekin strukturat e përshkruara në Shtojcën A dhe B të Nismës Suedeze për t'u garantuar që kërkesa të përmbajë të paktën informacionin e përshkruar në këto formate (shih Shtojcën). Për Shtetet Anëtare të BE-së, formatet A dhe B janë gjithashtu një udhëzues i dobishëm për të garantuar që gjatë marrjes së

kërkesave në fazën paraprake të MLA-së për gjurmimin e aseteve, për shembull duke përdorur kanalën e Europol-it ose Interpol-it, në kërkesë përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm. Platforma e shkëmbimit të informacionit të Europol-it, SIENA, lidh në mënyrë elektronike ARO-të e BE-së. Kërkesat për gjurmimin e aseteve mund të shkëmbehen në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë.

5.3. Shembull i Rastit A: Përdorimi i kanalit ARO për një kërkesë për gjurmimin e aseteve

Ju jeni një hetues financiar nga një juridiksion i BE-së që aktualisht po kryeni një hetim financiar për veprimtarinë e Max RUSU dhe bashkëpunëtorit të tij Vadim SANDU, (të dy qytetarë të vendit tuaj) të dyshuar për trafik droge dhe pastrim parash.

Pas arrestimit të RUSU u krye një kontroll në shtëpinë e tij. Nga dokumentacioni i sekuestruar, tregohet se RUSU është aksionar i shoqërisë Madame Blanc R.S.J, e regjistruar në Francë.

Ky hetim po kryhet në fazën e pas arrestimit, ku të dy personat janë në lirim me kusht duke pritur vendimin e gjyqit.

Prandaj, ju keni disa tregues se RUSU i ka investuar në Francë ato çfarë ka përfituar nga trafikimi i drogës.

Kërkesa e ARO-s

SHTOJCA B

SHKËMBIM INFORMACIONI SIPAS VENDIMIT KUADËR TË KËSHILLIT 2006/960/JHA,
 FORMULAR KËRKESE PËR PËR INFORMACION DHE INFORMATA RRETH DOSJES
 PENALE PËR T'U PËRDORUR NGA SHTETI ANËTAR QË DËRGON KËRKESËN

Ky formular përdoret kur kërkohen informacione dhe informata rreth dosjes penale sipas
 Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

I — Informacion administrativ

Autoriteti që dërgon kërkesën (emri, adresa, telefoni, faksi, emaili, Shteti Anëtar):	Zyra e Rikuperimit të Aseteve [juridiksioni, adresa, numri i telefonit, faksi, emaili i shtetit kërkues të BE-së]			
Detajet e agjentit të transportit (opsionale):	<i>Nëse kërkesa është dërguar nëpërmjet një njësie tjetër, vendosni emrin këtu</i>			
Për Shtetin Anëtar në vijim:	Francë			
Data dhe ora e kësaj kërkesë:	03/10/2018 ora 14:30			
Numri i Referencës i kësaj kërkesë:	ABC1234/16			
Kërkesat e mëparshme				
<input checked="" type="checkbox"/> Kjo është kërkesa e parë për këtë çështje				
<input type="checkbox"/> Kjo kërkesë ndjek kërkesat e mëparshme në të njëjtën çështje				
Kërkesa(t) e mëparshme			Përgjigjja(et)	
	Data	Numri i referencës (në Shtetin Anëtar që dërgon kërkesën)	Data	Numri i referencës (në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa)
1.				
2.				
3.				
4.				

Nëse kërkesa është dërguar tek më shumë se një autoritet në Shtetin Anëtar, lutemi specifikoni kanalet e përdorura:

<input type="checkbox"/> Oficeri ndërlidhës i Europol-it/ENU-së	<input type="checkbox"/> Për informacion	<input type="checkbox"/> Për ekzekutim
<input type="checkbox"/> Interpol NCB	<input type="checkbox"/> Për informacion	<input type="checkbox"/> Për ekzekutim
<input type="checkbox"/> Sirene	<input type="checkbox"/> Për informacion	<input type="checkbox"/> Për ekzekutim
<input type="checkbox"/> Oficeri ndërlidhës	<input type="checkbox"/> Për informacion	<input type="checkbox"/> Për ekzekutim
<input type="checkbox"/> Tjetër (ju lutemi specifikoni):	<input type="checkbox"/> Për informacion	<input type="checkbox"/> Për ekzekutim
Në rast se e njëjta kërkesë u dërgohet Shteteve të tjera Anëtare, ju lutemi specifikoni shtetet e tjera anëtare dhe kanalit e përdorur (opsionale)		

II — Afatet kohore

Kujtesë: afatet kohore sipas nenit 4 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

- A — Vepra parashikohet në nenin 2, paragrafi 2, të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA dhe

Informacionet ose informatat rreth dosjes penale të kërkuara mbahen në një bazë të dhënash në të cilën ka akses të drejtpërdrejtë një autoritet ligjzbatues

- ➔ Kërkesa është urgjente
- ➔ Afati kohor: 8 orë me mundësi shtyrjeje
- ➔ Kërkesa nuk është urgjente
- ➔ Afati kohor: 1 javë

- B — Çështje të tjera: ➔ Afati kohor: 14 ditë

Llojet e veprës (-ave) penale apo veprimtaritë kriminale që janë në proces hetimi

Përshkrimi i rrethanave në të cilat është kryer vepra (-at) penale, përfshirë kohën, vendin dhe shkallën e pjesëmarrjes në veprën penale nga personi i cili përbën objektin e kërkesës për informacion ose dosjen kriminale:

Max RUSU dhe bashkëpunëtori i tij Vadim SANDU kanë qenë objekt i një hetimi të gjatë nga [emri i agjencisë ose autoritetit dhe shtetit] lidhur me importimin dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të kokainës në [vendin tuaj] dhe pastrimin e të ardhurave nga veprimtaritë kriminale në periudhën midis janarit 2017 dhe majit 2019. Më 01/06/2019 të dy subjektet u akuzuan për trafik droge dhe pastrim parash dhe aktualisht janë nën arrest në pritje të gjyqimit që do të zhvillohet më 01/09/2019.

Gjykata ka lëshuar një urdhër ndalimi në lidhje me dy të pandehurit, në pritje të hetimit të konfiskimit. Për të identifikuar çdo aktiv, Zyra e Rikuperimit të asetëve po kryen aktualisht një hetim financiar në gjendjen financiare të Max RUSU dhe bashkëpunëtorit të tij Vadim SANDU për të konstatuar shumën e rikuperueshme bazuar në veprimtarinë e përgjithshme kriminale të të pandehurit.

Natyra e veprave penale

A — Zbatimi i nenit 4 paragrafi 1 ose nenit 4 paragrafi 3 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

- A. 1. Vepra penale dënohet me burgim të paktën për tre vjet në Shtetin Anëtar që i drejtohet kërkesa

DHE

A.2. Vepra penale është një (ose më shumë) nga sa më poshtë:

- | | |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> Pjesëmarrja në një organizatë kriminale | <input checked="" type="checkbox"/> Pastrimi i të ardhurave nga krimi; |
| <input type="checkbox"/> Terrorizmi | <input type="checkbox"/> Krimi kompjuterik |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i parave, duke përfshirë euron | <input type="checkbox"/> Krimi mjedisor, duke përfshirë trafikimin e paligjshëm të specieve të rrezikuara të kafshëve dhe të specieve dhe varieteteve të rrezikuara të bimëve |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i qenieve njerëzore | <input type="checkbox"/> Mbështetja e hyrjes dhe e qëndrimit të paautorizuar |
| <input type="checkbox"/> Shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe pornografia me fëmijë | <input type="checkbox"/> Vrasja, plagosja e rëndë |
| <input checked="" type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotrope; | <input type="checkbox"/> Tregtia e paligjshme e organeve dhe indeve njerëzore |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve | <input type="checkbox"/> Rrëmbimi, pengmarrja dhe mbajtja e paligjshme e personave |
| <input type="checkbox"/> Korrupsion | <input type="checkbox"/> Racismi ose ksenofobia |
| <input type="checkbox"/> Mashtrimi, duke përfshirë mashtrimin që prek interesat financiare të komuniteteve evropiane sipas kuptimit të Konventës së 26 korrikut 1995 për mbrojtjen e Interesave financiare të Komuniteteve Evropiane | <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i materialeve nukleare dhe radioaktive |
| <input type="checkbox"/> Vjedhja e organizuar ose e armatosur | <input type="checkbox"/> Trafikimi i mjeteve motorike të vjedhura |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i të mirave kulturore, duke përfshirë veprat antike dhe veprat e artit | <input type="checkbox"/> Përdhunimi |
| <input type="checkbox"/> Mashtrimi | <input type="checkbox"/> Zjarrvënie e qëllimshme |
| <input type="checkbox"/> Krimet brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale | <input type="checkbox"/> Shantazhi dhe zhatja; |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i dokumenteve administrative dhe trafikimi me anë të tyre | <input type="checkbox"/> Falsifikimi dhe pirateria e produkteve |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i mjeteve të pagesës | <input type="checkbox"/> Rrëmbimi i mjeteve fluturuese /anijeve |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i substancave hormonale dhe i stimuluesve të tjerë të rritjes Nxitësit | <input type="checkbox"/> Sabotimi |

➔ Për rrjedhojë, vepra penale përfshin nenin 2 paragrafi 2 të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA-> nenin 4 paragrafi 1 (për rastet urgjente) dhe nenin 4 paragrafi 3 (për rastet jo urgjente) të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA që janë rrjedhimisht të zbatueshme për sa i përket afateve kohore për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë

Ose

B — Veprat penale që nuk përfshihen nën A. Në këtë rast, përshkrimi i veprave penale është si në vijim:

Qëllimi për të cilin kërkohet informacioni ose shërbimi informativ

Qëllimet e shërbimit informativ të vetëm kësaj faze, si pjesë e hetimit financiar të aseteve në pronësi të të pandehurve

Lidhja ndërmjet qëllimit për të cilin kërkohet informacioni ose shërbimi informativ dhe personit i cili është objekt i informacionit ose shërbimit informativ

Për sa i përket dënimit, personat do të jenë objekt i masave të konfiskimit, prandaj kërkohet profili financiar i aseteve të tyre.

Identiteti (aq sa njihet) i personave që janë objekti kryesor i hetimit penal ose i operacionit të inteligjencës kriminale që i nënshtrohen kërkesës për informacion ose shërbim informativ

Max RUSU, datëlindja 04/12/1965,
shtetësia, numri i kartës së identitetit
numri i pasaportës, adresa

Vadim SANDU, datëlindja , 18/12/1965,
shtetësia, numri i kartës së identitetit,
numri i pasaportës, adresa

Arsyet për të besuar që informacioni ose shërbimi informativ ndodhet në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa

Pas arrestimit të RUSU u krye një kontroll në shtëpinë e tij. Nga dokumentacioni i sekuestruar, tregohet se RUSU është aksionar i shoqërisë Madame Blanc R.S.J, e regjistruar në Francë.

Siç edhe dyshohej të dy meshkujt janë të përfshirë në pastrimin e të ardhurave nga veprimtaritë e trafikimit të lëndëve narkotike. Gjurmimi i aseteve është kërkuar të kryhet në Francë për të dy të pandehurit.

Kufizimet në përdorimin e informacionit që përmban kjo kërkesë për qëllime të tjera nga ato për të cilat është vënë në dispozicion ose për parandalimin kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe serioze të sigurisë publike

- lejohet përdorimi
 lejohet përdorimi, por nuk përmendet personi që ka dhënë informacionin
 nuk lejohet përdorimi pa autorizimin e personit që ka dhënë informacionin
 nuk lejohet përdorimi

Kërkohet me urgjencë

Nuk kërkohet me urgjencë

Arsye për urgjencë (p.sh. të dyshuarit po mbahen nën arrest, dhe rasti duhet të shkojë në gjykatë para datës së caktuar):

Informacioni ose shërbimi informativ i kërkuar

Kërkesë për kontroll në të gjithë regjistrat dhe bazat e të dhënave për aseteve në pronësi të të dy të pandehurve.

Informacioni që kërkohet për çdo aset, për shembull pasuri të paluajtshme, automjete, llogari financiare dhe shoqëri.

Në veçanti, kërkohet që të bëhet një kontroll në Shoqërinë Madame Blanc R.S.J, e regjistruar në Francë, pasi shërbimi informativ tregon që RUSU është aksionar i kësaj Shoqërie. Ju lutemi jepni detaje për Drejtorët dhe Sekretarët e shoqërisë, mallrat që tregton shoqëria dhe xhiron vjetore të saj.

Shteti Anëtar i BE-së për një Juridiksion jashtë BE-së

ARO-të e BE-së mund të bëjnë kërkesa për gjurmimin e aseteve nëpërmjet Oficerit Ndërlidhës të Europol-it në të gjitha shtetet anëtare të RAI të Ballkanit jashtë BE-së. Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së "Nisma Suedeze" nuk zbatohet për shtetet e treta. Megjithatë, si një praktikë e mirë, Shtetet Anëtare të BE-së, gjatë përgatitjes dhe përgjigjes së një kërkesë për gjurmimin e aseteve, mund të përdorin formatet e parashikuara në Shtojcën A (përgjigje nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa) ose Shtojca B (hetim nga shteti i cili dërgon kërkesën) të Nismës Suedeze, ose të ndiqni strukturat e përshkruara në Shtojcën A dhe B të Nismës Suedeze për t'u garantuar që kërkesa të përmbajë të paktën informacionin e përshkruar në këto formate tip (shih Shtojcën). Platforma e shkëmbimit të informacionit të Europol-it, SIENA, lidh në mënyrë elektronike Shtetet Anëtare të BE-së me shtetet e treta që kanë qasje në sistem. Kërkesat për gjurmimin e aseteve mund të shkëmbehen në mënyrë të sigurt dhe të shpejtë. Një numër oficerësh ndërlidhës të Europol-it nga juridiksionet e Ballkanit, tashmë kanë akses në sistemin SIENA, për ofrimin e një platformë të sigurt për shkëmbimin e kërkesave për gjurmimin e aseteve.

Nga një Juridiksion jashtë BE-së për Shtetet jashtë BE-së

Gjatë kryerjes së hetimeve jashtë kuadrit ligjor dhe institucional të BE-së, kanali më i zakonshëm i përdorur për gjetjen e aseteve është Interpoli. Megjithatë, para se të dërgojnë një kërkesë nëpërmjet Byrosë Kombëtare Qendrore të Interpolit, juridiksionet të cilat dërgojnë kërkesën këshillohen që të kryejnë një hetim fillestar duke përdorur kanalet CARIN/ARIN që tregojnë se kërkesa do të dërgohet. Kërkesat duhet të shënohen qartë, në vëmendjen e kontaktit të kërkuar të CARIN/ARIN

5.4. Shembull i Rastit B: Përdorimi i CARIN dhe i ARIN-ve të tjerë për Zhvillimin e Kërkesave për Gjurmimin të Aseteve

Ju jeni hetuesi financiar që kryen hetimin financiar në veprimtaritë e Max RUSU dhe bashkëpunëtorit të tij Vadim SANDU, (të dy qytetarë të vendit tuaj) të dyshuar për trafik droge dhe pastrim parash.

Gjatë hetimit penal është kryer një kontroll në shtëpinë e SANDU-së. Një numër fletë hyrjesh të linjave ajrore me destinacion Australinë u sekuestruan gjatë kontrollit. Të gjitha kanë të shënuar emrin e SANDU-së si pasagjer. Kishte gjithashtu një numër fotografish të Vilave luksoze Australiane me automjete të shtrenjta të parkuara në rrugicën private.

Ky hetim po kryhet në fazën e pas arrestimit ku të dy personat janë në lirim me kusht duke pritur vendimin e gjyqit.

Gjykuar nga këto rrethana ju keni dyshime që SANDU udhëton shpesh për në Australi dhe ka disa tregues se ai mund t'i ketë investuar në këtë shtet ato çfarë ka përfituar nga trafikimi i drogës.

Kërkesë me Email nga grupi hetimor për kontaktin e tyre të CARIN-it:

Email nga: [Emri juaj]

Për: [Kontakti juaj i CARIN-it]

Data: [xx/xx/xx]

Subjekti: CARIN Hetim për Gjurmimin e Aseteve në Australi - Numri i Referencës xxxx

I nderuar [Kontakti juaj në CARIN]

Unë quhem [xxxx] dhe punoj në [xxx] departamenti i [xxxx]. Të dhënat e mia të kontaktit janë [xxxx].

Aktualisht jam duke kryer një hetim financiar në lidhje me dy meshkuj të dyshuar për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike dhe për pastrim parash. Hetimi është në fazën e pas-arrestimit.

Pas marrjes së dokumenteve të gjetura gjatë një kontrolli në pronë, kam informacione nga shërbimi informativ që dëshmojnë se asetet e një prej të dyshuarve janë investuar në Australi.

Prandaj unë dëshiroj të dërgoj **një kërkesë për gjurmimin e aseteve** tek autoritetet në Australi për të kontrolluar në bazën e të dhënave të tyre, veçanërisht në lidhje me pasuritë e paluajtshme, llogaritë bankare dhe automjetet.

Lutemi, mund ti drejtoheni pikës së kontaktit të CARIN në Australi për tu këshilluar në lidhje me mënyrën më të përshtatshme për dërgimin e kësaj kërkesë dhe kujt duhet ti dërgohet?

Përgjigja nga Kontakti i CARIN në shtetin i cili drejton kërkesën tek grupi hetimor:

Email nga: [Kontakti juaj i CARIN-it]

Për: [Emri juaj]

Data: [xx/xx/xx]

Subjekti: Përgjigje: CARIN Hetim për Gjurmimin e Aseteve në Australi Numri i Referencës xxxx

I nderuar [Emri juaj]

Shih më poshtë përgjigjen nga [Kontakti Australian i CARIN-it] për rastin ref: xxxx

I nderuar [Kontakti juaj në CARIN]

Zyra jonë Kombëtare për Konfiskimin e Aseteve në Canberra merret me hetimet e gjurmimit të asetëve nga juridiksionet e huaja.

Pasuritë e paluajtshme dhe Automjetet:

Ne nuk kërkojmë një kërkesë zyrtare nga Ndihma e Ndërsjellë Ligjore për kërkesat e gjurmimit të asetëve në lidhje me pasuritë e paluajtshme ose automjetet. Dërgoni kërkesën tuaj nëpërmjet Interpol NCB Australia, e shkruar në vëmendje të Z. xxxx, (numri i telefonit/adresa e emailit) Grupi i Gjurmimit të Asetëve, Zyra Kombëtare për Konfiskimin e Asetëve, Canberra.

Ju duhet të prisni një përgjigje brenda një muaji. Nëse kërkesa është urgjente, ju lutemi shënoni qartë 'URGJENT' dhe më kontaktoni menjëherë sapo t'ia dërgoni atë Interpol NCB. Ju garantoj se do t'i jepet prioritet.

Llogaria Bankare:

Për më shumë informacion në lidhje me ekzistencën e llogarive bankare, ju lutem përdorni kanalën FIU. Megjithatë, ju kërkohet të dërgoni një kërkesë për Ndihmë të Ndërsjellë Ligjore nëpërmjet Autoritetit tonë Qendror për informacione mbi çdo transaksion financiar që lidhet me një llogari në Australi.

Me Respekt

[Kontakti australian i CARIN-it]

5.5. Shembull i Rastit C: Një kërkesë nga Interpoli për Gjurimin e Aseteve

Kërkesa e Interpolit

DATA dhe ORA e Kërkesës

22/11/2016 në 14:40

NGA

Autoriteti që dërgon kërkesën [Emri i Agjencisë suaj]

Emri: [Emri Juaj]

Autoriteti [Agjencia Juaj]

Të Dhënat e Kontaktit [Adresa e Agjencisë, telefoni, numri i faksit dhe emaili juaj]

Numri i Referencës [Numri i referencës së Agjencisë suaj për kërkesën]

DREJTUAR:

Juridiksioni të cilit i drejtohet kërkesa: Australia

Autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa: Zyra Kombëtare për Konfiskimin e Aseteve, Canberra.

Në Vëmendje të: Z. xxxx, (numri i telefonit/ adresa e emailit) Grupi i Gjurimit të Aseteve

Vepra Penale: Dyshime për Trafikim Droge dhe Pastrim Parash

Subjektet:

1.

Emri: Max RUSU

I njohur ndryshe si: Nuk ka

Datëlindja 04/12/1965

Shtetësia:

Adresa më e fundit që dihet: [Emri dhe Numri i Ndërtesës, Emri i Rrugës, Qyteza, Qyteti, Kodi postar, Shteti]

Adresa e Mëparshme:

Numri i Pasaportës:

Numri i Kartës së Identitetit

2.

Emri: Vadim SANDU

I njohur ndryshe si: Nuk ka

Datëlindja 18/12/1965

Shtetësia:

Adresa më e fundit që dihet: [Emri dhe Numri i Ndërtesës, Emri i Rrugës, Qyteza, Qyteti, Kodi postar, Shteti]

Adresa e Mëparshme:

Numri i Pasaportës:

Numri i Kartës së Identitetit

KËRKESË: Kërkesë për gjurmimin e çdo aseti ose pasurie në pronësi ose të kontrolluar nga subjektet 1 & 2 për ndalimin dhe konfiskimin e tyre në vazhdim. Nëse identifikohet ndonjë aseti, një kërkesë për MLA do të dorëzohet nëpërmjet Autoritetit Qendror në Australi, për të përdorur informacionin për qëllime provash.

Max RUSU dhe bashkëpunëtori i tij Vadim SANDU kanë qenë objekt i një hetimi të gjatë nga [emri i agjencisë ose autoritetit dhe shtetit] lidhur me importimin dhe shpërndarjen e sasive të mëdha të kokainës në [vendin tuaj] dhe pastrimin e të ardhurave nga veprimtaritë kriminale midis janarit 2017 dhe majit 2019. Më 01/06/2019 të dy subjektet u akuzuan për trafik droge dhe pastrim parash dhe aktualisht janë nën arrest në pritje të gjykimit që do të zhvillohet më 01/09/2019.

Gjykata ka lëshuar një urdhër ndalimi në lidhje me dy të pandehurit, në pritje të hetimit të konfiskimit. Për të identifikuar çdo aktiv, Zyra e Rikuperimit të aseteve po kryen aktualisht një hetim financiar në gjendjen financiare të Max RUSU dhe bashkëpunëtorit të tij Vadim SANDU për të konstatuar shumën e rikuperueshme bazuar në veprimtarinë e përgjithshme kriminale të të pandehurit.

Gjatë hetimit penal u krye një kontroll në shtëpinë e SANDU-së. Një numër fletë hyrjesh të linjave ajrore me drejtim Sidnej, Australi u sekuestruan gjatë kontrollit. Të gjitha kanë të shënuar emrin e SANDU-së si pasagjer. Kishte gjithashtu një numër fotografish të Vilave luksoze Australiane me automjete të shtrenjta të parkuara në rruginë (bashkangjitur fotot).

Meqenëse SANDU udhëton shpesh për në Australi, dyshohet se SANDU dhe/ose RUSU mund të kenë investuar në shtetin tuaj fitimet e nxjerra nga trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave.

Kërkohet të kryhet një kontroll i të gjitha bazave të të dhënave dhe regjistrave të disponueshëm për të identifikuar nëse ndonjë nga këta subjekte zotëron asete në Australi, veçanërisht në lidhje me pasuritë dhe automjetet.

Gjurmimi dhe identifikimi tashmë i kryer i aseteve duke përdorur mundësitë e ndihmës së ndërsjellë ligjore (MLA) paraprake, për shembull, CARIN-in, ARO-të ose Interpolin, marrëveshjen për ndihmën e ndërsjellë ligjore në lidhje me kërkesat duhet të përdoren për të marrë informacion zyrtarisht për vendndodhjen e tyre. MLA-ja duhet përdorur për marrjen e informacionit më të detajuar në lidhje me lokalizimin dhe shumën e aseteve në rastet ku kërkohet marrja e masave shtrënguese si kërkimet për vendin dhe aksesin në financa apo informacione të tjera, nëpërmjet urdhërave të nxjerrë.

6. Grupet e Përbashkëta Hetimore (JIT-et)

Standardet Ndërkombëtare kanë njohur vlerën e formimit të grupeve të përbashkëta hetimore (JIT) për qëllimet e hetimeve ndërkufitare. Kjo është veçanërisht e dobishme kur një krim apo grup i krimit të organizuar prek juridiksione të shumëfishta. Shënimi shpjegues 16 i Rekomandimit 40 të FATF për bashkëpunimin ndërkombëtar sugjeron që autoritetet e zbatimit të ligjit duhet të jenë në gjendje të formojnë grupe të përbashkëta hetimore për të kryer hetime bashkëpunuese. Deri kohët e fundit, JIT-et në përgjithësi formoheshin vetëm për hetime të mëtejshme penale. Aspekti financiar i një hetimi shpesh harrohej ose nuk përfshihej në marrëveshjet e JIT. Kjo po fillon të ndryshojë dhe juridiksionet e Ballkanit do të përfitonin nga ndjekja e trendit për të garantuar që hetimet financiare me qëllim rikuperimin e aseteve do të përfshiheshin në çdo marrëveshje të JIT.

Ky kapitull jep informacion në lidhje me Grupet e Përbashkëta Hetimore për Shtetet Anëtare të BE-së dhe shtetet e treta, në kontekstin e dispozitave të përcaktuara në Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së të 13 qershorit 2002 (2) për Grupet e Përbashkëta Hetimore dhe Rezolutën e Këshillit mbi një marrëveshje model për ngritjen e një Grupi të Përbashkët Hetimor (JIT) (2017/C 18/01)

Çfarë është një JIT?

Një grup i përbashkët hetimor (JIT) është një grup ndërkombëtar i formuar nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët nga autoritetet kompetente të së paktën dy Shteteve Anëtare të BE-së, për hetimin e një çështjeje penale ndërkombëtare. Një JIT mund të përfshijë edhe përfaqësues nga shtetet jashtë BE-së, të përmendura si shtete të treta.

Shtetet Anëtare të përfshira në krijimin e një JIT-i vendosin për përbërjen, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij. Anëtarët e JIT-it nga shtete të ndryshme nga shteti në të cilin grupi kryen operacionin e tij, përmenden si "të deleguar" në grup. Ata mund të kryejnë detyra në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar në të cilin grupi vepron.

JIT-et nuk zëvendësojnë ose ndryshojnë legjislacionin kombëtar dhe nuk e zëvendësojnë bashkëpunimin me anë të letrave të kërkesës. Megjithatë JIT-ti është një instrument i fuqishëm dhe efektiv për të mundësuar një bashkëpunim të qetë dhe të lehtë kur:

- Një ndjekje penale kombëtare kërkon hetime të vështira dhe intensive duke përfshirë lidhjet me Shtetet e tjera Anëtare.
- Një numër i Shteteve Anëtare po kryejnë hetime për veprat penale për të cilat natyra e çështjes u kërkon këtyre shteteve të nisin veprime të përbashkëta dhe të koordinuara në Shtetet Anëtare të përfshira.

Një JIT u mundëson anëtarëve të saj:

- të ndajnë informacionin me njëri-tjetrin drejtpërdrejt pa nevojën e kërkesave të shumta formale për ndihmë të ndërsjellë ligjore.
- të kërkojnë masa hetimore drejtpërdrejt ndërmjet anëtarëve të grupit, duke përjashtuar nevojën e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë ligjore. Kjo zbatohet edhe për kërkesat për masa shtrënguese
- të jenë të pranishëm përgjatë kontrolleve të shtëpive dhe intervistave brenda të gjitha juridiksioneve të përfshira, duke ndihmuar në tejkalimin e barrierave gjuhësore.
- të bashkërendojnë përpjekjet në terren dhe të shkëmbejnë informacione në mënyrë informale
- të krijojnë besim të ndërsjellë ndërmjet praktikuesve nga juridiksionet e ndryshme që punojnë së bashku dhe të vendosin për strategjitë hetimore dhe ato të ndjekjes penale
- të marrin mbështetje dhe ndihmë të drejtpërdrejtë nga Europol-i dhe Eurojust-i
- sigurimin e fondeve të mundshme.

Përfshirja e Shteteve të Treta në një JIT të BE-së

Ndonjëherë JIT-i përfshin një shtet të tretë (një vend jashtë Bashkimit Evropian). Kjo është e mundur kur ka një bazë ligjore ekzistuese për bashkëpunim midis Shtetit ose Shteteve Anëtare të veçanta dhe shtetit të tretë. Kjo bazë ligjore për JIT-in mund të marri formën e:

- Një instrumenti ligjor ndërkombëtar
- Një marrëveshje dypalëshe
- Një marrëveshje shumëpalëshe
- Legjislacionit kombëtar.

Shembujt e një baze të përshtatshme ligjore për një JIT ndërmjet një Shteti Anëtar të BE-së dhe një vendi të tretë përfshijnë:

- Protokollin i Dytë Shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale të 20 Prillit 1959 (neni 20)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 15 nëntor 2000 (neni 19);
- Konventa për ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin ndërmjet administratave doganore (Konventa II e Napolit), 18 dhjetor 1997 (neni 24)
- Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (PCC SEE) 5 maj 2006 (neni 27).

Kur përdoret JIT-i

Nuk ka një rregull të thjeshtë se kur të duhet të ngrihet një JIT ose kur duhet të përdoren metodat tradicionale të bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet shteteve.⁶

⁶ Legjislacioni dhe Manuali i JIT-it i hartuar nga Eurojust dhe Europol përmban rekomandime të zgjeruara rreth kohës se kur duhet krijuar një JIT.

Pasi të ekzistojë një marrëveshje JIT, nuk ka asnjë kërkesë për të dërguar vazhdimisht kërkesat për MLA ndërmjet shteteve për bashkëpunim. Marrëveshja ofron një bazë ligjore të përgjithshme për një numër hetimesh që duhet të kryhet, duke përfshirë hetimet financiare nëse kjo është e përcaktuar në marrëveshje. Ajo ofron një kuadër për juridiksionet për të punuar me një çështje penale specifike për një qëllim të caktuar. JIT-et prandaj shpesh janë alternativa më e mirë për hetime më serioze dhe komplekse, të cilat kërkojnë koordinim të shpejtë dhe të qetë dhe shkëmbimin e shumë dosjeve, dokumenteve dhe ndoshta dëshmime të një periudhë më të gjatë kohore. Zakonisht nuk ndodh të përdoret një JIT për një çështje që kërkon një ose dy veprime hetimore në një shtet tjetër brenda disa javëve.

Struktura e një JIT-i

Për shkak të natyrës së tyre ndërkombëtare, JIT-et kanë karakteristika të veçanta të cilat dallojnë nga tiparet e hetimeve kombëtare dhe e bëjnë më të lehtë kryerjen e një hetimi ndërkombëtar. Kjo vlen posaçërisht për shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave, në trajtimin dhe aksesin tek provat, në mënyrën se si JIT-et vlerësohen pas përfundimit dhe në mënyrën se si financohen ato.

JIT-et në operacion

Gjatë fazës operacionale së një JIT-i, shkëmbimi i informacionit ndërmjet anëtarëve nga juridiksionet e ndryshme zhvillohet në të njëjtën bazë siç do të zhvillohej nëse të gjithë personat e përfshirë do të ishin nga e njëjti juridiksion. Personat nga juridiksione të ndryshme ndajnë me njëri-tjetrin informacione, që e kanë origjinën në shtetet e tyre. Kërkesat tradicionale për ndihmë të ndërsjellë ligjore (MLA) nuk duhet të lëshohen për të marrë informacion nga një anëtar i deleguar i grupit.

Baza ligjore që u lejon anëtarëve të deleguar t'i sigurojnë JIT-it informacione, të cilat janë të disponueshme në juridiksionin e tyre, është përcaktuar në nenin 1 paragrafi 9 të Vendimit Kuadër për JIT-et dhe nenin 13 paragrafi 9 të Ndihmës së Ndërsjellë Ligjore (MLA) në Konventën: "Një anëtar i grupit të përbashkët hetimor, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit të tij dhe brenda kufizimeve të kapacitetit të tij, mund t'i japë grupit informacionin që disponon Shteti Anëtar i cili e ka deleguar atë, për qëllimin e hetimeve penale të kryera nga grupi". Legjislacioni kombëtar luan ende një rol të rëndësishëm për të përcaktuar nëse është e mundur që një anëtar i një JIT-i t'i japi grupit informacione që burojnë nga juridiksioni i tyre. Një anëtar i grupit mund të shkëmbejë informacione vetëm për aq kohë sa kjo është e mundur sipas legjislacionit kombëtar të juridiksionit të tyre dhe brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni i tyre.

Një kusht i dytë i parashikuar në nenin 1, paragrafi (9), i Vendimit Kuadër për JIT-të dhe nenin 13 paragrafi (9), i Konventës së MLA-së është se informacioni nga vendi i origjinës mund të shkëmbehet vetëm me anëtarët e tjerë të JIT-it për aq kohë sa informacioni është në dispozicion të vendeve anëtare të deleguara.

Në përgjithësi, agjencitë e zbatimit të ligjit në BE kanë akses në nivel kombëtar për informacionin nga burime të ndryshme publike dhe private, për përmbushjen e detyrave të tyre. Ky akses në informacion është parashikuar në mënyrë specifike me ligj ose garantohet nga një marrëveshje e përgjithshme midis agjencive ligjzbatuese. Në disa raste akses mundësohet nëpërmjet një urdhri gjykatë. Gjatë një JIT-i, ky informacion, që është shumë i rëndësishëm gjatë gjurmimit të aseteve për konfiskim, ndahet më lehtësisht ndërmjet juridiksioneve.

Burimet mbështetëse për krijimin e një JIT-i

Në rastet kur konsiderohet krijimi i një JIT-i ndihma dhe informacioni janë të disponueshme nga burime të ndryshme.

Hetuesit dhe prokurorët mund të kontaktojnë **Ekspertin Kombëtar të JIT-it**, duke ofruar ndihmë përmes njohurive dhe përvojës që kanë fituar në JIT-et e mëparshme. Të gjitha shtetet anëtare, të cilat kanë ratifikuar Konventën e MLA-së në maj të vitit 2000, kanë caktuar një ose më shumë Ekspertë Kombëtarë për JIT-et. Përveç kësaj, Europol-i, Eurojust-i, OLAF-i, Komisioni Evropian dhe Këshilli Evropian kanë caktuar pikat e kontaktit kompetente për çështjet që lidhen me JIT-et. Meqenëse, objektivi kryesor i përcaktimit të Ekspertëve Kombëtar në JIT-e është lehtësimi i punës së praktikuesit në Shtetet Anëtare, ekspertët përzgjidhen nga organet e zbatimit të ligjit, prokuroritë dhe/ose autoritetet gjyqësore. Ekziston gjithashtu një Rrjet i Ekspertëve Kombëtarë për JIT-et (**Rrjeti i JIT-eve**) Rrjeti, i përbërë prej të paktën një eksperti për një Shtet Anëtar, promovon përdorimin e JIT-eve duke ndihmuar në lehtësimin e krijimit të grupeve të përbashkëta, duke ndihmuar në ndarjen e përvojave dhe praktikave më të mira, duke trajtuar aspektet operacionale, financiare dhe ligjore të një JIT-i. Këta ekspertë mund të ndihmojnë praktikuesit në krijimin e grupit të JIT-it duke komunikuar me njëri tjetrin në mënyrë që të lehtësojnë procesin. **Sekretariati i Rrjetit të JIT** pranë Eurojust-it menaxhon dhe mban listën e të gjithë ekspertëve kombëtarë të JIT-eve në secilin Shtet Anëtar. Në bazë të kërkesës, Sekretariati i Rrjetit të JIT-ve është në gjendje t'ju ofrojë detajet e kontaktit të Ekspertëve Kombëtar të JIT-it në juridiksionin tuaj. Kontakti me Sekretariati i Rrjetit të JIT mundësohet nëpërmjet kësaj faqe zyrtare JITsNetworkSecretariat@eurojust.europa.eu

Europol-i dhe Eurojust-i mund të ofrojnë këshilla dhe ekspertizë ligjore si dhe lehtësira për takime dhe interpretime për Shtetet Anëtare. Si Eurojust-i ashtu edhe Europol-i mund të ofrojnë financime në kuadër të takimeve operacionale paraprake në funksion të krijimit të një grupi JIT. Ata mund të ofrojnë ekspertizë të fituar nga pjesëmarrja e mëparshme në JIT-e dhe të ndihmojnë në hartimin, ndryshimin dhe zgjerimin e marrëveshjes për JIT-in.

Marrëveshja për krijimin e JIT

Marrëveshja JIT është një dokument ligjor i nënshkruar nga të gjitha juridiksionet pjesëmarrëse. Për ti ardhur në ndihmë juridiksioneve për të përfunduar marrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe standarde të JIT-it, është hartuar një **marrëveshje JIT Tip** i cili mund të gjendet në shtojcën e bashkëlidhur. **Manuali i JIT** parashikon të gjithë informacionin e duhur për juridiksionet në lidhje me krijimin e një grupi funksional JIT. Ky manual është i disponueshëm në faqet zyrtare të Eurojust-it dhe Europol-it:

<https://www.europol.europa.eu/activities-services/joint-investigation-teams> i

<http://www.eurojust.europa.eu/Practitioners/JITs/Pages/JITs-sitemap.aspx>

Marrëveshja Tip është një model i cili siguron një listë të plotë të të gjitha kushteve për krijimin e një JIT-i. Një Plan Operacional Veprimi (OAP) dhe një listë e plotë e kushteve të OAP-së gjendet në Shtojcën IV të Marrëveshjes Tip. Një model përfshihet gjithashtu në Marrëveshjen Tip për nënshkrimin me palë të treta. Marrëveshja Tip dhe shtojcat janë në dispozicion në të gjitha gjuhët e BE-së.

7. Gjurmimi i asetëve në juridiksionet offshore

7.1. Çfarë nënkupton një Juridiksion i një territori Parajse Fiskale

Termi “offshore” shpesh keqinterpretohet dhe keqpërdoret me konotacion negativ i lidhur përgjithësisht me strehat fiskale të pozicionuara veçanërisht në vende ekzotike si Ishujt e Virgjër Britanikë. Ishujt Kajman dhe Sejshell. Në fakt, një biznes “offshore” ka të bëjë me sipërmarrje tregtare nga persona jo rezidentë jashtë juridiksionit të vendit të tyre, dhe mund të nënkuptojë juridiksionin i një territori sovran apo vendi me strukturë ligjore dhe organe qeverisëse të veçanta. Atëherë teorikisht një shoqëri offshore mund të ekzistojë në çdo vend apo juridiksion nëpër botë dhe jo domosdoshmërisht të jetë shoqëri rezidente në vendet e parajsës fiskale. Kështu për shembull një individ apo shoqëri rezidente në Spanjë apo Francë mund të konsiderojnë vendet si Luksemburgu, Lihtenshtajnit ose Zvicrës si vende me juridiksion offshore.

Pse përdoren Juridiksionet Offshore?

Shërbimet financiare të ofruara nga organizatat financiare dhe shoqëritë në juridiksionet offshore përdoren në mënyrë të ligjshme për të ofruar shërbime ligjore për personat të cilët kanë detyrim të zbatojnë ligjin ose shoqëritë që mund të dëshirojnë të kërkojnë mbrojtjen e asetëve të tyre, të përfitojnë nga mundësitë e shpenzimeve fiskale të limituara, të kenë akses në infrastrukturë bankare më të mirë, të përmbushin kërkesat ligjore vendase në rastin e blerjes së një prone, ose në rast kur kërkojnë privatësi dhe siguri financiare.

Personat ose organizatat e angazhuara në veprimtari të paligjshme ose veprimtari kriminale kanë kërkuar historikisht të shfrytëzojnë juridiksionet offshore dhe të abuzojnë nga subjektet ligjore apo strukturat korporative për përfitime të tilla si evazioni fiskal ose mashtrimi tatimor, fshehje të të ardhurave nga krimi ose korrupsioni, pastrimin e parave nga aktiviteti tregtar ose fshehje të pasurisë nga agjencitë shtetërore, nga bashkëpunëtorët e biznesit ose nga anëtarët e familjes. Përfitimet shtesë nga mungesa e rregulloreve, privatësia bankare dhe ligjeve komplekse që mbrojnë identitetin e pronësisë përfituese, kanë inkurajuar më tej dhe e kanë lehtësuar një aktivitet të tillë.

Rregulloret

Vendet offshore kanë juridiksionet e veta të rregulluara dhe shoqëritë tregtare në këto vende të cilat ofrojnë shërbime financiare si bankat, shoqëritë e trusteve, shoqëritë tregtare ndërkombëtare (IBC-të) dhe ofruesit e shërbimit të korporatave (CSP-të) janë subjekte që funksionojnë në përputhshmëri me ligjin dhe rregulloret e parandalimit dhe pastrimit të parave. Gjatë kryerjes së një kërkimi ose një hetimi që lidhet me një juridiksion offshore mund të kërkohet informacion i hapur për të përcaktuar natyrën e strukturave të korporatave, legjislationin dhe rregulloret dhe në varësi të rrethanave, gjithashtu duhet të kërkohet bashkëpunimi i Njësisë së Inteljencës Financiare FIU-t vendore ose bashkëpunim me përfaqësuesit e ARIN-it.

7.2. Trustet

Keqpërdorimi i subjekteve ligjore tregtare nga persona të përfshirë në aktivitete ilegale apo kriminale mund të shfaqet në forma të ndryshme. Trusti është një shembull i cili përdoret gjerësisht nga këta persona me qëllim fshehjen apo maskimin e asetëve dhe gjenerimin e pasurisë nga një aktivitet i tillë. Natyrisht ka shumë mënyra të tjera, të cilat mund të përfshijnë Fondacionet, por ka shumë të ngjarë që kur të hetohet krimi ndërkombëtar dhe rrjedhja e fondeve mund të zbulohet se ekziston një Trust ose një numër Trustesh brenda strukturave komplekse të korporatave.

Çfarë është Trusti?

Një Trust është një marrëveshje ligjore e themeluar kryesisht sipas “common law” ku disa persona (të ashtuquajturit të mirëbesuarit) zotërojnë pronësinë e cila sjell përfitime për të tjerët (të quajtur përfituesit). Një Trust themelohet me anën e një dokumenti i cili përcakton rregullat e funksionimit të Trustit i cili quhet Deklarata e Mirëbesimit. Ky dokument nënshkruhet nga personat të cilët kanë vendosur asetet e tyre në Trust (të quajtur Themeluesit të Trustit) dhe të mirëbesuarit. Ky mekanizëm ligjor ka në zotërim titullin e pronësisë tek asetet dhe prona, menaxhon asetet në fjalë në përputhje me nevojat e trustit, në mënyrë që të gjenerojë një seri përfitimesh dhe të shpërndajë përfitimet tek një person apo grup personash të përcaktuar si përfitues. Pasi asetet të transferohen tek të mirëbesuarit, themeluesi i trustit humbet pronësinë ligjore të asetëve të transferuara. Të mirëbesuarit mund të bëhen zotëruarit ligjorë me detyrimin që të veprojnë në interesin më të mirë të të përfituesve dhe në përputhje me Deklaratën e Mirëbesimit. Përfituesit janë të vetmit të cilët gëzojnë të drejtën të përfitojnë nga asetet e trustit.

I mirëbesuari dhe/ose shoqëria e trustit me detyrën e menaxhimit të trustit janë të detyruar sipas detyrimit të mirëbesimit të respektojnë marrëveshjen. Me nënshkrimin e këtij dokumenti palët bien dakord të respektojnë rregullat dhe kërkesat e përcaktuara nga deklarata e mirëbesimit. Trusti është i ndryshëm nga korporata apo fondacioni. Ky lloj trusti është një marrëveshje me shkrim për të mirëbesuarin që të plotësojë detyrimet ndaj përfituesve dhe të mbrojë asetet nga grabitqarët.

Arsyeja pse se këto truste offshore gjenden pothuajse gjithmonë në vendet e parajsës fiskale ose në juridiksionet e vendeve që mbrojnë asetet, është se këto vende njihen pikërisht për ruajtjen e asetëve dhe nivelin e pacenueshëm të privatësisë, dhe trusti në vendet e parajsës fiskale përfiton pikërisht nga këto karakteristika. Asetet e menaxhuara brenda trusteve në vendet offshore, janë kryesisht të çliuara nga barrat ndonjëherë mbytëse ligjore ose fiskale, të zbatueshme këto në vendin e origjinës ose në juridiksionin e themeluesit të trustit. Nëse trusti është themeluar me qëllim përfitimin e themeluesit të trustit dhe/ose bashkëshortit (-es), fëmijëve apo trashëgimtarëve të tjerë të themeluesit, në rastin në fjalë, trusti në vendet offshore ofron një parajsë në lidhje me shmangien e hetimeve skrupuloze të pasurisë dhe taksave të larta.

Vendet e parajsës fiskale kanë si tipar mbrojtjen e asetëve brenda kësaj strehe të sigurt, dhe trustet në vendet e parajsës fiskale ofrojnë privatësi të pacënuar, mbrojtje të lartë ndaj rreziqeve nga

paditë civile gjyqësore dhe madje edhe nga raste si divorci apo shkrirjet e biznesit. Këto juridiksione offshore përdoren gjithashtu nga shumë persona për mbrojtjen e asetëve në rast trazirash politike ose ekonomike në juridiksionin e vendit të tyre. Është jashtëzakonisht e vështirë, përveç rasteve të akuzave për një vepër të rëndë penale, që një subjekt i jashtëm të çajë mburojën e privatësisë që ka një trust i themeluar në vendet e parajsës fiskale nga ana e pjesës më të madhe të juridiksioneve.

Trustet offshore shpesh formohen në këto streha fiskale me taksa të ulëta ose në këto parajsë të sigurta për asetet, juridiksionet e të cilave kanë një reputacion të sprovuar për menaxhimin dhe ekzekutimin e suksesshëm të trusteve dhe fondeve të besimit. Megjithatë, nuk është absolutisht e domosdoshme që një vend i përshtatshëm të jetë një parajsë fiskale ose të ketë rregullore toleruese fiskale; shumë prej juridiksioneve të suksesshme ku themelohen trustet thjesht ofrojnë shoqëri trustesh të mirënjohura dhe me përvojë, me tipar kryesor ruajtjen e pacenueshme të privatësisë dhe me mbrojtje ligjore të konsiderueshme për asetet. Një emërues i përbashkët është se këto juridiksione i mbështesin themelimin e këtyre trusteve, rregulloret dhe statutet e tyre të brendshme në "common law"-n anglez: kjo sepse ideja e formimit të trustit është një formë organizimi e vjetër angleze që daton nga koha e Kryqëzatave. Juridiksionet e tjera evropiane që ofrojnë administrim të suksesshëm të trustit, si Luksemburgu, Malta, Zvicra etj., kanë përshtatur statutet dhe rregulloret e tyre në përputhje me modelet e duhura të administrimit të trusteve, të bazuara në "common law"-n anglez.

Në varësi të natyrës së asetëve që vendosen në trust, i mirëbesuari mund të përfshijë shoqëri tek të cilat do të vendosë asetet për arsye të detyrimeve ligjore të kufizuara, taksave ose për arsye gjeografike. Si rrjedhojë, është plotësisht e mundshme që mund të ketë një numër të konsiderueshëm shoqëri (bashkë me dokumentacionin dhe bilancet e tyre), të cilat mund të gjenden nën kontrollin e shumë juridiksioneve të tjera. Atëherë është e rëndësishme të theksohet se për qëllime të çdo rasti hetimor, i mirëbesuari do të jetë personi kyç për tu pyetur ose tek i cili drejtohet kërkesa për paraqitje të të gjitha dokumenteve në lidhje me trustin dhe asetet.

Personat e përfshirë në veprimtari të paligjshme ose kriminale mund t'i përdorin trustet për të fshehur ose maskuar të ardhurat e tyre nga krimi apo për qëllime përfitimesh të tjera të paligjshme. Transferimi i pronësisë së asetëve të tyre në një trust të kontrolluar nga një i mirëbesuar, mund t'i sugjerojë një organi hetimor se personi ka pak ose aspak asete të rikuperueshme. Megjithatë, në varësi të legjislacionit të rikuperimit të asetëve të një vendi përkatës, asetet ende mund të rikuperohen gjatë procedurave penale ose civile kundër personit ose personave, bazuar në aftësinë për të vërtetuar prejardhjen e asetëve. Do të jenë autoritetet kompetente ato që do të zbatojnë juridiksionin përkatës përmes procesit gjyqësor për bllokimin dhe/ose rikuperimin e asetëve.

7.3. Llojet e informacioneve të mbajtura nga bizneset në Juridiksionet Offshore

Më poshtë paraqitet një listë e informacioneve dhe dokumenteve që zakonisht mbahen nga organizatat e poshtë përmendura dhe duhet të konsiderohen si informacione ose dëshmi të vlefshme si pjesë e çdo hetimi në procedurat penale ku kërkohet dëshmi financiare dhe/ose

parashikohet rikuperimi i pasurive. Kërkesat për informacione ose prova duhet të përshkruhen hollësisht në të gjitha kërkesat

Shoqëria e Trustit (Kur dihet se është themeluar një shoqëri e tillë)

- Kopjet e dokumenteve të Vigjilencës së Zgjeruar për themeluesin e trustit dhe secilin përfitues të njohur
- Kopje e Deklaratës së Mirëbesimit dhe çdo ndryshim
- Kopjet e të gjitha 'Letrave të Shprehjes së Vullnetit'
- Detajet e Administratorëve të mëparshëm dhe aktual
- Kopjet e Certifikatave të Aksioneve për shoqëritë e administruara/në pronësi të Trustit
- Kopje të Memorandumit dhe Aktit të Themelimit të secilës shoqëri

Përveç këtyre, për secilën prej këtyre shoqërive:

- Detajet e të gjithë Drejtorëve
- Kopjet e deklaratave bankare dhe mandateve bankare/formularëve të hapjes së llogarive
- Kopjet e të gjitha pasqyrave financiar
- Kopjet e formularëve MT 103 për të gjitha pagesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse
- Kopjet e të gjitha procesverbaleve të korporatës
- Kopjet e të gjitha shënimeve të dosjes
- Kopjet e korrespondencës elektronike dhe korrespondencës së Trustit dhe të gjitha shoqërive
- Kopjet e të gjitha dokumenteve, marrëveshjeve ose kontratave të tjera në lidhje me Trustin
- Një listë të tarifave të paguara për çdo vit për shërbimet e ofruara nga Administratori i Besuar

Ofruesi i Shërbimeve të Korporatave (Në çdo juridiksion ku nuk ka strukturë Trusti)

- Kopjet e dokumenteve të Vigjilencës së Zgjeruar, me detajet e pronarit ose pronarëve përfitues të fundit.
- Kopje të Certifikatës së Aksioneve
- Kopje të Memorandumit dhe Aktit të Themelimit

Përveç këtyre, për secilën shoqëri:

- Detajet e të gjithë Drejtorëve
- Emrin e plotë dhe adresën e Agjentit të Regjistruar
- Konfirmimin se shoqëria funksionon në "përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi" dhe se nuk ka tarifa/taksa të pashlyera
- Kopjet e deklaratave bankare dhe mandateve bankare/formularëve të hapjes së llogarive
- Kopjet e të gjitha pasqyrave financiare
- Kopjet e formularëve MT 103 për të gjitha pagesat ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse
- Kopjet e të gjitha procesverbaleve të korporatave
- Kopjet e të gjitha shënimeve të dosjes
- Kopjet e korrespondencës elektronike dhe korrespondencës së shkruar
- Kopjet e të gjitha dokumenteve, marrëveshjeve ose kontratave të tjera

7.4. Si duhet të arrihet Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Është e rëndësishme të dihet se procesi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndihma e ndërsjellë juridike nga një juridiksion offshore mbetet i njëjtë me çdo juridiksion tjetër. Secila kërkesë duhet të trajtohet në bazë të kriterëve përkatëse, duke marrë parasysh legjislacionin, rregulloret, agjencitë qeveritare kompetente dhe praninë e përfaqësimit nga rrjeti agjencisë të ndërlidhura të rikuperimit të asetëve për këshilla dhe udhëzime, ose për çështjet e rikuperimit të asetëve.

7.5. Fjalori i Termave në Lidhje me Juridiksionet Offshore

Ofruesi i Shërbimeve të Korporatave (CSP) - Është një shoqëri ose organizatë që ofron shërbime financiare si: shërbime këshillimi për bizneset, themelimin e shoqërive, lehtësira për agentët e regjistruar, shërbime financiare dhe bankare, shërbime kontabiliteti dhe fiskale, shërbime investimesh, shërbime në grup në vendet offshore, shërbime Trusti.

Fondacioni - Një fondacion privat offshore është shumë i ngjashëm me një Trust offshore, në kuptimin që është themeluar nga një Themelues (ashtu si Themeluesi i Trustit në rastin e Trustit offshore) dhe menaxhohet nga një Këshilltar (ashtu si i Mirëbesuari në rastin e Trustit offshore), i cili menaxhon pronën e Fondacionit Offshore në dobi të përfituesve të Fondacionit Offshore. Themeluesit bien dakord që fondacioni të themelohet, të rregullohet dhe të ketë disa të drejta, interesa dhe karakteristika nga statuti qeverisës i fondacioneve të atij territori.

Shoqëria ose Korporata Ndërkombëtare e Biznesit (IBC) - Një IBC është një shoqëri offshore, e krijuar sipas legjislacionit të disa juridiksioneve, si një shoqëri me legjislacion tatimor asnjës, e cila zakonisht është e kufizuar në lidhje me aktivitetet që mund të kryejë, por jo domosdoshmërisht nga juridiksioni në të cilin është themeluar. IBC-të janë shoqëri offshore që përdoren kryesisht për shërbime bankare offshore, për të kryer tregti ndërkombëtare, investime, si një subjekt me qëllim të posaçëm nga profesionistët, si dhe për mbrojtjen e asetëve. Shoqëritë offshore mund të kryejnë shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, të mbajnë llogari bankare dhe të operojnë me aktivitet tregtar. IBC-të përdoren zakonisht për pronësitë e pasurive të patundshme dhe truallit; për titujt e pronësisë industriale, licencimin dhe franshizën; shërbime personale nga individë që operojnë nëpër botë dhe midis të tjerash bizneset elektronike offshore. Termi 'shoqëri offshore' përdoret më gjerësisht sesa Shoqëri e Biznesit Ndërkombëtar (IBC). Ndonëse të gjitha IBC-të janë domosdoshmërisht shoqëri offshore, jo të gjitha shoqëritë offshore janë IBC.

Llogaria bankare offshore - Një llogari bankare offshore është një llogari në një bankë që ndodhet jashtë vendbanimit të klientit bankar. Këto llogari bankare njihen si llogari që kanë detyrime të ulëta fiskale, gjë që rrjedhimisht i bën të njohura si vende të parajsës fiskale. Llogaritë bankare offshore gjithashtu prirën të ofrojnë përfitime financiare dhe ligjore. Këto përfitime mund të përfshijnë rregulla fiskale më pak kontrolluese, pak ose aspak taksa, privatësi më të madhe dhe akses të lehtë në fonde.

Agjent i Regjistruar - Shumica e juridiksioneve kërkojnë që çdo subjekt biznesi i cili formohet ose kryen aktivitet tregtar brenda kufijve të vet cakton dhe mban një "agjent të regjistruar". Ky person mund të njihet si "agjent rezident" ose "agjent statutor", në varësi të legjislacionit të juridiksionit përkatës në të cilin është regjistruar subjekti i biznesit. Qëllimi i një agjenti të regjistruar është të ofrojë një adresë ligjore (jo numër të kuti postare) brenda atij juridiksioni ku ka persona të disponueshëm gjatë orarit të zakonshëm të punës, për të lehtësuar shërbimin ligjor të procesit që është duke u kryer në rast të një veprimi ligjor apo padie. Në përgjithësi, agjenti i regjistruar është gjithashtu personi të cilit qeveria e atij shteti i dërgon të gjitha dokumentet zyrtare të kërkuara çdo vit për qëllime tatimore dhe ligjore, siç janë njoftimet tatimore dhe formularët e raportimit vjetor. Është detyra e agjentit të regjistruar që ti përcjellë subjektit këto sete dokumentesh dhe njoftime. Agjentët e regjistruar zakonisht njoftojnë subjektet nëse qeveria i ka certifikuar me statusin "pozicion i mirë dhe në përputhje me statutin dhe ligjet në fuqi" apo jo. Arsyeja pse këto njoftime janë një funksion i dëshiruar i një agjenti të regjistruar është se është e vështirë për një subjekt biznesi që të ndjekë ndryshimet legjislative dhe të raportojë datat e pagesave në disa juridiksione, duke pasur parasysh legjislacionin në fuqi të juridiksioneve të ndryshme. Penalitetet për mungesën e një agjenti të regjistruar në përgjithësi bëjnë që juridiksioni të revokojë statusin ligjor të korporatës ose të shpk-së, si dhe në disa raste, të vendosë tarifa shtesë penalitetesh ndaj subjektit.

Vendet e Parajsës Fiskale - Një vend i parajsës fiskale përgjithësisht përkufizohet si një vend ose territor me norma shumë të ulëta "efektive" fiskale për të huajt. Në disa përkufizime tradicionale, një vend i parajsës fiskale gjithashtu ofron privatësinë financiare

Trust - Një marrëveshje (e bazuar kryesisht në të drejtën e "common law") ku një person (i mirëbesuari) zotëron pronën si pronar nominal për përfitimin e një ose më shumë përfituesve. Zakonisht, trustet offshore janë të ngjashme në natyrë me trustet homologe në vendet e tjera; ato kanë një themeluesi cili transferon (ose 'vendos') asetet ('pasurinë e trustit') tek të mirëbesuarit duke e menaxhuar në dobi të një personi, grupi apo disa personave (përfituesit)

8. Bllokimi dhe sekuestrimi

8.1. Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimit në procedurat penale

Kërkesat për ndihmë duhet të jenë mjaft të hollësishme për të mundësuar që shteti të cilit i drejtohet kërkesa dhe çdo gjykatë që konsideron një kërkesë për bllokimin dhe sekuestrimin të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përpunojnë kërkesën në mënyrë të shpejtë.

Prandaj, hartuesi në shtetin që dërgon kërkesën duhet të marrë parasysh në një fazë të hershme saktësisht:

- natyrën e asetit që shteti dëshiron të rikuperojë
- vendndodhjen e asetit që shteti dëshiron të rikuperojë
- mënyrën se si shteti kërkues mund të procedojë në lidhje me rikuperimin e asetit me anën e ndihmës së juridiksionit të huaj
- çfarë lloj ndihme shteti të cilit i është drejtuar kërkesa mund të ofrojë
- çdo traktat, Konventë dhe direktivë që është e përshtatshme për kërkesën.

Brenda BE-së, ku një kërkesë për ndihmë bazohet në njohjen e ndërsjellë, aktualisht mund të përdoret Vendimin Kuadër 2003/577/JHA i Këshillit të BE-së mbi Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave për Bllokimin e Pronave dhe Provave. Një model certifikate për njohje i është bashkangjitur Vendimit Kuadër. Për urdhrat e bllokimit të dërguara brenda BE pas 19 dhjetorit 2020, mund të përdoret Rregullorja e re (BE) 2018/1805 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018 për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Bllokimit dhe Urdhrave të Konfiskimit. Në rastin e Rregullores së re, jepet certifikata e bllokimit (në nenin 6), e cila mund të dërgohet drejtpërdrejt tek autoriteti ekzekutues ose autoriteti qendror. Urdhri i bllokimit gjithashtu mund të dërgohet, por vetëm certifikata duhet të përkthehet. Certifikatat tip të bashkangjitura në Vendimet Kuadër nxisin shtetin që dërgon kërkesën për të siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me shtetin të cilit i drejtohet kërkesa për të qenë në gjendje për të zbatuar kërkesën.

Në lidhje me kërkesat e tjera të ndihmës së ndërsjellë ligjore për bllokimin dhe sekuestrimin, traktatet dhe konventat në përgjithësi sigurojnë që shtetet duhet ti ofrojnë njëri-tjetrit në masën më të gjerë të mundshme të ndihmës në identifikimin dhe gjetjen e instrumenteve, të ardhurave dhe pasurive të tjera që i nënshtrohen konfiskimit. Pa ndryshim, në dritën e shpejtësisë me të cilën asetet likuide në veçanti mund të lëvizin nëpër botë, disa kërkesa për ndihmë ndërkombëtare duhet të lëshohen shumë shpejt dhe pa shumë detaje përshkruese. Gjithsesi, kuptohet se kërkesat për ndihmë duhet, kudo që të jetë të jetë e mundur:

- autoriteti kërkues shënohet në krye të letrës
- përshkruan rolin e brendshëm të autoritetit që bën kërkesën dhe konfirmon se ka leje për të bërë kërkesën sipas ligjit të brendshëm
- jep të dhënat e plota të kontaktit të autoritetit që bën kërkesën
- ofron një version të nënshkruar të kërkesës (gjithashtu të vulosur nëse lëshohet nga një gjyqtar) dhe një version të përkthyer nëse kërkohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa
- përcakton qëllimin për të cilin kërkohet ndihma.

Kërkesat duhet gjithashtu të identifikojnë qartë:

- ndihmën e kërkuar (p.sh bllokim dhe sekuestrim)
- veprat penale të brendshme të akuzuara ose nën hetim, dhe dënimet ose penalitetet e mundshme.
- një kopje të legjislacionit të brendshëm që dënon sjelljen
- përmbledhjen e fakteve dhe lidhjen me shtetin të cilit i drejtohet kërkesa
- çdo informacion sensitiv që nuk mund t'i përcillet gjykatës ose personit
- të dhënat e plota të personit (duke përfshirë personat juridikë)
- lidhja e qartë ndërmjet bllokimit ose sekuestrimit të kërkuar dhe veprës penale nën hetim ose lidhur me procedurat
- çdo datë seance e gjykatës kompetente ose arsyet e urgjencës
- Titulli i traktatit ose Konventës mbështetur në kërkesën për ndihmë të shtetit që dërgon kërkesën
- të dhënat e kontaktit për çdo agjenci ligjzbatuese ose për zyrtarët tashmë të njohur me hetimin në shtetin që i është drejtuar kërkesa
- Detajet që kanë të bëjnë me bujën mediatike ose lajme të tjera sensitive rreth hetimit apo procedimeve
- kur kërkohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa dhe ka lidhje me veprën nën fjalë, ofrohet garancia që nuk do të kryhet dënimi me vdekje apo nuk do të ketë ulje të dënimit.

Veçanërisht për kërkesat në lidhje me urdhrat e kërkuar të bllokimit dhe sekuestrimit, duhet të përfshihen, kur është e mundur, detajet e mëposhtme:

- konfirmimin se vepra përbën vepër penale në të dy juridiksionet (kriminalitet i dyfishtë), nëse kjo kërkohet nga shteti të cilit i është drejtuar kërkesa
- detajet e hetimeve/procedimeve në proces dhe nëse bëhet fjalë për vepër të rëndë penale apo kur është shpallur i pafajshëm
- faktet materiale, duke përfshirë çdo bllokim/ndalim në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa me kopjet e vulosura të këtyre urdhrave dhe çdo mbrojtje ose sqarim të ofruar nga i dyshuari/i pandehuri
- arsyet pse ka shkak të arsyeshëm për të dyshuar se i dyshuari/i pandehuri ka përfituar nga përvetësimi i parave apo asetëve me sjelljen e tij
- arsyet pse ka baza të arsyeshme për të dyshuar në lidhje me pronën e cila duhet të përmbushë urdhrin e sjellë nga shteti i cili dërgon kërkesën, dhe lidhja me shtetin të cilit i drejtohet kërkesa

- pse është e nevojshme përmbushja e këtij urdhri: a do të shpërdorohet prona nëse nuk nxirret një urdhër
- detajet e plota që kanë të bëjnë me të dyshuarit apo të pandehurit dhe pronën e cila do të bllokohet
- detaje të përmbledhura të të gjitha pronave të njohura në zotërimin e të dyshuarit/të pandehurit jashtë shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, në mënyrë që shteti të sigurojë (kur është e përshtatshme) se janë bllokuar vetëm asetet e mjaftueshme për të plotësuar shumën e urdhrit të konfiskimit
- në mënyrë që prona në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa të bllokohet sepse ka prona/asete të pamjaftueshme në vende të tjera
- nëse shteti i cili drejton kërkesën i refuzon ose i pranon shtetit të cilit i drejtohet kërkesa lejimin e aksesit në fondet e bllokuara për shpenzime jetike dhe ligjore.

Veç kësaj, kontaktet e ARIN do të jenë në gjendje të ndihmojnë shtetet që dërgojnë kërkesën me kërkesat bazë të shteteve të tjera për përmbajtjen e kërkesës me shkrim për ndihmë, nëse nevojitet, përpara se të dërgojnë kërkesën për ndihmë.

8.2. Marrja e kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimit në procedurat penale

Shteteve të cilave u drejtohet kërkesa duhet të kontrollojnë kërkesën pas pranimin për t'u siguruar që nuk bie në kundërshtim me arsyet e zakonshme që çojnë në refuzimin e nevojshëm ose në vonesën për zbatimin e kërkesës. Në varësi të legjislacionit vendas në shtetet individuale, së bashku me ndalimet në disa Konventa dhe Traktate, këto arsye të zakonshme përfshijnë:

- detaje të pamjaftueshme
- kur vepra penale nuk përbën vepër penale në juridiksionet e të dy vendeve nuk ka (kriminalitet të dyfishtë)/vepër penale ekuivalente.
- është në kundërshtim me parimet themelore të ligjit në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa
- dënim i dyfishtë
- kërkesa lidhet me një hetim ose procedurë të motivuar politikisht
- vepra parashikohet si shkelje në ligjin ushtarak apo legjislacionit fiskal
- masa e kërkuar mund të cenojë të drejtat e njeriut të të dyshuarit/të pandehurit.

Nëse kërkesa i është dërguar shtetit të cilit i drejtohet kërkesa për njohje të ndërsjellë në përputhje me instrumentet e tilla si Vendimi Kuadër 2003/577/JHA të Këshillit të BE-së për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave për Bllokimin e Pronave dhe Provave, në parim shteti të cilit i drejtohet kërkesa thjesht mund të kontrollojë nëse kutitë në certifikatën model të janë plotësuar siç duhet.

Në çdo rast, shteti të cilit i drejtohet kërkesa duhet të përgatitet (nëse është e nevojshme) t'i rikthehet shtetit që dërgon kërkesën për informacione të mëtejshme në mbështetje të zbatimit të duhur në një gjykatë në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa të urdhrit të bllokimit ose sekuestrimit. Edhe pse shteti që dërgon kërkesën pritet të ketë dhënë në kërkesën e tij detajet e përcaktuara në

seksionin e mësipërm "Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe të sekuestrimit në procedurat penale", përgjithësisht është e lejueshme që shtetet të cilave u drejtohet kërkesa të kërkojnë nga shteti që dërgon kërkesën më shumë detaje para se të ndjekin kërkesat për bllokim dhe sekuestrim.

Kuadri i brendshëm ligjor parashikon se shtetet të cilave ju është drejtuar kërkesa do të marrin masa të përkohshme për bllokimin në pritje të një konfiskimi të mundshëm të çdo artikulli të veçantë prone që përfaqëson të ardhurat apo mjetet, ashtu si edhe konfiskimin e të ardhurave në lidhje me një kërkesë për pagesën e një shume parash korrespondente të vlerës së të ardhurave.

Shteteve zakonisht u kërkohet që të përmbushin kërkesat për ndihmë nga shtetet e tjera me të njëjtën urgjencë dhe prioritet që ata do të trajtonin kërkesat e tyre të brendshme për bllokimin dhe sekuestrimin e aseteve; shih, për shembull, nenin 15.4 të Konventës së Varshavës.

Pasi të jetë ekzekutuar kërkesa për ndihmë, është mirë që shteti të cilit i drejtohet kërkesa të përditësojë shpejt shtetin që dërgon kërkesën me rezultatin e kërkesës për bllokim ose sekuestrim, duke dërguar një kopje të urdhrave të gjykatës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe duke siguruar një linjë të qartë komunikimi ndërmjet shteteve për ofrimin e përditësimeve të mëtejshme njëri-tjetrit gjatë kryerjes së hetimit dhe procedurave penale.

9. Heqja dorë nga asetet dhe konfiskimi

9.1. Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për konfiskim në procedurat penale

Parimi bazë mbetet i njëjtë lidhur me kërkesat për ndihmë për konfiskimin ose heqjen dorë prej të ardhurave nga krimi përkundrejt bllokimit apo sekuestrimit të tyre të mëparshëm: kërkesat duhet të jenë mjaft të hollësishme për të mundësuar që shteti të cilit i drejtohet kërkesa dhe çdo gjykatë që merr në konsideratë kërkesën për konfiskim ose për të hequr dorë të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përpunojnë kërkesën.

Kërkesat për të konfiskuar dhe për të hequr dorë nga aktivet mund të përfshijnë urdhrat e brendshëm të bëra nga shteti që dërgon kërkesën në procedurat penale ose civile.

Nuk është e nevojshme që një shtet të ketë kërkuar ndihmë më përpara për ngrirjen ose sekuestrimin e asetëve, në mënyrë që të kërkojë një kërkesë për ndihmë për konfiskimin ose heqjen dorë prej tyre.

Veç kësaj, hartuesi në shtetin që dërgon kërkesën që të jetë në gjendje të hartojë një kërkesë bindëse për ndihmë, duhet të marrë në konsideratë:

- natyrën e asetit që shteti dëshiron të rikuperojë
- vendndodhjen e asetit që shteti dëshiron të rikuperojë
- se si shteti kërkuar mund të procedojë në lidhje me rikuperimin e asetit me anën e ndihmës së juridiksionit të huaj
- çfarë lloj ndihme shteti i kërkuar mund të ofrojë
- çdo traktat, Konventë dhe direktivë që është e përshtatshme për kërkesën.

Në lidhje me kërkesën për ndihmë bazuar në njohjen e ndërsjellë të urdhrave të konfiskimit të hartuara në procedurat penale, për shembull pas 19 dhjetorit 2020 sipas Rregullores së re (BE) 2018/1805 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 14 nëntorit 2018 për Marrëveshjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Bllokimit dhe Konfiskimit, ose aktualisht duke përdorur Vendimin Kuadër të Këshillit të BE-së 2006/783/JHA për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Konfiskimit, i është bashkangjitur sërish një certifikatë model për njohje në të dyja instrumentet për të nxitur shtetin që dërgon kërkesën që të sigurojë të gjithë informacionin e nevojshëm për shtetin të cilit i drejtohet kërkesa në mënyrë që të jetë në gjendje të zbatojë kërkesën. Kini parasysh se njohja e ndërsjellë nuk zbatohet për urdhrat e bllokimit dhe të konfiskimit të lëshuara në kuadër të procedurave për çështjet civile ose administrative.

Në terma të përgjithshëm, formatet e kërkesave për hartimin e një kërkesë për ndihmë lidhur me konfiskimin ose heqjen dorë nga asetet janë të njëjta si për bllokimin dhe sekuestrimin, konkretisht:

- autoriteti kërkues shënohet në krye të letrës
- përshkruan rolin e brendshëm të autoritetit që bën kërkesën dhe konfirmon se ka leje për të bërë kërkesën sipas ligjit të brendshëm
- jep të dhënat e plota të kontaktit të autoritetit që bën kërkesën
- ofron një version të nënshkruar të kërkesës (gjithashtu të vulosur nëse lëshohet nga një gjyqtar) dhe një version të përkthyer nëse kërkohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa
- përcakton qëllimin për të cilin kërkohet ndihma.

Kërkesat duhet gjithashtu të identifikojnë qartë:

- ndihmën e kërkuar (p.sh. konfiskim dhe heqje dorë nga asetet)
- veprat penale të brendshme për të cilat është dënuar i pandehuri, dhe për të cilat janë vendosur dënimet dhe penaltetet.
- nëse urdhri i cili kërkohet të zbatohet nga shteti që ka dërguar kërkesën është bërë në procedurat penale ose civile të klasifikuara si të brendshme
- një kopje të legjislacionit të brendshëm që dënon sjelljen
- përmbledhjen e fakteve dhe lidhjen me shtetin të cilit i drejtohet kërkesa
- çdo informacion sensitiv që nuk mund t'i përcillet gjykatës ose personit
- të dhënat e plota të të pandehurit në fjalë (duke përfshirë personat juridikë)
- lidhjen e qartë ndërmjet konfiskimit ose heqjes dorë nga asetet e kërkuara dhe veprës penale për të cilin i pandehuri është dënuar
- çdo datë seance e gjykatës kompetente ose arsyet e urgjencës
- Titulli i traktatit ose Konventës mbështetur në kërkesën për ndihmë të shtetit që dërgon kërkesën
- detajet e kontaktit për çdo agjenci zbatimi ose zyrtarët tashmë të njohur me çështjen në shtetin të cilit i është drejtuar kërkesa
- detaje që kanë të bëjnë me vëmendjen mediatike ose lajme të tjera sensitive rreth çështjes
- kur kërkohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa dhe ka lidhje me veprën në fjalë, ofrohet garancia që nuk do të kryhet dënimi me vdekje apo nuk do të ketë ulje të dënimit.

Kërkesa duhet të përfshijë gjithashtu:

- konfirmimin se vepra përbën vepër penale në të dy juridiksionet (kriminalitet i dyfishtë), nëse kjo kërkohet nga shteti të cilit i është drejtuar kërkesa
- kur është e përshtatshme, konfirmimin se personi është i dënuar dhe nuk ka ndonjë apel në lidhje me dënimin
- kur është e përshtatshme, konfirmimin se çdo urdhër është në fuqi dhe është përfundimtar/nuk mund të apelohe, së bashku me një kopje të vulosur të urdhrin
- konfirmimin se e gjitha ose një shumë e caktuar që duhet paguar sipas urdhrin mbetet e papaguar
- konfirmimin se urdhri ka për qëllim rikuperimin e pronës ose vlerën e saj
- konfirmimin se urdhri mund të zbatohet jashtë shtetit që drejton kërkesën
- faktet materiale, duke përfshirë çdo bllokim/ndalim të mëparshëm në shtetin të cilit i drejtohet kërkesa me kopjet e vulosura të këtyre urdhrave dhe çdo mbrojtje ose sqarim rreth procedimeve të brendshme të ofruar nga pandehuri

- arsyen se pse urdhri është i domosdoshëm - a është i nevojshëm konfiskimi ose heqja dorë nga prona për të kryer urdhrin e konfiskimit?
- detajet e plota që kanë të bëjnë me të dyshuarit apo të pandehurit dhe pronën e cila do të konfiskohet
- detaje të shkurtra të të gjitha pronave të tjera të njohura që mbahen nga i pandehuri jashtë shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

Kontaktet e ARIN-it mund të ndihmojnë shtetet që dërgojnë kërkesën me kërkesat bazë të shteteve të tjera për përmbajtjen e kërkesës me shkrim për ndihmë, nëse nevojitet, përpara se të dërgojnë kërkesën për ndihmë.

9.2. Dërgimi dhe marrja e kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit në procedurat e konfiskimit pa dënim

Siç përshkruhet në 2.6 konfiskimi pa dënim (NCB) është procesi i konfiskimit të asetëve pa dënuar ndonjë person të caktuar për vepër penale në lidhje me ato asete. Kjo mund të bëhet si në proceset gjyqësore penale, ashtu edhe civile. Shumë juridiksione në mbarë botën po përfitojnë nga përfitimet e konfiskimit pa dënim duke miratuar legjislacionin e konfiskimit civil. Megjithatë në BE-ja, me përjashtim të disa juridiksioneve (MB, Irlanda, Bullgaria, Sllovakia), ende nuk ka miratuar ligjet e brendshme të konfiskimit civil. Për të siguruar që urdhrat e huaj të konfiskimit të jenë të njohura dhe të zbatuara në një gamë më të gjerë rrethanash, standardet ndërkombëtare kërkojnë që vendet të kenë autoritetin që të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesave të bëra në bazë të procedurave të konfiskimit pa dënim dhe masave të përkohshme, përveç nëse kjo nuk është në përputhje me parimet themelore të ligjit të tyre të brendshëm. Meqë mund të duhen disa vjet para se juridiksionet e BE-së të kenë ligjet e tyre të konfiskimit civil, standardet ndërkombëtare deklarojnë se juridiksionet duhet të jenë në gjendje të zbatojnë urdhrat bazuar në procedurat e konfiskimit të NBC-së, të paktën, në rrethanat kur autori nuk është i disponueshëm për shkak të vdekjes, udhëtimit, mungesës, ose nëse autori është i panjohur.

Pavarësisht asaj të thënë më sipër, shumë shtete në mbarë botën kanë dispozita të brendshme të pjesshme ose të plota për konfiskimin civil, të cilat gjithashtu mund të njihen si procedurat e rikuperimit civil. Disa shtete mund të jenë të gatshme për të zbatuar urdhrat e konfiskimit civil, për sa kohë që procedura e konfiskimit mund të jetë e lidhur me një rast të natyrës penale, madje edhe në mungesë të procedurave penale.

Siç është theksuar më sipër në këtë Manual, traktatet dhe Konventat kërkojnë që autoritetet shtetërore t'u përgjigjen kërkesave për ndihmë të bazuara në procedurat e konfiskimit pa dënim, kur është e mundur, brenda kuadrit të ligjeve të tyre të brendshme. Duke u bazuar sërish në parimin që autoritetet shtetërore duhet t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmën më të gjerë të mundshme për rikuperimin e të ardhurave nga krimi, nëse procedurat e tyre për ta bërë këtë klasifikohen në nivel të brendshëm si penale ose civile nga natyra, autoritetet shtetërore janë të ftuara

përgjithësisht të mendojnë anën tjetër kur vlerësojnë një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ligjore ose për bashkëpunim ndërkombëtar në lidhje me konfiskimin pa dënim. Për shembull, Dokumenti i Praktikave më të Mira të FATF-së për Konfiskimin inkurajon shtetet që të shohin përtej terminologjisë dhe etiketave, thelbin e procedurës me qëllim vlerësimin objektiv të kërkesës. Është e rëndësishme që kërkesat të mos refuzohen në mënyrë të paarsyeshme për shkak të konfuzionit të shkaktuar nga përdorimi i terminologjisë së ndryshme në shtete të ndryshme. FATF rekomandon që kërkesa të mos refuzohet thjesht mbi bazën se shteti që dërgon kërkesën përdor termin "konfiskim civil".⁷

Megjithatë, në parim, nëse çdo shtet ndërmerr masa të brendshme për rikuperimin e të ardhurave nga veprimtaritë kriminale në procedurat e klasifikuara si civile, të njëjtat informacione të përgjithshme duhet t'i dërgohen shtetit të cilit i drejtohet kërkesa sipas përmbajtjes së letër kërkesës siç përcaktohet më sipër në seksionin "Dërgimi i kërkesave ndërkombëtare për urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimit në procedurat penale".

Veç kësaj, kontaktet e ARIN do të jenë në gjendje të ndihmojnë shtetet që dërgojnë kërkesën me kërkesat bazë të shteteve të tjera për përmbajtjen e kërkesës me shkrim për ndihmë, nëse nevojitet, përpara se të dërgojnë kërkesën për ndihmë.

Fraza "konfiskim pa dënim" në vetvete dhe pa dyshim disa koncepte të NCB-së për konfiskimin, kanë shkaktuar konfuzion të konsiderueshëm midis praktikuesve të rikuperimit së aseteve. Për të ndihmuar juridiksionin për zbatimin e urdhrave të bllokimit, sekuestrimit dhe konfiskimit bazuar në procedurat e konfiskimit pa dënim, CARIN-i ka përgatitur një Udhëzues të dobishëm për Tipologjitë e Praktikuesve për Konfiskimin pa dënim, për të sqaruar llojet e ndryshme të konfiskimit pa dënim. Ky udhëzues gjendet në Shtojcën V të Manualit CARIN.

https://docs.wixstatic.com/ugd/d54f05_4ccdfc507cb44d3588354132a68af289.pdf.

Meqenëse terminologjia është ajo që shpeshherë shkakton konfuzion gjatë ekzekutimit të kërkesave ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e rikuperimit të aseteve, këshillat e FATF për të parë përtej terminologjisë në kërkesat e thelbit aktual të procedurave janë veçanërisht të rëndësishme dhe të vlefshme.

⁷ Seksioni VI, 19

9.3. Urdhrat për Pasurinë e Padeklaruar

Një lloj konfiskimi pa dënim, siç shpjegohet në 2.6 d) është dispozita 'pasuria e padeklaruar' Kjo dispozitë synon të konfiskojë ose të heqë dorë nga asetet në rastet kur një person zotëron ose gëzon një nivel pasurie që nuk mund ta kenë fituar ligjërisht, ose që nuk mund të shpjegohet me ndonjë mjet tjetër, si trashëgimi, fitim lotarie ose dhuratë. Kjo mund të ndodhë në procedurat penale ose civile, në varësi të juridiksionit. Kjo dispozitë është veçanërisht e rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar, pasi disa shtete do të ndërmarrin masa kundër asetëve që ndodhen nën juridiksionin e tyre, me kërkesë të shtetit që ka kryer hetimin/ndjekjen penale, duke përdorur dispozitat e tyre për pasuritë e padeklaruar. Një rast i një shteti që e ka këtë mundësi është Mbretëria e Bashkuar (MB).

9.4. Urdhrat për Pasurinë e Padeklaruar në MB

Nisur nga 12 nëntori 2018, mund të bëhen kërkesa nga çdo shtet drejtuar Mbretërisë së Bashkuar për ndihmë të ndërsjellë ligjore në lidhje me Urdhrat për Pasurinë e Padeklaruar (UWO-të), edhe pse UWO-të vetë mund të mos jenë të disponueshme si mjet i brendshëm për rikuperimin e pasurisë së shtetit që dërgon kërkesën.⁸

UWO-të janë mjete hetimore të disponueshme brenda Mbretërisë së Bashkuar nisur nga 31 janari 2018 dhe ato kërkojnë nga personi (i cili specifikohet me dokumente) që:

- përcaktojnë natyrën dhe shtrirjen e interesit të tyre në pronën për të cilën është bërë urdhri
- shpjegojnë se si e kanë përfituar pronën (dhe, në veçanti, se si janë përballuar të gjitha shpenzimet e kryera për përfitimin e saj)
- kur prona mbahet nga të mirëbesuarit e një marrëveshjeje, përcaktojnë detaje të marrëveshjes që mund të specifikohen në urdhër
- përcaktojnë informacione të tjera në lidhje me pronën nëse specifikohen në urdhër, për një periudhë të caktuar kohore.

UWO duhet të specifikojë ose përshkruajë pronën për të cilën kërkohet urdhri dhe të specifikojë personin që autoriteti zbatues mendon se e ka në pronësi (i cili mund të jetë një person jashtë Mbretërisë së Bashkuar). Ky person mund të jetë një person i ekspozuar politikisht, domethënë një individ që i (ose i janë) besohen funksione publike të rëndësishme nga një organizatë ndërkombëtare ose nga një shtet i ndryshëm nga Mbretëria e Bashkuar ose nga një shtet tjetër i KEE-së, një anëtar i familjes së atij individ, i njohur si bashkëpunëtor i ngushtë i tij, ose i lidhur në ndonjë formë tjetër me atë individ.

Mospërbushja pa justifikim të arsyeshëm (ose supozimi i përmbushjes) të kërkesave të vendosura nga UWO brenda një periudhe të lejuar nga një gjykatë nënkupton që pasuria supozohet të jetë pasuri e rikuperueshme (dmth. pasuri e përfituar nëpërmjet veprimtarive të paligjshme) në procedurat civile për rikuperimin.

⁸ Të ardhurat nga krimi, Akti 2002 (Hetimet e Jashtme si edhe Urdhrat dhe Kërkesat e Jashtme) (Amendamenti) Urdhër 2018

Në hartimin e një kërkesë për ndihmë për të marrë një UWO në mbështetje të hetimit apo procedurave në shtetin që dërgon kërkesën, formati i kërkesës për ndihmë duhet sërish të jetë:

- autoriteti kërkues shënohet në krye të letrës
- përshkruan rolin e brendshëm të autoritetit që bën kërkesën dhe konfirmon se ka leje për të bërë kërkesën sipas ligjit të brendshëm
- jep të dhënat e plota të kontaktit të autoritetit që bën kërkesën
- ofron një version të nënshkruar të kërkesës (gjithashtu të vulosur nëse lëshohet nga një gjyqtar) dhe një version të përkthyer nëse kërkohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa
- përcakton qëllimin për të cilin kërkohet ndihma.

Kërkesa duhet të përfshijë gjithashtu informacione të mjaftueshme dhe detaje të dokumentacionit që gjykata e MB të arrijë në përfundimin se:

- ka arsye për të besuar se personi zotëron pasurinë për të cilën kërkohet urdhri dhe vlera e pasurisë është më e madhe se £ 50,000
- ka baza të arsyeshme për të dyshuar se burimet e deklaruara të të ardhurave të fituara në mënyrë të ligjshme të personit do të ishin të pamjaftueshme për të mundësuar që personi të përfitonte pasurinë.
- personi është një person i ekspozuar politikisht ose ka baza të arsyeshme për të dyshuar se personi është, ose ka qenë, i përfshirë në krim të rëndë (qoftë në një pjesë të Mbretërisë së Bashkuar ose diku tjetër), ose dikush që lidhet me atë person është, ose ka qenë, gjithashtu i përfshirë.

Ndonëse kjo është ende një fushë relativisht e re për kërkesat e ndihmës së ndërsjellë ligjore në Mbretërinë e Bashkuar, sugjerohet që kërkesat për një UWO të identifikojnë qartë:

- ndihmën e kërkuar (p.sh një UWO)
- veprat penale të brendshme të akuzuara ose nën hetim, dhe dënimet ose penalitetet e mundshme.
- një kopje të legjislacionit të brendshëm që dënon sjelljen
- përmbledhjen e fakteve dhe lidhjen me shtetin të cilit i drejtohet kërkesa
- çdo informacion i klasifikuar që nuk mund t'i përcillet gjykatës ose personit
- të dhënat e plota të personit (duke përfshirë personat juridikë)
- lidhja e qartë ndërmjet UWO-së së kërkuar dhe veprës penale nën hetim ose lidhur me procedurat.
- çdo datë seance e gjykatës kompetente ose arsyet e urgjencës
- Titulli i traktatit ose Konventës mbështetur në kërkesën për ndihmë të shtetit që dërgon kërkesën
- të dhënat e kontaktit për çdo agjenci zbatuese ose për oficerët tashmë të njohur me hetimin në shtetin që i është drejtuar kërkesa
- detajet që kanë të bëjnë me bujën mediatike ose lajme të tjera sensitive rreth hetimit apo procedimeve

10. Kthimi dhe Asgjësimi i Aseteve: Marrëveshjet për Ndarjen e Aseteve

Kuadri ndërkombëtar për ndihmën e ndërsjellë ligjore në rikuperimin e të ardhurave nga krimi përgjithësisht parashikon që shteti i cili dërgon kërkesën nuk mund të insistojë në mbajtjen e vlerës së pasurisë së rikuperuar kur ajo ndihmohet nga shteti të cilit i drejtohet kërkesa.

Megjithatë, Konventat dhe traktatet mund të ofrojnë dispozita për marrëveshjet për ndarjen e asetëve me nxitjen e njëres nga shtetet palë për kërkesën. Për shembull, neni 25 i Konventës së Varshavës parashikon që shteti të cilit i drejtohet kërkesa që vepron sipas Konventës mund të asgjësojë pronën (e cila konfiskohet me kërkesë të një shteti tjetër) në përputhje me ligjin dhe procedurat administrative të brendshme, por duhet të marrë në konsideratë dhënien e përparësisë për kthimin e pronës së konfiskuar shtetit që dërgon kërkesën, në mënyrë që të mund t'u japë kompensim viktimave të krimit ose t'ia kthejë këtë pronë pronarëve legjitim. I njëjti nen lejon shtetin të cilit i drejtohet kërkesa që të lidhë marrëveshje për ndarjen e asetëve me shtetin që dërgon kërkesën, rregullisht ose rast pas rasti, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa ose me procedurat administrative.

Dispozita të ngjashme jepen, për shembull, në nenin 14 të UNTOC dhe nenin 57 të UNCAC.

Neni 57.4 i UNCAC gjithashtu parashikon që nëse shtetet palë nuk bien dakord ndryshe, shteti të cilit i drejtohet kërkesa mund të zbrisë shpenzimet e justifikuar për hetimet, ndjekjet penale ose procedurat gjyqësore që çojnë në kthimin ose asgjësimin e pronës së konfiskuar sipas Konventës.

Brenda BE-së, Rregullorja e re (BE) 2018/1805 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018 për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Bllokimit dhe Konfiskimit ofron dispozita gjithëpërfshirëse që përfshijnë kthimin e pronës së bllokuar viktimës dhe asgjësimin e pronës së konfiskuar ose parave të fituara pas shitjes së kësaj prone; këto do të hyjnë në fuqi për urdhrat e transmetuara pas 19 dhjetorit 2020. Udhëzuesi i përgjithshëm 50/50 për ndarjen e asetëve, i zhvilluar nga Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Konfiskimit të vitit 2006, është gjithashtu i paraqitur në Rregulloren e re. Në të shprehet se nëse shuma e përfituar nga ekzekutimi i urdhrit të konfiskimit është e barabartë ose më e vogël se 10 000 euro, shuma i kreditohet shtetit ekzekutues. Nëse shuma e përfituar nga ekzekutimi i urdhrit të konfiskimit është më e madhe se 10 000 euro, 50% e shumës do të transferohet nga shteti ekzekutues në shtetin kërkues.

Prandaj, shtetet të cilave u drejtohet kërkesa mund të dëshirojnë të marrin në konsideratë pas marrjes së kërkesës për ndihmë, në lidhje me shtetin që dërgon kërkesën, sipas rastit, nëse ai dëshiron të mbajë vlerën e çdo të ardhure të rikuperuar në një rast të veçantë. Udhëzimet për praktikrat më të mira nxisin shtetet të marrin në konsideratë atë se çfarë do t'i ndodhë çdo aset të përfshirë në çështjet ndërkombëtare në fazën më të hershme të mundshme. Diskutimet lidhur me kthimin e pronës viktimave dhe ndarjen e asetëve duhet të mbyllet me një marrëveshje për përdorimin e njërës prej instrumenteve të disponueshme: për shembull, Rregulloren e re dhe

lidhjen e një marrëveshjeje për ndarjen e asetëve. Faktorët që i nxisin rregullisht shtetet të lidhin marrëveshje për ndarjen e asetëve ose të kthejnë plotësisht vlerën e një asemi të konfiskuar përfshijnë shpeshhtësinë e kërkesave ndërmjet dy shteteve përgjithësisht në lidhje me bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe heqjen dorë nga të ardhurat nga krimi; ose natyrën e veprës penale prej së cilës rrjedhin të ardhurat. Për shembull, në rastet e korrupsionit të shkaktuara në vendet më të varfra në botë, shtetet më të pasura të cilave u drejtohet kërkesa do të shqyrtojnë mundësinë e kthimit të vlerës së pasurisë së konfiskuar në një shtet tjetër drejtpërdrejt ose për të mbështetur nismat që do të përmirësojnë shoqërinë në atë shtet në tërësi (si projekte edukative ose bamirësie). Marrëveshja për Ndarjen e Aseteve e Modelit të OKB-së mund të gjendet në https://www.unodc.org/pdf/crime/ieg_crime_2005-01-26_draft_model_agr_01.pdf.

11. Ndihma e ndërsjellë juridike për rikuperimin e asetëve

Aftësia për të kërkuar përkohësisht ndihmën ndërkombëtare për bllokimin dhe konfiskimin e asetëve të cilat janë transferuar jashtë juridiksionit ligjor të një vendi, për t'i ruajtur nga çdo urdhër konfiskimi kriminal apo nga urdhrat e rikuperimit civil që mund të bëhen, është një armë kryesore në luftën kundër lëvizjes së paligjshme të të ardhurave të krimit.

Siç përcaktohet më sipër në lidhje me hetimet, ndryshimet në legjislacionin vendas, politikat, institucionet dhe procedurat mund të pengojnë përpunimin efikas të kërkesave ndërkombëtare për bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe heqjen dorë nga asetet, ndërsa ofrimi i ndihmës së ndërsjellë juridike ndaj shteteve të tjera ka treguar se është një mjet thelbësor.

Shumë shtete kanë një zyrë të vetme për përpunimin e kërkesave hyrëse për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe përmes së cilave çdo kërkesë e tillë duhet të drejtohet në shkallë të parë; shtetet e tjera tregojnë gatishmërinë për t'i pranuar këto kërkesa përmes zyrave rajonale ose autoriteteve të veçanta në varësi të natyrës së kërkesës. Këto kërkesa publikohen gjerësisht; për shembull, Këshilli i Evropës ofron një udhëzues gjithëpërfshirës për procedurat kombëtare të Shteteve Anëtare dhe kërkesat e tyre individuale për të përpunuar kërkesat. ARIN contacts will also provide information and assistance as to the appropriate office for directing a request for assistance.

Ndihma e ndërsjellë juridike (MLA) mundëson bashkëpunimin ndërmjet shteteve për të marrë ndihmë në hetimin ose ndjekjen penale të veprave penale, si dhe në hetimin, bllokimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, qoftë në bazë kriminale (dënim), ose në bazë civile (mosdënim).

Kërkesat bëhen me një Letër Kërkesë Ndërkombëtare (ILOR ose LOR). Në juridiksionin e së drejtës civile, këto njihen gjithashtu si Commissions Rogatoires. Kjo ndihmë në përgjithësi kërkohet nga gjykatat ose prokurorët, prandaj njihet edhe si "bashkëpunim gjyqësor".

Kur një shtet palë sipas Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së 2003/577/JHA për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave për Bllokimin e Pasurive dhe Provave dhe Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së 2006/783/JHA për Njohjen e Ndërsjellë të Urdhrave të Konfiskimi, kërkon regjistrimin e shpejtë dhe ekzekutimin e urdhrave të bllokimit dhe të konfiskimit të një shteti tjetër, kjo njihet si "njohje e ndërsjellë". Në vend që të përdorin ILOR-të ose LOR-të, shtetet palë hartojnë një certifikatë model, të cilën ia bashkëngjisin secilit Vendim Kuadër të nevojshëm.

Marrja e kërkesave ndërkombëtare për ndihmë

Është shumë e rëndësishme që fillimisht të analizohet një kërkesë hyrëse për të përcaktuar nëse kërkon masa ndihme në procedurat penale ose civile, në mënyrë që organizata e duhur të mund të përpunojë kërkesën dhe të ofrojë ndihmën.

Disa shtete nuk pranojnë kërkesa për ndihmë në procedurat civile për rikuperim civil (të bazuara në raste mosdënimi). Megjithatë, neni 43 i UNCAC-it shpreh synimin që, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me sistemin e tyre ligjor vendas, shtetet palë duhet të ndihmojnë njëri-tjetrit në hetimet dhe procedurat në çështjet civile dhe administrative në lidhje me korrupsionin. Përveç kësaj, për shembull, neni 21 i Konventës së Varshavës të Këshillit të Evropës autorizon një shtet të cilit i është drejtuar kërkesa që të marrë masat e nevojshme të përkohshme, si bllokimi apo sekuestrimi, për të ndihmuar një tjetër shtet palë, i cili ka nisur ndjekje penale ose procedura për qëllime konfiskimi. Prandaj, këto Konventa dhe të tjera si këto në përgjithësi synojnë që shtetet t'i ofrojnë njëri-tjetrit nivelin më të lartë të ndihmës, e cila synon të shtrihet edhe në kërkesat për ndihmë për rikuperimin e bazuar në mosdënim.

Kapitujt e mëparshëm japin udhëzime të hollësishme për çështjet që duhet të përfshihen në kërkesat e MLA-së për gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe heqjen dorë nga asetet. Mjetet e dobishme për të ndihmuar në hartimin e kërkesave të MLA-së mund të gjenden në kapitullin 14.

Mos harroni se rikuperimi i aseteve jashtë vendit shpesh kërkon punë të lodhshme dhe vullnet politik. Për të garantuar sukses:

- sigurohuni që gjuha dhe drejtshkrimi në çdo dokument të transmetuar të jenë përkthyer më së miri nga gjuha origjinale: disa vende e refuzojnë kërkesën vetëm për gabime drejtshkimore
- mbani kontakte të rregullta me kolegët hetues ndërkombëtarë dhe autoritetet e ndjekjes penale në lidhje me çështjen
- përditësoni në lidhje me progresin e hetimit të brendshëm dhe procedurat e lidhura gjyqësore, shpejt nëse është e nevojshme
- kuptoni marrëveshjet për ndarjen e aseteve

12. Përmbledhje e marrëveshjeve dypalëshe ekzistuese në rajon për rikuperimin e asetëve

Shqipëri

Shqipëria ka lidhur një sërë marrëveshjesh dypalëshe dhe i ka kombinuar në një Manual për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Nuk dihet nëse ndonjëra nga këto përqendrohet në mënyrë specifike te rikuperimi i asetëve.

Bosnja-Hercegovina

Bosnja-Hercegovina ka lidhur marrëveshje me disa juridiksione brenda dhe jashtë rajonit të Ballkanit. Këto marrëveshje janë më të përgjithshme në natyrë dhe nuk përqendrohen te hollësitë që lidhen me gjurmimin, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve. Bosnje-Hercegovina nuk ka lidhur ndonjë marrëveshje dypalëshe që lidhet në mënyrë specifike me rikuperimin e asetëve. Konfiskimi rregullohet në kuadër të marrëveshjeve të përgjithshme për MLA-të.

Kosova*

Asnjë marrëveshje dypalëshe në lidhje me rikuperimin e asetëve.

Mali i Zi

Mali i Zi ka marrëveshje dypalëshe për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale me Serbinë, Kroacinë dhe Maqedoninë e Veriut. Të tria marrëveshjet janë të ngjashme. Marrëveshjet nuk përmbajnë dispozita të gjera të rikuperimit të asetëve. Sipas nenit 3, (Fushëveprimi i ndihmës juridike) ata tregojnë se veprimet e kërkuara mund të përfshijnë konfiskimin dhe sekuestrimin e përkohshëm të objekteve. Këto marrëveshje janë të disponueshme vetëm në gjuhën vendase.

Maqedonia e Veriut

Maqedonia e Veriut ka një sërë marrëveshjesh dypalëshe në fuqi me juridiksionet duke përfshirë vendet fqinje të Ballkanit, të nënshkruara dhe të ratifikuara që nga viti 1998. Përveç këtyre, ekzistojnë Memorandume Mirëkuptimi ndërmjet Shërbimit të Prokurorisë së Maqedonisë së Veriut dhe Shërbimit të Prokurorisë së Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Serbisë, Kroacisë dhe Malit të Zi. Këto marrëveshje dhe memorandume janë të një natyre të përgjithshme dhe janë të përqendruara te shkëmbimi i informacionit, ekstradimi dhe ekzekutimi i sanksioneve penale. Asnjëra prej tyre nuk përqendrohet në mënyrë specifike tek aspektet e ndryshme të rikuperimit të asetëve. Këto marrëveshje janë të disponueshme vetëm në gjuhën vendase.

*Ky emërtim nuk cenon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Serbi

Serbia ka një marrëveshje dypalëshe me Malin e Zi. Kjo ofron një bazë ligjore për bashkëpunim në lidhje me provat dhe instrumentet e krimit, në vend të të ardhurave nga krimi. Si rrjedhojë, kjo nuk është e mjaftueshme për një bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe efektiv në fushën e konfiskimit të aseteve.

13. Akronime/ Shkurtime

AMO	- Zyra e Menaxhimit të Aseteve
AP	- Projekti i Analizës (Europol)
ARIN	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve
ARIN-AP	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Azinë e Paqësorit
ARIN-CARIB	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Karaibe
ARIN-EA	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Lindore
ARIN-SA	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Jugore
ARIN-WA	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Afrikën Perëndimore
ARIN-WCA	- Rrjeti i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve në Azinë Perëndimore dhe Qendrore
AMO	- Zyra e Menaxhimit të Aseteve
CARIN	- Rrjeti Camden i Agjencive të Rikuperimit të Aseteve
CoE	- Këshilli i Evropës
CSP	- Ofruesi i Shërbimeve të Korporatave
dob/D.O.B.	- Datëlindja
EGMONT	- Grupi Egmont (i FIU-ve)
EJN	- Rrjeti Gjyqësor Evropian (BE)
ETS	- Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës
BE	- Bashkimi Evropian
EU MS	- Shtet(e) Anëtar(e) i/të BE-së
Eurojust	- Njësia e Bashkëpunimit Gjyqësor të Bashkimit Evropian
Europol	- Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit
FATF	- Grupi i Punës për Veprime Financiare Kundër Pastrimit të Parave
FIU	- Njësia e Inteligjencës Financiare
GAFI	- Groupe d'action financière (Termi francez i FATF-së)
GAFILAT	- Organi rajonal i FATF-së për Amerikën Latine
GFPN	- Rrjeti i Pikave të Kontaktit të Interpoli-it
I 24/7	- Sistemi global i komunikimit të policisë (Interpol)
IBC	- Korporata ose Shoqëria Ndërkombëtare e Biznesit
ICPO	- Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
ILOR	- Letër Kërkese Ndërkombëtare
Interpol	- Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale (ICPO)
I-SECOM	- Sistemi i sigurt i postës elektronike me bazë në internet për komunitetin e specializuar kundër korrupsionit (Interpol)

JIT	- Grupi i Përbashkët Hetimor
JHA	- Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme (BE)
SHPK	- Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
LOR	- Letër Kërkese
MLA	- Ndihmë e Ndërsjellë Juridike
MoneyVal	- Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (një komitet i CoE-së)
MS	- Shtet(et) anëtar(e) i/të BE-së.
MT103	- mesazhi i standardizuar i pagesës SWIFT i përdorur për transfertat bankare ndërkombëtare
NCB	- Zyra Qendrore Kombëtare (Interpol)
OAP	- Plan Operacional Veprimi
OLAF	- Office Européen de Lutte Antifraude (Zyra Evropiane e Kundër Mashtrimit)
PCC SEE	- Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore
RAI	- Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit
RRAG	- Red de Recuperación de Activos de GAFILAT (ARIN-i për Amerikën Latine)
SIENA	- Aplikim i Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit (Europol)
StAR	- Rrjeti i Aseteve të Vjedhura (Nisma)
SWIFT	- Shoqëria për Telekomunikacionin Financiar Ndërbankar Botëror
UK	- Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut
UN	- Kombet e Bashkuara
UNCAC	- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit
UNODC	- Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit
UNTOC	- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2000)
UWO	- Urdhri/at për Pasurinë e Padeklaruar

14. Burime të dobishme informacioni

FATF Praktikrat më të mira për konfiskimin (rekomandimet 4 dhe 38) dhe një kuadër për punën e vazhdueshme për rikuperimin e asetëve (2012)

Ky dokument përcakton praktikrat më të mira ndërkombëtare për të ndihmuar vendet në zbatimin e Rekomandimeve 4 dhe 38 të FATF-së dhe për të trajtuar pengesat për konfiskimin efektiv dhe rikuperimin e asetëve në kontekstin ndërkombëtar:

<http://www.fatf-gafi.org/publications/fatfrecommendations/documents/bestpracticesonconfiscationrecommendations4and38andaframeworkforongoingworkonassetrecovery.html>

FATF Fshehja e Pronësisë Përfituese (2018)

Ndërsa subjektet ligjore tregtare, si shoqëritë, fondacionet, partneritetet dhe llojet e tjera të personave juridikë dhe marrëveshjeve janë të rëndësishme për mbështetjen e aktivitetit tregtar dhe sipërmarrës, ato gjithashtu mund të keqpërdoren për të fshehur pronësinë dhe kontrollin e asetëve të fituara në mënyrë të paligjshme. Raporti bazohet në mbi 100 raste studimore të ofruara nga 34 juridiksione të ndryshme të Rrjetit Global të FATF-së, përvojat e ligjzbatuesve dhe ekspertëve të tjerë, të dhënat e komunikuar nga sektori privat si dhe raportet e kërkimit të marra nga burime me akses të hapur në internet dhe raportet e inteligjencës për të identifikuar metodat që përdorin kriminelët për të fshehur pronësinë e përfituar. Cenueshmëritë e lidhura me pronësinë përfituese analizohen me një fokus të veçantë të përfshirja e ndërmjetësve profesionistë.

<http://www.fatf-gafi.org/publications/methodsandtrends/documents/concealment-beneficial-ownership.html>.

Partneritetet Ndërkombëtare të StAR-it për Rikuperimin e Aseteve: Përmbledhje dhe Adresari Global i Rrjeteve (2012)

Ky adresar liston rrjetet e rikuperimit të asetëve, së bashku me informacionin rreth strukturës dhe operacioneve të tyre, si dhe të dhënat e kontaktit.

<https://star.worldbank.org/publication/international-partnerships-asset-recovery>

Burimet me Akses të hapur në lidhje me Strukturat Offshore

The Puppet Masters (2011): shpjegon se si të korruptuarit përdorin strukturat ligjore për të fshehur asetet e vjedhura dhe çfarë masash duhen ndërmarrë në lidhje me këtë fenomen

Ky publikim merret me strukturat korporative dhe financiare, të cilat formojnë gurët e themelit të gjurmëve të parave të fshehura. Në veçanti, përqendrohet tek lehtësia me të cilën aktorët e korruptuar fshehin interesat e tyre nën ombrellën e korporatave dhe vështirësitë me të cilat përballen hetuesit në përpjekje për ta kapërcyer këtë barrierë.

<http://documents.worldbank.org/curated/en/784961468152973030/The-puppet-masters-how-the-corrupt-use-legal-structures-to-hide-stolen-assets-and-what-to-do-about-it>

Aktivitetet Offshore dhe Pastrimi i Parave - Gjetjet e fundit dhe Sfidat (2017)

Ky raport publikohet nga BE-ja dhe shqyrton përgjigjen e BE-së për krijimin e transparencës në lidhje me regjistrat bankarë, pronësinë përfituese dhe llogaritë tatimore.

<https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/e2af020a-1379-11e7-808e-01aa75ed71a1/language-en>

Burimet me Akses të Hapur për hartimin e MLA-së**Programi i UNODC për Hartimin e Kërkesave të MLA-së - <https://www.unodc.org/mla/>**

Programi për Hartimin e Kërkesave të Ndhmës së Ndërsjellë Juridike (MLA Tool) u zhvillua nga UNODC për të ndihmuar praktikuesit e drejtësisë penale në hartimin e shpejtë të kërkesave të MLA-së, duke rritur kështu bashkëpunimin midis shteteve dhe duke përshpejtuar kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të tilla.

Programet e Këshillit të Evropës -

<https://www.coe.int/en/web/transnational-criminal-justice-pcoc/mutual-legal-assistance>

Kjo faqe ofron informacione të dobishme për vendin, traktatet, konventat, standardet ndërkombëtare dhe mjetet për zbatimin e ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale.

Mjetet e Rrjetit Gjyqësor Evropian

https://www.ejn-crimjust.europa.eu/ejn/EJN_Home.aspx

Kjo faqe ofron një sërë instrumentesh të dobishme për identifikimin e kërkesave ligjore të një autoriteti kompetent vendor kur kërkon bashkëpunimin gjyqësor, një model të ndihmës së ndërsjellë juridike, një bibliotekë gjyqësore, pikat e kontaktit dhe ofron informata koncize dhe praktikë ligjore lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar për sa i përket masave shtrënguese.

Mjetet e Autoritetit Qendror të Mbretërisë së Bashkuar

<https://www.gov.uk/guidance/mutual-legal-assistance-mla-requests>

Kjo ofron informacione për autoritetet kompetente jashtë vendit (dhe në Mbretërinë e Bashkuar) për marrjen e provave brenda Britanisë së Madhe (ose jashtë vendit) për të ndihmuar në hetimet ose ndjekjet penale.

15. Shtojca

Shtojca A

SHKËMBIM INFORMACIONI SIPAS VENDIMIT KUADËR TË KËSHILLIT 2006/960/JHA,
FORMULAR PËR T'U PËRDORUR NGA
**SHTETI ANËTAR TË CILIT I DREJTOHET KËRKESA NË RAST TRANSMETIMI/VONESE/
REFUZIMI TË INFORMACIONIT**

Ky formular do të përdoret për të transmetuar informacionin dhe/ose informatat e kërkuara rreth dosjes penale, për të informuar autoritetin kërkues për pamundësinë e përmbushjes së afatit të rregullt, për nevojën e dorëzimit të kërkesës tek një autoritet gjyqësor për një autorizim ose refuzimin për të transmetuar informacionin.

Ky formular mund të përdoret më shumë se një herë gjatë procedurës (p.sh. nëse kërkesa duhet së pari t'i dorëzohet një autoriteti gjyqësor dhe më vonë konstatohet se ekzekutimi i kërkesës duhet të refuzohet).

Autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa (emri, adresa, telefoni, faksi, emaili, Shteti Anëtar):	
Detajet e agjentit të transportit (opsionale):	
Numri i Referencës i kësaj përgjigjeje:	
Data dhe numri i referencës i përgjigjes së mëparshme	
Kthim përgjigje ndaj autoritetit të mëposhtëm që drejton kërkesën	
Data dhe ora e kërkesës	
Numri i Referencës i kërkesës	
Afatet kohore normale sipas nenit 4 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA	
Vepra parashikohet në nenin 2, paragrafi 2, të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA dhe Informacionet ose informatat rreth dosjes penale të kërkuara mbahen në një bazë të dhënash në të cilën ka akses të drejtpërdrejtë një autoritet ligjzbatues në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa	Kërkohet me urgjencë <input type="checkbox"/> 8 orë
	Nuk kërkohet me urgjencë <input type="checkbox"/> 1 javë
Raste të tjera:	<input type="checkbox"/> 14 ditë
Informacioni i transmetuar sipas Vendimit Kuadër 2006/960/JHA: informacioni dhe informatat e dhëna rreth dosjes penale	
1. Përdorimi i informacionit dhe informatave të transmetuara rreth dosjes penale <input type="checkbox"/> mund të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë ose për të parandaluar një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike; <input type="checkbox"/> është i autorizuar edhe për qëllime të tjera, në varësi të kushteve të mëposhtme (opsionale):	
2. Besueshmëria e burimit <input type="checkbox"/> I besueshëm <input type="checkbox"/> Kryesisht i besueshëm <input type="checkbox"/> Jo i besueshëm <input type="checkbox"/> Nuk mund të vlerësohet	

3. Saktësia e informacionit dhe informatave rreth dosjes penale

- I saktë
- I përcaktuar nga burimi
- Zëra- të konfirmuar
- Zëra- të pakonfirmuar

4. Rezultati i hetimit penal ose operacionit të inteligjencës kriminale brenda të cilit ka ndodhur shkëmbimi i informacionit duhet t'i raportohet autoritetit transmetues

- Jo
- Po

5. Në rastin e shkëmbimit pa njoftim paraprak, arsyet për të besuar se informacioni ose informatat rreth dosjes penale mund të ndihmojnë në zbulimin, parandalimin ose hetimin e veprave penale të përmendura në nenin 2, paragrafi 2 të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA:

Vonesë - Nuk është e mundur të kthehet një përgjigje brenda afatit të zbatueshëm sipas nenit 4 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

Informacioni ose informatat rreth dosjes penale nuk mund të jepen brenda afatit të caktuar për arsyet e mëposhtme:

Ka të ngjarë të jepen brenda:

- 1 dite 2 ditësh 3 ditësh
-javësh
- 1 muaji

- Është kërkuar autorizimi i një autoriteti gjyqësor.
Procedura që çon deri në dhënie/refuzimin e autorizimit pritet të zgjasë ... javë

REFUZIMI- Informacioni ose informatat rreth dosjes penale

- nuk mund të jepen apo të kërkohen në nivel kombëtar; ose**
- nuk mund të jepen, për një ose disa nga arsyet e mëposhtme:**

A — Arsye që lidhen me kontrollin gjyqësor, i cili pengon transmetimin ose kërkon përdorimin e ndihmës së ndërsjellë

- autoriteti gjyqësor kompetent nuk ka autorizuar aksesin dhe shkëmbimin e informacionit ose të informatave rreth dosjes penale
- informacioni ose informatat e kërkuara rreth dosjes penale janë marrë më parë me anë të masave shtrënguese dhe dhënia e tyre nuk lejohet sipas legjislacionit kombëtar

- informacioni apo informatat rreth dosjes penale nuk janë të disponueshme
- nga autoritetet ligjzbatuese; ose
 - nga autoritetet publike ose nga subjektet private në një mënyrë që i vë në dispozicion të autoriteteve ligjzbatuese pa marrjen e masave shtrënguese

- B — Dhënia e informacionit ose informatave të kërkuara rreth dosjes penale do të dëmtonte interesat thelbësore të sigurisë kombëtare ose do të rrezikonte suksesin e një hetimi aktual ose të një operacioni të inteligjencës kriminale, sigurinë e individëve, ose do të ishte qartësisht joproporcional ose i parëndësishëm në lidhje me qëllimet për të cilat ishte kërkuar.

Në rast se përdoret rasti A ose B, jepni, nëse konsiderohet e nevojshme, informacione shtesë ose arsye për refuzim (opsionale):

- D — Autoriteti të cilit i drejtohet kërkesa vendos ta refuzojë ekzekutimin, sepse kërkesa lidhet, sipas legjislacionit të Shtetit Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa, me veprën penale të mëposhtme (natyra e veprës dhe kualifikimi i saj ligjor që duhet të specifikohen) e cila dënohet me një ose më pak vite burgim

- E — informacioni apo informatat rreth dosjes penale nuk janë të disponueshme

- F — Informacioni ose informatat e kërkuara rreth dosjes penale janë marrë nga një tjetër Shtet Anëtar ose nga një vend i tretë dhe iu nënshtrohen parimit të specialitetit dhe se Shteti Anëtar ose vendi i tretë nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre për transmetimin e informacionit ose informatave rreth dosjes penale.

Shtojca B

**SHKËMBIM INFORMACIONI SIPAS VENDIMIT KUADËR TË KËSHILLIT 2006/960/JHA,
FORMULAR KËRKESE PËR PËR INFORMACION DHE INFORMATA RRETH DOSJES PENALE
PËR T'U PËRDORUR NGA SHTETI ANËTAR QË DËRGON KËRKESEN**

Ky formular përdoret kur kërkohen informacione dhe informata rreth dosjes penale sipas
Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

I — Informacion administrativ

Autoriteti që dërgon kërkesën (emri, adresa, telefoni, faksi, emaili, Shteti Anëtar):					
Detajet e agjentit të transportit (opsionale):					
Për Shtetin Anëtar në vijim:					
Data dhe ora e kësaj kërkesë:					
Numri i Referencës i kësaj kërkesë:					
Kërkesat e mëparshme					
<input checked="" type="checkbox"/> Kjo është kërkesa e parë për këtë çështje					
<input type="checkbox"/> Kjo kërkesë ndjek kërkesat e mëparshme në të njëjtën çështje					
Ранији захтев(и)			Одговор(и)		
	Data	Numri i referencës (në Shtetin Anëtar që dërgon kërkesën)	Data	Numri i referencës (në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa)	
1.					
2.					
3.					
4.					
Nëse kërkesa është dërguar tek më shumë se një autoritet në Shtetin Anëtar, lutemi specifikoni kanalet e përdorura:					
<input type="checkbox"/>	Oficeri Ndërlidhës i ENU/Europol-it	<input type="checkbox"/>	Për informacion	<input type="checkbox"/>	Për ekzekutim
<input type="checkbox"/>	Interpol NCB	<input type="checkbox"/>	Për informacion	<input type="checkbox"/>	Për ekzekutim
<input type="checkbox"/>	Sirene	<input type="checkbox"/>	Për informacion	<input type="checkbox"/>	Për ekzekutim
<input type="checkbox"/>	Oficeri ndërlidhës	<input type="checkbox"/>	Për informacion	<input type="checkbox"/>	Për ekzekutim
<input type="checkbox"/>	Tjetër (ju lutemi specifikoni):	<input type="checkbox"/>	Për informacion	<input type="checkbox"/>	Për ekzekutim

Në rast se e njëjta kërkesë u dërgohet Shteteve të tjera Anëtare, ju lutemi

II — Afatet kohore

Kujtesë: afatet kohore sipas nenit 4 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

C — Vepra parashikohet në nenin 2, paragrafi 2, të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA

dhe

Informacionet ose informatat rreth dosjes penale të kërkuara mbahen në një bazë të dhënash në të cilën ka akses të drejtpërdrejtë një autoritet ligjzbatues

➔ Kërkesa është urgjente ➔ Afati kohor: 8 orë me mundësi shtyrjeje

➔ Kërkesa nuk është urgjente ➔ Afati kohor: 1 javë

D — Çështje të tjera: ➔ Afati kohor: 14 ditë

Kërkesë Urgjente

Kërkesë Jo Urgjente

Arsye për urgjencë (p.sh. të dyshuarit po mbahen nën arrest, dhe rasti duhet të shkojë në gjykatë para datës së caktuar):

Informacioni ose shërbimi informativ i kërkuar

Llojet e veprës (-ave) penale apo veprimtaritë kriminale që janë në proces hetimi

Përshkrimi i rrethanave në të cilat është kryer vepra (-at) penale, përfshirë kohën, vendin dhe shkallën e pjesëmarrjes në veprën penale nga personi i cili përbën objektin e kërkesës për informacion ose dosjen kriminale:

Natyra e veprave penale

A — Zbatimi i nenit 4 paragrafi 1 ose nenit 4 paragrafi 3 të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA

- A. 1. Vepra penale dënohet me burgim të paktën për tre vjet në Shtetin Anëtar që i drejtohet kërkesa

DHE

A.2. Vepra penale është një (ose më shumë) nga sa më poshtë:

- | | |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> Pjesëmarrja në një organizatë kriminale | <input type="checkbox"/> Pastrimi i të ardhurave nga krimi; |
| <input type="checkbox"/> Terrorizmi | <input type="checkbox"/> Krimi kompjuterik |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i parave, duke përfshirë euron | <input type="checkbox"/> Krimi mjedisor, duke përfshirë trafikimin e paligjshëm të specieve të rrezikuara të kafshëve dhe të specieve dhe varietetëve të rrezikuara të bimëve |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i qenieve njerëzore | <input type="checkbox"/> Mbështetja e hyrjes dhe e qëndrimit të paautorizuar |
| <input type="checkbox"/> Shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe pornografia me fëmijë | <input type="checkbox"/> Vrasja, plagosja e rëndë |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotrope; | <input type="checkbox"/> Tregtia e paligjshme e organeve dhe indeve njerëzore |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve | <input type="checkbox"/> Rrëmbimi, pengmarrja dhe mbajtja e paligjshme e personave |
| <input type="checkbox"/> Korrupsion | <input type="checkbox"/> Racismi ose ksenofobia |
| <input type="checkbox"/> Mashtrimi, duke përfshirë mashtrimin që prek interesat financiare të komuniteteve evropiane sipas kuptimit të Konventës së 26 korrikut 1995 për mbrojtjen e Interesave financiare të Komuniteteve Evropiane | <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i materialeve nukleare dhe radioaktive |
| <input type="checkbox"/> Vjedhja e organizuar ose e armatosur | <input type="checkbox"/> Trafikimi i mjeteve motorike të vjedhura |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i të mirave kulturore, duke përfshirë veprat antike dhe veprat e artit | <input type="checkbox"/> Përdhunimi |
| <input type="checkbox"/> Mashtrimi | <input type="checkbox"/> Zjarrvënie e qëllimshme |
| <input type="checkbox"/> Krimet brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale | <input type="checkbox"/> Shantazhi dhe zhatja; |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i dokumenteve administrative dhe trafikimi me anë të tyre | <input type="checkbox"/> Falsifikimi dhe pirateria e produkteve |
| <input type="checkbox"/> Falsifikimi i mjeteve të pagesës | <input type="checkbox"/> Rrëmbimi i mjeteve fluturuese /anijeve |
| <input type="checkbox"/> Trafikimi i paligjshëm i substancave hormonale dhe i stimuluesve të tjerë të rritjes Nxitësit | <input type="checkbox"/> Sabotimi |

➔ Për rrjedhojë, vepra penale përfshin nenin 2, paragrafi (2), të Vendimit Kuadër 2002/584/JHA-> nenin 4, paragrafi (1) (për rastet urgjente) dhe nenin 4 paragrafi (3) (për rastet jo urgjente) të Vendimit Kuadër 2006/960/JHA që janë rrjedhimisht të zbatueshme sipas afateve kohore për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë

Ose

B — Veprat penale që nuk përfshihen nën

A. Në këtë rast, përshkrimi i veprave penale është si në vijim:

Qëllimi për të cilin kërkohet informacioni ose shërbimi informativ

Lidhja ndërmjet qëllimit për të cilin kërkohet informacioni ose shërbimi informativ dhe personit i cili është objekt i informacionit ose shërbimit informativ

Identiteti (aq sa njihet) i personave që janë objekti kryesor i hetimit penal ose i operacionit të inteligjencës kriminale që i nënshtrohen kërkesës për informacion ose shërbim informativ

Arsyet për të besuar që informacioni ose shërbimi informativ ndodhet në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa

Kufizimet në përdorimin e informacionit që përmban kjo kërkesë për qëllime të tjera nga ato për të cilat është vënë në dispozicion ose për parandalimin kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe serioze të sigurisë publike

lejohet përdorimi

lejohet përdorimi, por nuk përmendet personi që ka dhënë informacionin

nuk lejohet përdorimi pa autorizimin e personit që ka dhënë informacionin

nuk lejohet përdorimi

MARRËVESHJA TIP PËR KRIJIMIN E NJË GRUPI TË PËRBASHKËT HETIMOR

Në përputhje me:

[Ju lutemi tregoni këtu bazat ligjore të zbatueshme, të cilat mund të merren nga – por pa u kufizuar në — instrumentet e renditura me poshtë:

- *Neni 13 i Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian të 29 majit 2000 (1);*
- *Vendimi Kuadër i Këshillit të 13 qershorit 2002 për grupin e përbashkët të hetimor (2);*
- *Neni 1 i Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë për zbatimin e dispozitave të caktuara të Konventës së 29 majit 2000 për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Protokollit të vitit 2001 me 29 dhjetor 2003 (3);*
- *Neni 5 i Marrëveshjes për Ndihmën e Ndërsjellë Ligjore ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (4);*
- *Neni 20 i Protokollit të dytë shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale të 20 Prillit 1959 (5);*
- *Neni 9 paragrafi 1 pika (c) e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Lëndëve Psikotrope (1988) (6);*
- *Neni 19 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2000) (7);*
- *Neni 49 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (2003) (8);*
- *Neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (2006) (9).1*

1. Palët në Marrëveshje

Palët e mëposhtme kanë nënshkruar një marrëveshje për ngritjen e një grupi të përbashkët hetimor, në vijim referuar si "JIT":

1. [Shënoni emrin e agjencisë/administratës kompetente të parë të një Shteti si Palë në marrëveshje]

Dhe

2. [Shënoni emrin e agjencisë/administratës kompetente të dytë të një Shteti si Palë në marrëveshje]

Palët në këtë marrëveshje mund të vendosin me pëlqimin e tyre të ftojnë agjencitë ose administratat e Shteteve të tjera që të bëhen palë në këtë marrëveshje.

2. Qëllimi i JIT-it

Kjo marrëveshje mbulon themelimin e një JIT-i për qëllimin e mëposhtëm:

[Ju lutemi përshkruani qëllimin specifik të JIT-it.

Ky përshkrim duhet të përfshijë rrethanat e krimit(-eve) që po hetohen në Shtetet e përfshira (data, vendi dhe natyra) dhe, nëse është e zbatueshme, referencën për procedurat e brendshme në vazhdim. Referencat për të dhënat personale në lidhje me çështjen duhet të jenë minimale.

Ky seksion duhet gjithashtu të përshkruajë shkurtimisht objektivat e JIT-it (duke përfshirë, p.sh. mbledhjen e provave, arrestimin e koordinuar të të dyshuarve, bllokimin e asetëve ...). Në këtë kontekst, Palët duhet të marrin në konsideratë përfshirjen e fillimit dhe përfundimit të një hetimi financiar si një prej objektivave të JIT-it (10).]

3. Periudha që mbulon kjo marrëveshje

Palët bien dakord që JIT-i do të veprojë për [ju lutemi tregoni kohëzgjatjen specifike], duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi kur pala e fundit në JIT ta ketë nënshkruar atë. Kjo periudhë mund të zgjatet me pëlqim të ndërsjellë.

4. Shtetet në të cilat do të veprojë JIT-i

JIT-i do të veprojë në Shtetet e palëve të kësaj marrëveshjeje.

Grupi i kryen operacionet e tij në përputhje me legjislacionin e Shteteve në të cilat vepron në çdo kohë të caktuar.

5. Drejtuesi(t) e JIT-it

Drejtuesit e grupit të përbashkët janë përfaqësues të autoriteteve kompetente që marrin pjesë në hetimet penale nga Shtetet ku vepron ekipi në çdo kohë të caktuar, nën udhëheqjen e të cilit anëtarët e JIT-it kryejnë detyrat e tyre.

Palët kanë caktuar personat e mëposhtëm për të vepruar si drejtues të JIT-it:

Emri	Pozicioni/Kategoria	Autoriteti/Agjencia	Shteti

Nëse ndonjë nga personat e lartpërmendur nuk është në gjendje të kryejë detyrat e veta, caktohet pa vonesë një zëvendësues për të. Njoftimi me shkrim i këtij zëvendësimi u jepet të gjitha palëve në fjalë dhe i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje.

6. Чланови заједничког истражног тима

Përveç personave të përmendur në pikën 5, palët duhet të sigurojnë një listë të anëtarëve të JIT-it në një shtojcë të dedikuar për këtë marrëveshje (11).

Në rast se ndonjë nga anëtarët e JIT-it nuk është në gjendje të kryejë detyrat e veta, drejtuesi kompetent i JIT-it cakton pa vonesë një zëvendësues për të, me anë të një njoftimi me shkrim.

7. Pjesëmarrësit në JIT

Palët në JIT bien dakord që të përfshijnë [Shënoni këtu p.sh., Eurojust, Europol, OLAF ...] si pjesëmarrës në JIT. Marrëveshjet specifike në lidhje me pjesëmarrjen e [Shënoni emrin] duhet të trajtohen në shtojcën përkatëse të kësaj marrëveshjeje.

8. Mbledhja e informacionit dhe provave

Drejtuesit e JIT-it mund të bien dakord për procedurat specifike që duhet të ndiqen në lidhje me mbledhjen e informacionit dhe provave nga JIT-i në Shtetet në të cilat vepron.

Palët i besojnë drejtuesit të JIT-së detyrën e dhënies së këshillave për marrjen e provave.

9. Aksesit në informacion dhe prova

Drejtuesit e JIT-it specifikojnë proceset dhe procedurat që duhen ndjekur në lidhje me ndarjen midis tyre të informacionit dhe provave të marra sipas JIT-it në çdo Shtet Anëtar.

[Përveç kësaj, palët mund të bien dakord për një klauzolë që përmban rregulla më specifike për aksesin, trajtimin dhe përdorimin e informacionit dhe provave. Kjo klauzolë mund të konsiderohet e përshtatshme kur JIT-i nuk bazohet as në Konventën e BE-së, as në Vendimin Kuadër (që tashmë përfshin dispozita specifike në këtë drejtim - shih nenin 13, paragrafi 10 të Konventës).]

10. Shkëmbimi i informacionit dhe provave të marra para JIT-it

Informacionet ose provat e disponueshme në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe që kanë të bëjnë me hetimin e përshkruar në këtë marrëveshje, mund të ndahen ndërmjet palëve në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

11. Informacionet dhe provat e marra nga Shtetet që nuk marrin pjesë në JIT

Nëse lind nevoja për një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike që do t'i dërgohet një Shteti që nuk merr pjesë në JIT, shteti që drejton kërkesën shqyrton mundësinë e marrjes së miratimit të Shtetit të cilit i drejtohet kërkesa për të ndarë me palët e tjera të JIT-it informacionet ose provat e marra si rezultat i ekzekutimit të kërkesës.

12. Marrëveshje specifike në lidhje me vendet anëtare të deleguara.

[Kur konsiderohet e përshtatshme, palët, sipas kësaj klauzole, mund të bien dakord për kushtet specifike sipas të cilave vendet anëtare të deleguara mund:

- të kryejnë hetime - duke përfshirë në veçanti masat shtrënguese - në Shtetin veprues (nëse konsiderohet e përshtatshme, legjislacioni vendas mund të citohet këtu ose i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje)
- të kërkojnë masa që duhet të kryhen në Shtetin e anëtarit të deleguar
- të ndajnë informacionet e mbledhura nga grupi i përbashkët
- të mbajnë/përdorin armë]

13. Ndryshimet në marrëveshje

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, ndryshimet mund të bëhen në çdo formë të shkruar të miratuar nga palët (12).

14. Konsultimi dhe koordinimi

Palët garantojnë që konsultohen me njëra-tjetrën sa herë që është e nevojshme për koordinimin e aktiviteteve të ekipit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- rishikimin e progresit të arritur dhe performancën e grupit të përbashkët hetimor
- kohën dhe mënyrën e ndërhyrjes nga hetuesit
- mënyrën më të mirë për të ndërmarrë procedura gjyqësore eventuale, shqyrtimin e vendit të duhur të gjykimit dhe konfiskimin.

15. Komunikimi me mediat

Nëse parashikohet, koha dhe përmbajtja e komunikimit me mediat miratohen nga palët dhe ndiqen nga pjesëmarrësit.

16. Vlerësimi

Palët mund të marrin në konsideratë vlerësimin e performancës së JIT, praktikën më të mirë të përdorur dhe mësimet e nxjerra. Mund të organizohet një takim i posaçëm për të kryer vlerësimin.

[Në këtë kontekst, palët mund t'i referohen formularit të vlerësimit të JIT-eve të zhvilluar nga ekspertët e Rrjetit të Bashkimit Evropian të JIT-ve. Mund të kërkohet financim nga BE-ja për të mbështetur takimin e vlerësimit.

17. Marrëveshje specifike

[Ju lutemi shënoni, nëse është e zbatueshme. Nënkapitujt e mëposhtëm kanë për qëllim të theksojnë fushat e mundshme që mund të përshkruhen në mënyrë të specifike.]

17.1. Rregullat e zbulimit

[Palët mund të dëshirojnë të sqarojnë këtu rregullat kombëtare të zbatueshme për komunikimin për mbrojtjen dhe/ose të bashkëngjisin një kopje ose një përmbledhje të tyre.]

17.2. Menaxhimi i asetëve/marrëveshjeve të rikuperimit të asetëve

17.3. Përgjegjësia

[Palët mund të dëshirojnë ta rregullojnë këtë aspekt, veçanërisht kur JIT-i nuk bazohet as në Konventën e BE-së, as në Vendimin Kuadër (që tashmë përfshin dispozita specifike në këtë drejtim - shih nenin 15, paragrafi 16 të Konventës).]

18. Marrëveshje organizative

[Ju lutemi shënoni, nëse është e zbatueshme. Nënkapitujt e mëposhtëm kanë për qëllim të theksojnë fushat e mundshme që mund të përshkruhen në mënyrë të specifike.]

18.1. Pajisjet (ofrimi i zyrave, automjetet, pajisje të tjera teknike)

18.2. Kostot/shpenzimet/sigurimi

18.3. Mbështetje financiare për JIT-et

[Sipas kësaj klauzole, Palët mund të bien dakord për marrëveshje specifike lidhur me rolet dhe përgjegjësitë brenda grupit në lidhje me paraqitjen e kërkesave për financim nga BE-ja.]

18.4. Gjuha e komunikimit

Nënshkruar në [vendi i nënshkrimit], [data]

[Nënshkrimi i palëve të pranishme]

(1) Fletore Zyrtare C 197, 12.7.2000, f. 3.

(2) Fletore Zyrtare L 162, 20.6.2002, f. 1.

(3) Fletore Zyrtare L 26, 29.1.2004, f. 3.

(4) Fletore Zyrtare L 181, 19.7.2003, f. 34.

(5) CET No 182.

(6) Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol. 1582, f. 95.

- (7) Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol. 2225, f. 209. Dok. A/RES/55/25.
- (8) Kombet e Bashkuara, Seria e Traktateve, vol. 2349, f. 41. Dok. A/58/422.
- (9) Regjistrimi në Sekretariatit e Kombeve të Bashkuara: Shqipëri, 3 Qershor 2009, Nr. 46240.
- (10) Palët duhet t'i referohen në këtë kontekst Konkluzioneve të Këshillit dhe Planit të Veprimit për progresin në lidhje me hetimin financiar (Dokumenti i Këshillit 10125/16 + COR1)
- (11) Kur është e nevojshme, JIT-i mund të përfshijë ekspertë kombëtarë të rikuperimit të aseteve.
- (12) Shembujt e formulimeve mund të gjenden në Shtojcat 2 dhe 3.

Aneksi I

MARRËVESHJA TIP PËR KRIJIMIN E NJË GRUPI TË PËRBASHKËT HETIMOR

Pjesëmarrësit në një JIT

Marrëveshje me Europol-in/Eurojust-in/Komisionin (OLAF), organet kompetente në bazë të dispozitave të miratuara në kuadër të Traktateve dhe organeve të tjera ndërkombëtare.

1. Pjesëmarrësit në JIT

Personat e mëposhtëm do të marrin pjesë në JIT:

Emri	Pozicioni/Kategoria	Organizata

[Shëno emrin e Shtetit Anëtar] ka vendosur që anëtari i tij kombëtar i Eurojust-it do të marrë pjesë në grupin e përbashkët hetimor në emër të Eurojust-it/si një autoritet kombëtar kompetent (1).

Nëse ndonjë nga personat e lartpërmendur nuk është në gjendje të kryejë detyrat e veta, caktohet pa vonesë një zëvendësues për të. Njoftimi me shkrim i këtij zëvendësimi u jepet të gjitha palëve në fjalë dhe i bashkëngjitet kësaj marrëveshjeje.

2. Marrëveshje specifike

Pjesëmarrja e personave të lartpërmendur do t'u nënshtrohet kushteve të mëposhtme dhe vetëm për qëllimet e mëposhtme:

2.1. Pjesëmarrësi i parë në marrëveshje

2.1.1. Qëllimi i pjesëmarrjes

2.1.2. Të drejtat e akorduara (nëse ka)

2.1.3. Dispozita në lidhje me kostot

2.1.4. Qëllimi dhe fushëveprimi i pjesëmarrjes

2.2. Pjesëmarrës i dytë në marrëveshje (nëse është e zbatueshme)

2.2.1. ...

3. Kushtet e pjesëmarrjes për stafin e Europolit

- 3.1. Stafi i Europolit që merr pjesë në grupin e përbashkët hetimor ndihmon të gjithë anëtarët e grupit dhe ofron gamën e plotë të shërbimeve mbështetëse të Europolit për hetimin e përbashkët siç parashikohet dhe në përputhje me Rregulloren e Europolit. Ata nuk zbatojnë asnjë masë shtrënguese Megjithatë, stafi pjesëmarrës i Europolit mundet, nëse udhëzohet dhe nën udhëheqjen e drejtuesit(ve) të grupit, të jetë i pranishëm gjatë aktiviteteve operacionale të grupit të përbashkët hetimor, për të dhënë këshilla dhe ndihmë në çast për anëtarët e grupit të cilët zbatojnë masat shtrënguese, me kusht që të mos ketë kufizime ligjore në nivel kombëtar, aty ku vepron grupi.
- 3.2. Neni 11(a) i Protokollit për Privilegjet dhe Imunitetet e Bashkimit Evropian nuk zbatohet për stafin e Europolit gjatë pjesëmarrjes së tij në JIT (2). Gjatë operacioneve të JIT-it, stafi i Europolit-it, në lidhje me veprat penale të kryera ndaj tyre ose nga ata, i nënshtrohet ligjit kombëtar të Shtetit Anëtar që kryen operacionin, i cili është i zbatueshëm për personat me funksione të ngjashme.
- 3.3. Stafi i Europolit mund të mbajë lidhje të drejtpërdrejtë me anëtarët e JIT-it dhe i jep të gjithë anëtarëve të JIT-it të gjithë informacionin e nevojshëm në përputhje me Rregulloren e Europolit.

(1) Lutemi kryeni kërkimin sipas procedurave të aplikueshme

(2) Protokollin për Privilegjet dhe Imunitetet e Bashkimit Evropian (variant i konsoliduar) (OJ C 326, 26.10.2012, p. 266).

ANEKSI II

MARRËVESHJA TIP PËR KRIJIMIN E NJË GRUPI TË PËRBASHKËT HETIMOR

Marrëveshje për zgjerimin e grupit të përbashkët hetimor

Palët kanë rënë dakord të ndryshojnë marrëveshjen me shkrim duke krijuar një grup të përbashkët hetimor (në vijim 'JIT') më **[shëno datën]**, nënshkruar në **[shëno vendin]**, një kopje e së cilës i është bashkangjitur marrëveshjes.

Palët konsiderojnë se JIT-i duhet të shtyjë afatin kohor për të cilën ishte krijuar **[shënoni datën e përfundimit të periudhës]**, meqenëse qëllimi i tij siç përcaktohet në nenin **[shënoni qëllimin JIT-it këtu]** nuk është arritur.

Rrethanat që kërkojnë që JIT-i të shtyjë afatin kohor janë shqyrtuar me kujdes nga të gjitha palët. Shtyrja e afatit kohor të JIT-it konsiderohet thelbësore për arritjen e qëllimit për të cilin JIT-i u krijua.

Për këtë arsye JIT-i do të vazhdojë me operacionin për një periudhë shtesë **[ju lutemi tregoni kohëzgjatjen specifike]** nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje. Afati kohor i mësipërm mund të shtyhet me tej me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Data/Nënshkrimi

ANEKSI III

MARRËVESHJA TIP PËR KRIJIMIN E NJË GRUPI TË PËRBASHKËT HETIMOR

Palët kanë rënë dakord të ndryshojnë marrëveshjen me shkrim duke krijuar një grup të përbashkët hetimor (në vijim 'JIT') më **[shëno datën]**, nënshkruar në **[shëno vendin]**, një kopje e së cilës i është bashkangjitur marrëveshjes.

Nënshkruesit kanë rënë dakord që nenet e mëposhtme të ndryshohen si në vijim:

1. (Ndryshimi...)
2. (Ndryshimi...)

Rrethanat që kërkojnë që marrëveshja e JIT-it të ndryshohet, janë shqyrtuar me kujdes nga të gjitha palët. Ndryshimet (ndryshimet) e Marrëveshjes së JIT-it konsiderohen thelbësore për arritjen e qëllimit për të cilin u krijua JIT.

Data/Nënshkrimi

RAI

Nisma Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) përfaqëson një organizatë ndërqeveritare me nëntë shtete anëtare: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia. Polonia, Gjeorgjia dhe Sllovenia janë vende që gëzojnë statusin e Vëzhguesit. Misioni i RAI-t konsiston në udhëheqjen e bashkëpunimit rajonal për të mbështetur përpjekjet në luftën kundër korrupsionit, duke ofruar një platformë të përbashkët për diskutime përmes shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira.

Sekretariati i Organizatës ka selinë e tij në Sarajevë me projekte të shtrira në të gjithë Evropën Jug-lindore, duke u fokusuar kryesisht në forcimin e bashkëpunimit rajonal për sa i përket çështjeve si konflikti i interesit dhe zbulimi i aseteve, vlerësimi i hapësirave ligjore për korrupsion, vlerësimi i rrezikut të korrupsionit, sinjalizimi, ndërtimi i integritetit në zbatimin e ligjit dhe forcimi i kapaciteteve kombëtare në rikuperimin e aseteve.

Qendra AIRE

Qendra AIRE përfaqëson një organizatë joqeveritare me mision ndërgjegjësimit për të drejtat e ligjit evropian dhe siguron mbështetje për viktimat nga shkelja e të drejtave të njeriut. Një grup avokatësh ndërkombëtarë ofrojnë informacion, mbështetje dhe këshillim mbi standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Qendra ka ekspertizë dhe përvojë të veçantë në çështjet gjyqësore pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe ka marrë pjesë në mbi 150 raste. Gjatë 20 viteve të fundit, Qendra AIRE ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në disa seminare në Evropën Qendrore dhe Lindore në përfitim të avokatëve, gjyqtarëve, zyrtarëve qeveritarë dhe organizatave joqeveritare.


Qendra AIRE është përqëndruar në vendet e Ballkanit Perëndimor, ku për më shumë se një dekadë e gjysmë, ka zhvilluar një sërë programesh afatgjata në lidhje me promovimin e sundimit të ligjit në partneritet me institucionet dhe gjykatat vendase. Qëllimi ynë në të gjitha këto programe ka qenë promovimi i zbatimit në nivel kombëtar i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të ndihmojmë në procesin e integritetit evropian, duke forcuar sundimin e ligjit dhe thellimin e njohurive për të drejtat e njeriut, duke inkurajuar bashkëpunimin rajonal midis gjyqtarëve dhe profesionistëve ligjorë.



**REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE**

Fra Andela Zvizdovića 1. B/5
71000 Sarajevo
Bosnia and Herzegovina
Tel: +387 33 296 327/328
www.rai-see.org

We look for better solutions together



The AIRE Centre
Advice on Individual Rights in Europe

Room 505, Institute of
Advanced Legal Studies
Charles Clore House,
17 Russell Square, London
Tel: +44 20 7831 4276
www.airecentre.org



Foreign &
Commonwealth
Office

Përgatitja e këtij publikimi është mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim nuk reflektojnë domosdoshmërisht qendrimin zyrtar të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.